

BUKA E VITEVE TË HERSHME
Hajnrih Bël

I

Hedviga erdhi ditën e hënë dhe atë mëngjes, përpara se pronarja të më fuste nën derë letrën e tim eti, unë duhej të kisha mbuluar kokën me kënaqësi me batanije, siç bëja shpesh më parë kur banoja ende në bujtinë, por në korridor dëgjova pronaren që thirri: "Ju ka ardhur një letër nga shtëpia!" Kur futi letrën nën derë dhe kjo rrëshqiti e bardhë dëborë në përhimësinë ku qe kredhur dhoma, brofa i trembur nga krevati, sepse në vend të vulës së rrumbullakët të postës, dallova vulën vezake të postës së hekurudhës.

Babai, i cili i kishte zët telegramet, më dërgoi ato shtatë vjet që banoja fillikat këtu në qytet, vetëm dy letra të këtilla me vulën e postës së hekurudhës: në letrën e parë më njoftonte për vdekjen e nënës, kurse në të dytën për fatkeqësinë që i kishte ndodhur, ku kishte thyer të dy këmbët - dhe ja kjo ishte letra e tretë. E hapa letrën dhe u lehtësova kur e lexova. "Mos harro" shkruante im atë "se çupa e Mulërve, Hedviga për të cilën ti zure dhomë, vjen sot me tren, që mbërrin aty më 11:47. Ki mirësinë, dil e merre në stacion, bli ca lule dhe tregoju i dashur me të. Përpiqu të përfytyrosh gjendjen shpirtërore të vajzës: ajo vjen për herë të parë vetëm në qytet, nuk e njih rrugën, nuk e njih lagjen ku do të banojë. Për të, gjithçka aty është e huaj dhe stacioni i trenit, me atë zhurmën e tij në drekë, do ta trembë. Mos harro se ajo është njëzet vjeçe dhe vjen në qytet që të bëhet mësuese. Sa keq, që nuk më vjen më të dielave rregullisht, sa keq! Përzemërsisht, babai".

Më vonë, fillova ta vrisja mendjen shpesh se çfarë do të kishte ndodhur, po të mos e kisha pritur Hedvigën në stacion: do të kisha hyrë në një jetë tjetër, ashtu siç gabon, në një jetë që atëherë, përpara se ta njihja Hedvigën, më ishte dukur krejt e pranueshme. Kështu e quaja kur flisja me vetveten, por këtë jetë që më priste e gatshme si treni në anën

tjetër të peronit, treni që thuajse do të kisha marrë, këtë jetë rroj tani në ëndrrat e mia. E di se ajo jetë, që më ishte dukur krejt e pranueshme atëherë, do të ishte kthyer e bërë një ferr i vërtetë. E shoh veten rrotull kësaj jete, tek buzëqesh, tek flas, siç sheh të buzëqeshë dhe siç dëgjon të flasë në ëndërr një vëlla binjak, që s'e ke pasur kurrë; atë, që ndoshta për një grimëz të sekondës ishte ngjizur, përpara se fara që e mbartte të merrte fund.

U çudita atëherë që im atë e kishte dërguar këtë letër urgjente dhe nuk e dija ende në do të kisha kohë ta merrja Hedvigën në stacion, se, që kur jam specializuar për riparimin dhe kontrollin e makinave automatike larëse, fundjava dhe të hënata nuk janë të qeta. Pikërisht të shtunave dhe të dielave, kur janë pushim, burrat engledisen me këto makina të çmueshme, sepse duan të binden për cilësinë dhe mënyrën e tyre të punës. Unë rri pranë telefonit dhe pres telefonata, që më çojnë shpesh në rrethinat e largëta të qytetit. Me të shkelur në ato shtëpi, ndiej erën e kontakteve dhe të kabllove të djegur ose gjej makina, nga të cilat shkuma e sapunit buron si në filmat multiplikativë; takoj burra të penduar, gra që qajnë, të cilat nga ata pak butona që kanë për të shtypur, ose e harrojnë aksh buton ta shtypin, ose e shtypin dy herë. Atëherë shijoj plogështinë me të cilën hap çantën e veglave, kontrolloj buzëpërvëshur defektin, rrëmoj i qetë çelësat, levat dhe lidhjet dhe sqaroj, duke buzëqeshur miqësisht, edhe një herë funksionimin e makinës, ndërkohë që përgatis sipas udhëzimit përzierjen e pluhurit të sapunit. Pastaj e lë makinën të punojë dhe, ndërsa laj duart, dëgjoj me mirësjellje fjalët prej specialisti diletant të të zotit të shtëpisë, që gëzohet tek sheh se njohuritë e tij teknike merren seriozisht. Kur më shënojnë pastaj në dëftesë orët e punës dhe kilometrat e rrugëtimit, nuk shikojnë në më të shumtën e herëve dhe aq me vëmendje, atëherë unë i hipi i qetë makinës dhe shkoj tek vendi tjetër i telefonatës.

Dymbëdhjetë orë punë edhe të dielave dhe herë pas here ndonjë takim me Volfin dhe Ulan në kafenenë Joosi. Të dielave - ndonjë mbrëmësore, tek e cila në më të shumtën vete me vonesë dhe lexoj me frikë në lëvizjet që bën prifti se mos ka filluar lutja e blatimit. Psherëti i lehtësuar kur shikoj se ajo s'ka filluar dhe ulem i lodhur në ndonjë stol. Nganjëherë më zë kështu gumi dhe zgjohem kur ministrantët i bien ziles për tejnishërimin. Ka çaste që e urrej veten time, punën dhe duart e mia.

Këtë mëngjes të hëne ndjehesha i lodhur; kisha gjashtë telefonata nga e diela dhe në treme dëgjova pronaren e bujtinës që tha: "Po, do t'ia them". U ula në shtrat, ndeza një cigare dhe po mendoja për babanë.

Shikoja se si kalonte mbrëmjeve nëpër qytet për ta hedhur letrën në postën e trenit, që ndalonte më dhjetë në Knohta. E shikoja se si shkonte nëpër sheshin e kishës, si kalonte pranë shtëpisë së Mulerëve, nëpër rruginën e ngushtë me pemët e sakatuara, si hapte derri e madhe të gjimnazit për të shkurtuar rrugë dhe dilte në oborin e shkollës përmes hyrjes së erret, si shikonte pranë ballinës së pasme të lyer me bojë të verdhë të godinës lart klasën e tretë, si kalonte para pemës, që lartohej në mesin e oborrit e binte erë urinë e qenit të kujdestarit të shkollës. Shihja babanë si hapte derën e vogël, që çdo mëngjes nga ora tetë pa pesë deri më tetë hapej për nxënësit e autoshkollës, të cilat vërshonin nga stacioni përballë, ndërkohë që Honshaidi, kujdestari i shkollës, që rrinte atje te dera për të parë se mos ndonjë nga nxënësit që banonin në qytet përvidhej përmes derës. Alfred Grusi ndoshta, i biri i përgjegjësit të stacionit të trenit, i cili duhej të bënte rrugën e gjatë e të shkretë, për qark bllokut të shtëpive, sepse nuk ishte nxënës i autoshkollës.

Në mbrëmjet verore dielli varet i kuq në xhamat shkëlqyer të dritareve të klasave. Vitin e fundit, që e kalova në Knohta, shkoja shpesh me babanë kësaj rruge, kur çonim letra apo pako për nënën në postën e trenit, që vinte nga drejtimi i përkundërt dhe më dhjetë e gjysmë ndalonte në Brohen, ku nëna ishte shtruar në spital.

Edhe babai, në kthim, më të shumtën e herëve zgjidhte këtë rrugë përmes oborrit të shkollës, sepse ajo shkurtonte katër minuta kohë dhe mënjanonte rrugën rrotull bllokut të shëmtuar të shtëpive dhe sepse im atë të shumtën e herëve kishte pr të marrë ndonjë libër apo fletore. Kur sjell në mëndje këto mbrëmje verore të dielash në gjimnaz, më këputet zemra: korridoret kridheshin në një errësirë të përhimtë, kasketa të veçuara vareshin në kremstarët përpara klasave, dyshemeja sapo ishte vajosur, bronzi e argjendi në monumentin e të rënëve vezullonte lëbyrtas pranë katërkëndëshit të madh e të bardhë dëborë, ku zakonisht varej portreti i Hitlerit dhe rrëzëllente e kuqe jaka e Sharnhorstit¹, ngjitur me sallën e mësuesve.

Një ditë u përpoqa të fusja në xhep një formular dëftese që ishte mbi tryezën e sallës së mësuesve, por formulari ishte aq i ngrirë dhe fëshfëriti aq shumë kur e palosa dhe po matesha ta fusja nën kërnishë, sa që im atë që rrinte atje te dollapi, u kthye, ma rrëmbeu me inat nga dora dhe e hodhi prapë në tryezë. Ai nuk u mundua ta lëmonte, nuk më shau por që nga ky çast lipsej ta prisja gjithmonë jashtë në korridor fillikat me jakën e kuqe gjak të Sharnhorstit dhe me të kuqin e buzëve të Ifigenisë, portreti i së cilës varej atje pranë klasës së katërt të gjimnazit. Nuk më mbeti gjë tjetër veçse errësira e përhimtë e korridorit dhe, kohë më kohë, një vështrim përmes vrimës së derës brenda në klasën e katërt. Por edhe vrima linte të lirë vetëm vështrimin në errësirën e përhimtë. Një ditë gjeta një letër asi kup në dyshemenë e porsavajosur: i kuqi ishte po ai i buzëve të Ifigenisë dhe i jakës së Sharnhorstit dhe përmes

¹ *Sharnhorst = general prusian në kohën e luftimeve të Napoleonit.*

amëzës së vajit të freskët ndjeva duhmën e gjellëve të kuzhinës së shkolks. Para klasave shihja qartë gjurmët e rrumbullakëta të bidonit të nxehtë mbi linoleum dhe kjo erë supe, mendimi i bidonit që të hënën në drekë do të qëndronte para klasës sonë, më zgjoi urinë, të cilën nuk mund ta shuante dot i kuqi i jakës së Sharnhorstit, i buzëve të Ifigjenisë dhe ai i asit të letrave. Kur ktheheshim për në shtëpi, i lutesha tim eti për të hedhur një sy te Fundali, furrтари, t'i thoshim "Mirëmbërëma" dhe kalirnthi ta pyesnim në kishte ndonjë bukë, apo mos i kishte mbetur ndonjë copë kek i murrëmë, shtresa e marmelatës së të cilit ishte aq e kuqe sa dhe jaka e Sharnhorstit. I diktova tim eti, ndërsa çapiteshim nëpër rrugët e qeta e të errëta për në shtëpi, të gjithë dialogun që duhej të bënte me Fundalin - për t'i dhënë vizitës sonë ngjyresën e rastësisë. U habita me veten për talentin tim të sajimit dhe, sa më shumë i afroheshim dyqanit të Fundolit, aq më ngulmuese bëheshin përfytyrimet e mia, aq më i mirë bëhej dialogu imagjinar, që babai duhej të bënte me Fundalin. Im atë tundte kokën fort, sepse djali i furrtarit kishte pasë qenë në klasën e tij, një nxënës i keq, por kur arritëm në shtëpinë e Fundalit, ai sikur ngurroi, sepse qëndroi. E dija sa të vështirë e kishte, por vazhdoja ta zhbiroja dhe çdo herë, si bënte një si kthesë katrore, siç i bëjnë kthesat ushtarët në filrnat komikë, vinte te dera e shtëpisë së Fundaleve dhe binte mbrëmje e diel, ora dhjetë dhe gjithmonë përsëritej e njëjta skenë e heshtur: vinte dikush dhe hapte derën, por kurrë Fundali vetë dhe im atë e humbte dhe emocionohet aq sa nuk i jepte dot as vaktin. Djali i Fundalit, e bija apo e shoqja, kushdo që hapte derën, thërriste mbrapa në korridorin e errët: "Baba, zoti mësues". Dhe im atë priste gojëkyçur, ndërsa unë qëndroja pas tij dhe regjistroja grahmat e darkës Fundale: binte erë mish i pjekur apo dhjamë i tiganisur dhe, kur dera e gilarit ishte e hapur, më vinte era e bukëve. Pastaj dilte Fundali, shkonte në dyqan, sillte një bukë, që nuk e mbështillte, ia zgjaste tim eti dhe babai e merrte pa thënë asgjë. Herën e parë s'kishim as çantë, as

letër me vete dhe im atë e mbajti nën sqetull, ndërsa unë e ndiqja pas gojëkyçur dhe vëreja shprehjen e fytyrës së tij: ishte një fytyrë gazmore, krenare dhe nuk dalloje asgjë nga fakti se sa e vështirë i ishte bërë jeta. Kur u mata t'ia merrja bukën për ta mbajtur vetë, ai tundi miqësisht kokën dhe, më vonë, kur shkonim sërish të dielave mbrëma nga stacioni për të hedhur letrën për nënën në postën e trenit, unë kujdesesha gjithmonë që të merrnim ndonjë çantë me vete. Erdhën muaj kur e prisja me gëzimn qysh të martën atë bukë speciale, gjersa një të diel, papritur, Fundali na e hapi vetë derën dhe nga fytyra e tij e kuptova menjëherë se s'do të na jepte bukë: sytë e rëndhenj e të errët ishin të ashpër, mjekrën e rëndë e kishte si të një figure monumenti dhe nuk i lëvizti thujt fare buzët kur na tha: "Unë jap bukë vetëm me marka dhe të dielave mbrëma s'jap as me marka". Na e përplasi derën para hundës, atë derë, që sot është hyrja e kafenesë së tij, në të cilën rmblihet klubi lokal i xhazit. Unë kisha parë pllakatin e kuq flakë: negër shend e verë, që shtrëngonin buzët pas pipëzave të trombave.

Kjo punë zgjati disa sekonda, gjersa e mblodhëm veten dhe shkua në shtëpi, unë me çantën bosh, lëkura e së cilës ishte po aq e flashkët sa dhe lëkura e një traste psonisjesh. Shprehja e fytyrës së tim eti ishte, si zakonisht, po ajo: krenare dhe e gëzuar. Ai tha "Dje u detyrova t'i vija të birit një pesë."²

Dëgjova pronaren time tek bluante kafë në kuzhinë, dëgjova këshillat miqësore, me zë të ulët, që i jepte së bijës të vogël —dhe qejfi ma kishte ende të shkoja në shtrat dhe të mbuloja kokën me batanije: akoma më kujtohet sa bukur ishte, kur e kuptova aq mirë në bujtinë, se lipsej të shtrembëroja gojën si i mjerë. Kështu drejtori, kapelani Derins, urdhëroi të më sillnin çaj dhe një borsë të ngrohtë në shtrat dhe unë ia futa gjumit prapë, kur të tjerët zbritën poshtë për të ngrënë mëngjesin. U zgjova vetëm aty nga ora njëmbëdhjetë, kur erdhi pastruesja për të

² Pesë – në shkollën gjermane pesa është nota më e keqe.

ormisur dhomën e madhe të gjumit. Ajo quhej Vicel dhe unë kisha frikë nga vështrimi i saj i egër e i kaltër, frikë nga ndershmëria e atyre duarve të fuqishme dhe, ndërsa rregullonte shtretërit dhe paloste batanijet - krevatin tim e linte pa rregulluar si krevat i një leprozi lëshonte gjithmonë ato fjalë kërcënuese, që ende sot më tingëllojnë të tmerrshme në veshë: "Ti s'do të bëhesh asgjë - asgjë s'ke për t'u bërë". Keqardhja e saj kur më vdiq nëna dhe të gjithë mu bënë miq, keqardhja e saj ishte dhe më e keqe për mua. Por kur pas vdekjes së sime ëme ndërrova profesionin dhe punën e mësuesit, duke ardhur vërdallë tërë ditën në bujtinë, gjersa kapelani më gjeti një vend të ri pune - qëroja patate apo vija vërdallë në korridore me një fshesë në dorë ato ditë asaj i iku përsëri keqardhja për mua dhe, sa më shihte, lëshonte nga goja ato fjalë profetike: "Ti s'do të bëhesh asgjë - asgjë s'ke për t'u bërë". Kisha frikë nga ajo si nga një shpend grabitqar, që të ndjek duke krakërritur, dhe u arratisa e u futa në kuzhinë, ku nën mbrojtjen e zonjës Fehter e ndieja veten të sigurt: e ndihmoja këtë të konservonte lakër dhe fitoja ndonjë racion puding ekstra, duke i shtyrë lakrat e bardha mbi zdrukthin e madh. Pastaj nanurisesha nga ërn bëlsia e këngëve që këndonin kuzhinierët. Gjatë këngës, vendet që zonja Fehter i mbante për të pamoralshme - vendet si "Dhe ai e dashuronte atë në natën e madhe e të errët" - mbyteshin nga gumëzhima e përgjithshme. Por grumbulli i lakrave të bardha u pakësua më shpejt nga ç'kisha menduar dhe mbeteshin akoma edhe dy ditë të frikshme, që kisha për të kaluar me fshesë në dorë nën urdhrat e zonjës Vicel. Pastaj kapelani më gjeti punë tek Vikveberi dhe, pasi punova si nxënës në bankë, si ndihmës shitës dhe marangoz çirak, fillova punë si elektrikist te Vikveberi.

Para pak kohe, shtatë vjet pas qëndrimit në bujtinë, pashë zonjën Vicel në një stacion tramvaji. Ndala makinën, zbrita dhe i thashë të hipte e ta çoja në qytet. Ajo pranoi, por kur zbriti te shtëpia, më tha

përzemërsisht: "Ju falënderit, por një veturë nuk do të thotë aspak se je bërë diçka...".

Nuk e mbuloja kokën me batanije, nuk merrja mundimin të vendosja nëse zonja Vicel kishte apo jo të drejtë, sepse, në isha bërë diçka apo jo, kjo aq më bënte. Kur pronarja më sollli mëngjesin, po rrija ende në buzë të krevatit. I dhashë letrën e tim eti dhe ajo e lexoi, ndërkohë që shtiva kafë dhe bëra gati bukën.

- Natyrisht, - tha ajo, do të shkoni. Dhe e vuri letrën në tabaka, pranë kutisë me sheqer. Tregohuni i sjellshëm dhe ftojeni vajzën për drekë. Mos harroni se këto çupat e reja, në më të shumtën, kanë uri më shumë se sa thonë.

Ajo doli jashtë, se ra zilja e telefonit, dhe e dëgjova të thoshte përsëri: "Po, po do t'i them - po" dhe u kthye e tha: "Më telefonoi një grua në Kurbelshtrese, qante rië telefon se nuk po e rregullonte dot makinën. Ajo ju lutet që të shkoni ta ndihmoni menjëherë.

- Nuk mundem, - i thashë unë, - duhet të mbaroj në fillim telefonatat e djeshme.

Pronarja mblodhi supet dhe u largua. Unë hëngra mëngjes, u lava dhe po mendoja për të bijën e Mulerve, që s'e njihja fare. Ajo lipsej të vinte qysh në shkurt në qytet dhe unë qesha me letrën e tim eti, me shkrimin që ia njihja nga notat e detyrave të mia dështake të anglishtes, si dhe me stilin e tij.

"Ime bijë, Hedviga" shkruante atëherë Mulleri "do të vijë në shkurt në qytet për të filluar studimet në Akademinë Pedagogjike. Do t'ju isha mirënjohës, po të më ndihmonit për t'i gjetur një dhomë. Sigurisht, nuk më mbani mend mirë unë jam drejtor i shkollës Hoffman-fon-Fallers, në të cilën edhe ju kini kryer disa vjet studime" - me këtë mënyrë fisnike ai shprehu faktin se, kur isha gjashtëmbëdhjetë vjec, pasi mbeta në klasën e katërt dhe e bëra atë dy herë, e braktisa shkollën si shtatvjeçar dështak - "por ndoshta" vazhdonte të shkruante

Mulleri më tej "më mbani mend dhe shpresoj se lutja ime nuk do t'ju sjellë shumë telashe. Ime bijë nuk do dhomë me shumë pretendime, por as edhe të shëmtuar, mundësisht jo larg Akademisë Pedagogjike, dhe - po qe se biem dakord - jo në lagjet e rrethinave dhe, përveç kësaj, marr leje të theksoj se dhoma, për çdo rast, duhet të jetë me çmim të leverdishëm. Duke lexuar letrën, Mulleri u bë për mua një person krejt tjetër, ndryshe nga ai që kisha në kujtesë: e mbaja mend si njeri elastik e harraq dhe thujse pak shallatur, por tani mu shfaq portreti i një njeriu pedant dhe kurnac, që nuk i afrohej atij që kisha në kujtesë.

Vetëm fjala "i leverdishëm" mjaftonte që ta urreja atë që në asnjë mënyrë nuk ishte i urryer në kujtesën time, sepse e urrej fjalën "i leverdishëm". Edhe im atë di të rrëfejë për ato kohë, në të cilat një fund gjalpë kushtonte një markë, një dhomë e mobiluar me mëngjes dhjetë marka, kohë në të cilat me tridhjetë pfenigë në xhep mund të shkoja të kërceja dhe në lidhje me tregimet e këtyre kohëve fjala "i leverdisshëm" shqiptohej gjithmonë me një nënton ankues, sikur ai që i rrëfehej ishte fajtor, që gjalpi tani kushtonte katër herë më shumë. Më është dashur të mësoj çmimin për të gjitha gjërat - sepse nuk mund ta paguaja kurrë kur erdha vetëm si çirak gjashtëmbëdhjetë vjeçar në qytet: uria m'i mësonte çmimet; mendimi i bukës së porsapjekur më bënte krejt budalla dhe endesha mbrëmjeve shpesh me orë të tëra nëpër qytet, pa menduar për asgjë tjetër veçse për bukë. Sytë më digjinin, gjunjët i kisha të dobët dhe ndjeja diçka prej ujku në vetvete - urinë. Kisha neps për bukë, siç mund të kesh neps për morfinë. Kisha frikë nga vetë vetvetja, gjithmonë sillja ndër mend burrin që mbajti në bujtinë një referat për fotografitë e një ekspedite të Veriut, duke na rrëfyer se si kishin coptuar peshq të porsakapur, ende të gjallë, dhe i kishin kollofitur. Ende tani, që i kam marrë paratë, çapitem me kartëmonedhat dhe të shkoqurat në xhep nëpër qytet, kujtoj atë frikë prej ujku të atyre ditëve dhe blej bukë ashtu taze, siç qëndruan në vitrinat e furrës: blej dy, që më duken shumë

të mira, pastaj blej përsëri edhe një tjetër në dyqanin e afërm, panine të vogla, të zeshkëta, të rreshkura, shumë panine, të cilat pastaj ia vë pronares time atje në kuzhinë, sepse nuk mund ta ha dot një të katërtën e karaveles së blerë dhe mendimi se buka mund të më dëmtojë më mbush me frikë.

Më të këqij për mua ishin muajt pas vdekjes së nënës: nuk kisha me qejf të vazhdoja mësimet për elektrikist. Por kisha provuar gjer më tani shumë zanate: kisha qenë nxënës në bankë, shitës, çirak marangozi. Të gjithë gjithmonë për tamam dy muaj dhe e urreja edhe këtë zanat të ri, e urreja tim usta aq shumë, sa që shpesh më merreshin mendtë, kur kthehesha në mbrëmje në bujtinë me tramvajin e mbushur dingas me njerëz. Por, megjithatë i vazhdova mësimet, sepse kisha vendosur t'ua tregoja juve. Katër herë në javë duhej të shkoja mbrëmjeve në St-Vincenc-Hospital, ku një kushëriri e largët e nënës ishte atje kuzhinierë; atje merrja supë, nganjëherë edhe bukë dhe gjeja te stoli përpara dritarezës së kuzhinës çdo herë katër apo pesë të uritur të tjera, më të shumtit ishin pleq, që zgjatnin duart dridhëse në sportel kur hapej dritareza dhe dukeshin kështu durt e rrumbullata të kuzhinieres Klara. Lipsej të përmbahesha që të mos ia rrëmbeja nga dora pjatën me supë. Supa shpërndahej gjithnjë vonë, kur të sëmuret kishin kohë që flinin nuk donin të zgjonin dyshimet e tyre se këtu me supën, që u jepej, tregohej një dhimbisuri e pavend dhe në korridor ku rrinim galiç, ndriçonin hajën tonë vetëm dy llampa 15-wat. Shpesh ne e ndërprisnim të ngrënë, dritareza shtyhej për të dytën herë dhe kuzhinierë Klara merrte aty pjata plot me puding: ky puding ishte gjithmonë i kuq, aq flakë i kuq sa stopkat e sheqerit, që i gjen në sheshet e panairëve dhe, kur suleshim për te sporteli, kuzhinierë Klara qëndronte në fund të kuzhinës duke tundur kokën, duke psherëtirë, më të shumtën gati për të qarë. Atëherë ajo thoshte: "Prisni", kthehej edhe një herë në kuzhinë dhe vinte me një broke plot me salcë: salca ishte e verdhë squfur, aq e

verdhë si dielli në tablotë e piktorëve shkarravitës. Dhe ne e hanim supën, e hanim pudingun e hanim salcën dhe prisnim që sporteli të hapej sërish: nganjëherë kishte dehe ndonjë copë bukë. Njëherë në muaj kuzhinierja Klara na ndante racionin e saj të cigareve. Secili merrte një ose dy nga këta stapinj të bardhë e të shtrenjtë - por më të shumtën e herëve Klara e hapte sportelin vetëm për të na thënë, se s'kishte më gjë. Çdo muaj ndërroreshin grupet, që ajo ushqente në këtë mënyrë, dhe ne kalonim në grupin tjetër, që duhej të vinte katër herë në javë. Kjo ditë e katërt ishte e diel. Pra të dielave kishte ndonjëherë patate me mish të pjekur dhe unë e prisja aq me padurim fundin e muajit për të kaluar në grupin tjetër, aq me padurim se ai i burgosuri që mezi pret fundin e burgosjes së tij.

Qysh atëherë e urreja fjalën "i leverdishëm" sepse e dëgjoja gjithmonë nga goja e tim ustai: Vikveberi bënte pjesë në ata njerëz që mund t'i quash të ndershëm. Ishte i zoti, kishte haber nga zanati dhe në mënyrën e tij ishte madje babaxhan. Unë isha a s'isha gjashtmbëdhjetë vjet kur u futa çirak tek ai. Atëherë ai kishte dy ndihmës dhe katër çirakë; përveç këtyre kishte dhe një usta, por ky më të shumtën rrinte në fabrikën e vogël që Vikveberi sa e kishte hapur atëherë. Vikveberi ishte trupmadh, i shëndoshë dhe i qeshur dhe bile as përsipirtshmërisë së tij s'i mungonin tiparet simpatike. Sefte thjesht nuk e doja, por pas dy muajve fillova ta urrej vetëm për shkak të duhmave që vinin nga kuzhina e tij: binte erë gjërash, që s'i kisha shijuar kurrë: byrekë të porsapjekur, mish të pjekur, sallo të nxehtë dhe kjo bagëti që rrëmonte brenda rropullive mia, uria - për atë këto grahma ishin të padurueshme: ai i jepte fort trupit përpjetë, unë inatosesha dhe kështu filloia ta urreja Vikveberin, sepse me dy feta bukë të mëlmjera me marmelatë të kuqe e të ngjitura bashkë shkoja në mëngjes në punë e gjithashtu me një enë plot me supë të ftohtë, që lipsej ta ngrohja në ndonjë kantier ndërtimi, por që e kollofitja në më të shumtën e herëve rrugës për në punë. Kur

pastaj sosja në punë, ena bosh rrapëllinte në çantën e veglave dhe kështu shpresoja se ndonjë kliente do të më jepte bukë, një pjatë supë ose diçka tjetër për të ngrënë. Të shumtën e herëve më jepnin diçka. Atëherë isha i ndrojtur, shumë i heshtur, një çapkën i gjatë e i hajthëm dhe askush nuk dinte diçka, nuk ndjente diçka prej ujku, që ekzistonte tek unë. Një ditë dëgjova një zonjë, që nuk dinte se e dëgjoja, tek fliste për mua: thoshte fjalë lavdëruese dhe në fund tha: "Duket shumë fisnik". Bukur fort, mendoja atëherë, pra, dukesh fisnik. Fillova të shihesha më me vëmendje në pasqyrën, që varej në dhomën e larjes së bujtinës: vështroja fytyrën time të zbehtë e gjatoshe, kërveshja buzët, pastaj i shpija sërish në vend dhe thosha me vete: këtë pamje ke, kur dukesh fisnik. Dhe kështu i thosha me zë të lartë fytyrës sime atje në pasqyrë: "Dua diçka për të ngrënë..."

Atëherë im atë shkruante se do të vinte për të parë sesi jetoja, por nuk erdhi. Kur isha në shtëpi, ai më pyeste si ishte në qytet dhe unë duhej t'i tregoja për tregun e zi, për bujtinën, për punën time. Atëherë tundte kokën i dëshpëruar dhe kur i tregoja për urinë që ndjeja - nuk i flisja shpesh për këtë, por nganjëherë më shpëtonte goja - im atë vraponte në kuzhinë dhe merrte gjithçka për të ngrënë, që ishte atje: mollë, bukë, margarinë. Nganjëherë ai rrinte atje dhe priste patate të ftohta, i hidhte në tigan dhe më përgatiste patate të fërguara. Njëherë doli nga kuzhina me një lakër të kuqe dhe tha: "Kjo është e githa, që munda të gjeja - besoj se mund të bësh sallatë me këtë lakër". Por kurrë nuk kisha shijuar diçka. Kisha ndjenjën se kisha bërë një padrejtësi apo isha shprehur gabim, kur kisha përshkruar punët në qytet në një mënyrë që s'përputheshin me të vërtetë. I tregova çmimet e bukës, të gjalpit dhe të qymyrit dhe im atë trembej çdo herë, por gjithashtu çdo herë dukej se i kishte harruar ata përsëri, por nganjëherë më dërgonte para dhe më shkruante që të blija me to bukë. Kur më vinin paratë, shkoja tek tregu i zi dhe blija një karavele taze dy ose trepfundëshe, ulesha me të në derë

në një stol apo diku në gërmadha, e thyeja më dysh dhe e haja me duart e pista duke i këputur e futur copat në gojë. Nganjëherë ajo ende lëshonte avull, ishte brenda krejt e ngrohtë. Për disa çaste kisha ndjenjën sikur mbaja në duar një qenie të gjallë, sikur e copëtoja dhe kështu sillja ndër mend atë burrin, që na kishte mbajtur atë referatin për ekspeditën e Polit të Veriut dhe na kishte rrëfyer sesi copëtonin peshq të gjallë dhe po të gjallë i kollofitnin. Shpesh e mbështillja një pjesë të bukës me gazetë, e fusja në çantën time të veglave. Por kur kisha çapitur njëqind hapa, qëndroja, e çmbështillja dhe e kollofitja pjesën e mbetur në mes të rrugës. Kur ishte bukë trefundëshe ndjehesha aq i ngopur sa që ia jepja në bujtinë bukën time të mbrëmjes një tjetri dhe vetë shtrihesha menjëherë në krevat. Rrija ashtu shtrirë, i mbështjellë me batanije vetëm atje lart në dhomën e gjumit, mbushur barkun plot me bukë të ëmbël, taze, thuajse me ndija të topitura nga të ngopurit. Ishte ora tetë e mbrëmjes dhe kisha për të bërë njëmbëdhjetë orë gjumë, se dhe gjumin nuk e bëja tamam. Ndoshta tim eti s'i bëhej vonë atëherë për asgjë përveç sëmundjes së nënës: kur isha në shtëpi përpiquesha sidoqoftë ta evitoja fjalën uri dhe të gjithë romuzet për shtrëngicën ku jetoja, se e dija e gjithashtu e shikoja se babai kishte shumë më pak për të ngrënë sesa unë: vinte verdhacuk në fytyrë, thatanik dhe i përhumbur. Ne shkuam pastaj të shikonim nënën. Edhe ajo më ofronte gjithmonë diçka për të ngrënë, kur ulesha e rrija në krevatin e saj; më ofronte gjëra, që i kishte kursyer nga vaktet e ngrënies, ose që ia kishin dhënë vizitorët: fruta apo një shishe me qumësht, një copë byrek, por s'mund të haja, sepse e dija që ajo ishte e sëmurë nga mushkëritë dhe duhej të hante mirë. Por ajo ngulmonte duke më thënë se ato ushqime do të prisheshin, po të mos i haja dhe im atë i thoshte: "Klere, duhet të hash duhet të shërohesh përsëri". Ime ëmë qante, anonte kokën mënjanë dhe nga ato gjëra që më ofronte nuk mund të haja asgjë. Pranë saj ishte një grua, në sytë e së cilës pashë atë diçka prej ujku dhe e dija se ajo do t'i

hante të gjitha, që kishte lënë nëna. Ndjeva duart e ngrohta të im mëje në krahun tim dhe pashë në sytë e saj frikën nga nepsi i fqinjës së saj. Nëna mu përgjërua dhe më tha: "Djalë i dashur, haj, e di që ke uri, e di si qëndrojnë punët në qytet". Por unë tundja vetëm kokën, ia hiqja duart nënës nga krahu dhe i përgjërroheshja të mos më lutej më. Ajo vinte buzën në gaz, nuk e zinte më në gojë të ngrënë dhe e dija që më kishte kuptuar. I thashë: "Ndoshta do të ishe më mirë në shtëpi, ndoshta do të ishe më mirë në një dhomë tjetër, por nëna ma priste: "Nuk ka dhoma të tjera dhe të shkoj në shtëpi nuk më lënë, se jam e infektuar." Më vonë kur folëm me mjekun, im atë dhe unë, fillova ta urrej këtë për shkak të indiferencës që tregonte; Ai mendonte diçka tjetër, ndërsa fliste me ne, vështronte nga dera apo nga dritarja, kur u përgjigjej pyetjeve të tim eti dhe nga buzët e tij të kuqe, që dridheshin butësisht e kuptova se nëna do të vdiste. Por gruaja në krevatin fqinj me nënën time vdiq më parë. kur vajtëm në spital të dielën në drekë, ajo sa kishte vdekur. Krevati ishte bosh dhe i shoqi, që sapo e kishte marrë lajrnin e vdekjes, erdhi në dhomën e të sëmurve dhe mblodhi në dollapin e natës sendet e saj: karfica flokësh, një kuti pudre, të linjtat dhe një kuti me shkrepëse. I mblodhi të gjitha këto gojëkyçur dhe shpejt e shpejt, pa na përshëndetur ne. Ishte një burrë i vogël, thatanik, dukej si një mlysh, kishte një lëkurë të errët dhe sy të veckël, krejt të rrumbullt dhe, kur erdhi infermierja e pavijonit, ai zuri të bërtiste për një kuti mishi, që nuk e kishte gjetur në dollapin e natës. "Ku është Corned beef³? - bërtiti kur erdhi infermierja. "Ia solla dje, dje mbrëma, kur erdha nga puna, në orën dhjetë dhe meqë vdiq natën s'do mend që s'e ka ngrënë". Ai tundte karficat e flokëve të së shoqes në fytyrë të infermieres, në shtjekë të buzëve i ishte mbledhur shkumë e verdhë. Vazhdonte të bërtiste paprerë: "Ku është mishi? Dua mishin - do ta shkatërroj të tërë këtë karakatinë, po s'më dhatë kutinë e mishit". Infermierja, u skuq, zuri të bërtiste dhe nga shprehja e fytyrës e

³ *Corned beef* = *kuti mishi*

kuptova se ajo e kishte vjedhur kutinë me mish. Burri, po bubullinte, i hodhi sendet e mble-dhura në dysheme, i shkeli ata me këmbë dhe bërtiste: "Dua mishin, moj kurva, moj hajdute e vrasëse". Kjo zgjati vetëm pak sekonda, doli në korridor babai për të marrë dikë dhe unë vajta e qëndrova midis infermieres dhe burrit, sepse ky filloi ta godiste infermierën; por ai ishte i vogël dhe i shkathët, shumë më i shkathët se unë dhe munda ta godiste atë në gji me grushtat e vogla e të errët. Pashë sesi zgërdhihej nga inati që ndjente, me dhëmbë të skërmitur siç kisha parë kështu minjtë, që kuzhinierja e bujtinës kishte kapur me çark. "Mishin, moj sokollomë", bërtiste - "mishin" - derisa erdhi im atë me dy roje, që e kapën dhe e tërhoqën në korridor, por edhe me derë të mbyllur e dëgjuam tek thërriste: "Dua mishin, mor hajdut".

Kur jashtë ra qetësia, u vështruam në sy dhe nëna tha e qetë: "Çdo herë që vinte, ata grindeshin për paratë, që ajo jepte për të blerë ushqime. Gjithmonë i thërriste dhe i thoshte se çnimet ishin rritur sërish por ajo nuk i besonte. Ishin palavi ato që i thoshin njëri-tjetrit, por ajo i jepte përsëri para". Nëna heshtte, vështronte krevatin e të ndjerës dhe thoshte ultas: "Kishin 20 vjet, që ishin martuar e rrinin bashkë dhe djali i tyre i vetëm ishte vrarë në luftë. Nganjëherë merrte fotografinë nën jastëk dhe qante. Është akoma atje së bashku me paratë. Ai nuk e gjeti. Dhe mishin - tha ajo akoma më ultas "mishin e kishte ngrënë". Dhe unë përpiqesha ta përfytyroja si kishte ndodhur kështu: Si gruaja e zeshkët e nepsqare, tashmë në agoninë e vdekjes, shtrihej aty në krevatin pranë sime mëje dhe si hante mishin e kutisë.

Babai më shkruante shpesh në vitet pas vdekjes së nënës, gjithnjë e më shpesh dhe letrat sa vinin e bëheshin gjithnjë, e më të gjata. Më të shumtën shkruante se do të vinte për të parë si jetoja, por nuk erdhi kurrë dhe kështu jetova shtatë vjet vetëm në qytet. Atëherë, pas vdekjes së nënës, më tha që ta këmbëja vendin e punës, duke

kërkuar një tjetër në Knohta, por mua ma kishte qejfi të rrija në qytet, sepse tani kisha filluar ta gjeja vetveten, kisha filluar t'u bija në të hileve që bënte Vikveberi dhe se kishte rëndësi që t'i mbaroja studimet tek ai, gjithashtu kisha njohur një çupë, që quhej Veronika. Ajo punonte në zyrën e Vikveberit, ishte bionde dhe i ndrinte nuri. Kisha qenë shpesh me të. Ne mbrëmjet e verës shëtisnim bashkë buzë Rinit ose hanim akulllore. E puthja kur rrinim në errësi të fare poshtë në gurët e kaltër prej bazalti të murit të skelës, ku këmbët e zhveshura vareshin në ujë. Kur netët ishin të qarta dhe e shikonim lumin, dilnim me not jashtë një anijeje të fundosur, që ishte në mes të lumit dhe uleshim në stolin e hekurt, në të cilin mbrëmjeve më parë rrinin lundërtari me të shoqen. Banesa, që ishte prapa stolit kishte kohë që ishte çmontuar, ne mundëm të mbështeteshim pas një shufre hekuri. Poshtë nën anije gurgullonte uji. Që kur e bija e Vikveberit kishte filluar punën në zyrë dhe Veronika ishte pushuar, kisha filluar ta takoja më rrallë këtë të fundit. Pas një viti Veronika u martua me një të ve, që kishte një dyqan qumështi, jo larg rrugës ku banoj tani. Kur makina ime riparohet dhe udhëtoj me tramvaj, e shoh Veronikën atje prapa në dyqanin e saj: ajo vazhdon të jetë bionde dhe shend e verë, por në fytyrën e saj shoh të shtatë vitet, që kanë kaluar që atëherë. Ajo është shëndoshur dhe atje prapa në oborr varen në një galmë të linjta fëmijësh: ato në ngjyrë të trëndafiltë janë të një çupke të vogël dhe ato blu janë të një djalke. Një ditë dera ishte hapur dhe e pashë Veronikën atje prapa dyqanit ku me duart e saj të gjata e të bukura zbrazte qumësht. Kohë më kohë më sillte bukë nga një kushëri, që punonte në një fabrikë buke. Ajo kishte ngulmuar që unë duhej të ushqehesha dhe çdo herë kur më jepte ndonjë copë bukë, i kisha ato duar mu afër syve. Por një herë i tregova unazën e sim mëje dhe në sytë e saj pashë po atë dritë nepsqare që kishin sytë e gruas, që rrinte pranë nënës atje në spital.

Këto shtatë vjet i kam mësuar çmimet saktësisht për ta dashur ende fjalën "i leverdishëm": asgjë s'është e leverdisshme dhe çmimet e bukës janë gjithmonë pakëz si të lartë.

E kisha gjetur rrugën, siç thuhet kështu: i zotëroja dijet e mia speciale aq mirë, sa që nuk isha më prej kohësh për Vikveberin një fuqi punëtore e leverdishme, siç kisha qenë tre vjet rresht. Kam një veturë të vogël bile e kam blerë dhe kam kursyer prej vitesh për kaucionin⁴, që doja ta kisha gati për t'u bërë e pavarur nga Vikveberi dhe që të mundja të ndryshoja për konkurrencë në çdo kohë. Më të shumtët e njerëzve, me të cilët kam të bëj, janë të dashur me mua, edhe unë me ata. Çdo gjë është krejt në rregull. Kam çnirnin tim vetjak, atë të duarve të mia, të njohurive të mia teknike, atë të një farë përvoje, atë të komunikimit tim të dashur me klientët (se e lëvdojnë Charme-n tim dhe sjelljen time të përkryer, që më sjell veçanërisht dobi, meqënëse jam gjithashtu përfaqësues i atyre njerëzve, që i kam mësuar të riparojnë në errësirë) - këtë çmim kam mundur ta rrit gjithnjë e më shumë, çdo gjë më vete si jo më mirë dhe çmimi, i bukës ndërkaq është balancuar — siç i thonë fjalës. Punoja dymbëdhjetë orë në ditë, flija tetë orë dhe mbeteshin katër orë që të isha më nge: takohesha me Ulën, të bijën e shefit tim, me të cilën nuk isha fejuar, sidoqoftë jo në formën që e quanin zyrtare, por ama, ekzistonte një mendim i pashprehur se do të martohesha me të...

Por infermierja e spitalit, Vincenc, Klara, që më jepte supë, Bukë, puding të kuq flakë dhe salcë të verdhë shafran, që gjithsej më ka falur njëzet cigare pudingë që sot nuk më shijojnë më, cigare, që sot s'do të pija më pra, Klara, infermierja, që ka kohë që prehet në varrezën e murgeshave, kujtimit të fytyrës së saj të buhavitur dhe i syve të trishtuar e të ujhëm kur duhej ta mbyllte përfundimisht sportelin asaj i përket më shumë dhimbsuri se të gjithë atyre, që i njihja kur dilja me Ulën: në sytë, në duart e tyre lexoja të shkruar çnimet që duhej t'ju

⁴ Kaucion – shumë parash që është e nevojshme për përgjegjësi zhdëmtuese.

paguaja: e mërgova tej vetes Charme-n, ua hoqa atyre tej kostumet dhe grahmat, këtë madhështi të tërë, që është kaq e leverdishme... dhe zgjova atë diçka prej ujku që vazhdonte gjithnjë të flinte tek unë, urinë, që më mësonte çmimet e bukës: e dëgjoja atë të hungëronte kur në vallëzim e sipër e vija kokën në supet e një vajze të bukur; dhe shikoja duart e hijshme e të vogla që preheshin në krahun tim, në supet e mia tek ktheheshin e bëheshin kthetra, që do të ma hiqnin bukën nga dora. jo shumë veta më kanë dhuruar diçka: babai, nëna dhe nganjëherë vajzat e fabrikës.

II

E fshiva briskun tim të rrojës me një nga ato letërthithëset, prej të cilave gjithmonë kam varur pranë lavamanit një bllok të tërë. Përfaqësuesi i firmës së sapunit m'i dhuron ato: goja e kuqe gjak e një gruajë është shtypur në këto letra dhe nën gojën gjak të kuqe lexohet: Ju lutemi, mos e fshini të kuqtë e buzës me peshqir. Ka dhe blloqe të tjerë, në letrat e të cilëve shikon një dorë burri që pret me një brisk rroje një peshqir dhe në këto letra është shtypur: Merrini këto letra për briskun tuaj të rrojës - por unë parapëlqej për përdorim letërthithëset me gojën e kuqe gjak dhe të tjerat ia dhuroj fëmijëve të pronares sime.

Mora rrotën me kablo, që Volfi e kishte sjellë qysh në mbrëmje si dhe lekët nga tryeza e shkrimit ku i lë në mbrëmje, pasi i heq nga xhepat, dhe, kur dola nga dhoma, ra zilja e telefonit. Pronarja tha përsëri: "Po, do t'ia them" - pastaj i hodhi sytë nga unë dhe më zgjati gojëkëqur dorezën e telefonit. Tunda kokën, por ajo bëri me kokë me aq seriozitet sa që unë shkova atje dhe mora dorezën. Një zë qaraman

gruaje tha diçka nga e cila kuptova vetëm "Kurbelstrasse ejani - ejani ju lutem. Unë i thashë: "Po, po vij" dhe gruaja që qante tha përsëri diçka nga e cila kuptova vetëm "Grindje, im shoq, ju lutem, ejani menjëherë". Thashë përsëri: "Po, po vij" dhe e mbylla telefonin.

"Mos harroni lulet" — tha pronarja "dhe mendoni dhe për hajen. Është pikërisht vakti i drekës".

I harrova lulet. Po kthehesha nga një rrethinë e largët e qytetit, megjithëse kisha për të bërë në një lagje fqinjë edhe një riparim dhe kështu mund t'i llogarisja kilometrat e bërë dhe kohën e udhëtimit dy herë. Ecja shpejt, sepse ora ishte njëmbëdhjetë e gjysmë dhe treni erdhi më 11.47. E njihja këtë tren: kthehesha shpesh me të të hënave, kur vizitoja babanë. Rugës për në stacionin e trenit përpiqesha ta përfytyroja vajzën si ishte.

Këtu e shtatë vjet më parë, kur po kaloja vitin e fundit në shtëpi, e kisha parë disa herë. Atë vit kisha qenë tamam dymbëdhjetë herë në shtëpinë e Mullerve: një herë në muaj për t'i dhënë fletoret e reja gjuhësore të punës, që im, atë i lexonte rregullisht. Në faqen e fundit, në qenarin e poshtëm dukeshin pastërtisht nënshkrimet e tre filologëve të rinj: Mu - ky ishte Mulleri; zbk - Zubaneku dhe Fen - ishte nënshkrimi i tim eti, që më kish lënë trashëgim mbiemrin Fendrih. Më qartë më kujtoheshin pllangat e errëta të shtëpisë së Mullerve: suvaja jeshile tregonte gjer në dritaret e katit përdhes re të zeza igrasie, që ishte ngjitur lart; figura fantastike, që më dukeshin gjithmonë si harta të një atlasit misterioz: në behar ato thaheshin në qenarët e mureve dhe qarkoheshin nga kurora të bardha si lepra. Por megjithë të nxehtit e beharit këto re mbartnin një bërthamë të errët në gri. Në vjeshtë dhe në dimër igrasia hapej e kalonte këta qenarë leprozë si një njollë boje që hapet e zezë dhe e athët në letërthithëse. Gjithashtu mbaja mend mirë punën shkel e shko të Mullerve, çibukun e tij të gjatë, shpinën e lëkurtë të librave dhe fotografinë në korridor, që tregonte Mulerin, burrë të ri, me një kasketë

të larme studenti dhe poshtë kësaj fotografie dukeshin spërdredhjet e Teutonisë ose të një Onie tjetër. Nganjëherë shikoja djalin e Mulerve, që ishte dy vjet më i vogël se unë dhe dikur kishte qenë në një klasë me mua; por tani kishte kohë që ishte ngjitur më lart se unë. ishte kockëfortë, i qethur shkurt dhe dukej si një kotorr. Nuk rrinte me mua më shumë se një rminutë se ishte një djalosh i sjellshëm. Ndoshta i vinte rëndë të rrinte me mua, sepse e kishte të vështirë të më thoshte të gjitha ato për të cilat besonte se duhej të më preknin: keqardhje, fodullëk dhe atë shkueshmëri të rëndë e artificiale. Kështu, kur takoheshim, kufizohej vetëm duke më thënë me një zë të ngjirur "Mirëdita" dhe duke më treguar rrugën për tek dhoma e babait të tij. Dy herë vetëm pashë një çupkë të vogël dymbëdhjetë a trembëdhjetë vjeç. Herën e parë që e pashë luante me kokrra bosh të luleve në kopsht. Pranë murit me myshk jeshil kishte vendosur vazo të thata dhe të kuqe në të çelur në formë piramide dhe, kur një zë gruaje thirri "Hedvig" u hodh përprjetë e trembur. Dukej se frika, që ndjeu, i kaloi stavës me saksu lulesh, se saksia në majë të piramidës u rrokullis teposhtë dhe u bë copë e çikë në çimenton e lagësht e të errët, me të cilën qe shtruar oborri.

Herën e dytë, që e pashë, ishte në korridor, i cili të çonte në dhomën e Mulerëve: ajo kishte rregulluar në një shportë teshash një krevat për një kukull. Ca flokë ngjyrë të çelët binin mbi zverkun thatanik prej fëmije, që mu duk thajse jeshil atje në treme dhe e dëgjova tek mërmëriste për kukullën e padukshme një melodi të panjohur për mua. Në këtë melodi ndërkalte në intervale të caktuara një fjalë të vetme: Suveija - su - su - su - Suveija dhe, kur kalova pranë saj në rrugën që të çonte në kthinën e Mulerëve, ajo ngriti sytë dhe unë mund t'ia shihja fytyrën: një fytyrë e zbehtë, thatanike dhe flokët biondë i binin me cullufë në fytyrë. Kjo ishte ajo, Hedviga, për të cilën kisha zënë një dhomë.

Një dhomë të tillë si kjo, që i zura bijës së Mulerëve e kërkojnë në qytetin tonë ndoshta njëzet mijë njerëz. por dhoma të tilla kishte vetëm dy ose vetëm një dhe ajo zihet me qera nga një prej atyre engjëjve të panjohur, të cilët herë pas here humbasin mes njerëzve - e kam një dhomë të tillë, e kam gjetur atëherë kur i lutesha tim eti për të më marrë nga bujtina e çirakëve.

Dhoma ime ishte e madhe, e pajisur me ca orendi të pakta të vjetra, por komode dhe këto katër vitet që banoj në të mu dukën shekuj të tërë: i kam jetuar lindjet e fëmijëve të pronares sime, jam bërë nun i më të voglit, sepse isha unë që vajta natën dhe e mora maminë. Për javë të tëra i kam ngrohur që pa gdhirë Robertit qumështin, i kam dhënë shishen, sepse pronarja, e raskapitur nga punët e natës, ngrihej vonë në mëngjes dhe mua nuk më bënte zemra që ta zgjoja. I shoqi është një nga ata që i vleinë botës si artistë, një nga ata që kanë dështuar në jetë: ai ankohet me orë të tëra për rininë e humbur kot, që gjoja ia kishte vjedhur lufta. "Ne u mashtruam - thotë ai "u mashtruam në vitet më të mirë që ka jeta e një njeriu, vitet nga njëzet deri në njëzet e tetë". Kjo rini e humbur i shërben atij si alibi për gjithfarë marrëzish, që e shoqja jo vetëm ia fal, por edhe e ndihmon t'i bëjë: ai pikturon, bën projekte shtëpish, kompozon... Asnjë nga këto sidoqoftë kështu më duket - nuk e bën siç duhet, megjithëse herë pas here këto i sjellin para. Në dhomat e shtëpisë varen gjithandej projektet e tij: "Shtëpi për një shkrimtar në lartësitë e Taunusit" - "Shtëpi për një skulptor". Të gjithë këta projekte gjelojnë nga pemët, që kanë pikturuar arkitektët dhe unë i urrej ato pemë, sepse ka pesë vjet që i shoh përditë. I gëlltit këshillat e tij, siç gëlltiten ilaçet që të jep një doktor mik. "Në këtë qytet" thotë ai "në këtë qytet kam jetuar vetëm si Ju dhe në moshën tuaj dhe aty më është dashur të kaloj rreziqe, që Juve nuk do t'jua uroja". Dhe e di se e ka fjalën për lagjen e lavireve.

I shoqi i pronares është goxha i dashur, por - kështu më duket mua një kërraç, që ka vetëm aftësinë për të ruajtur dashurinë e së shoqes, së cilës i fali fëmijë të lezetshëm. Pronarja ime është e gjatë dhe bionde dhe një farë kohe kisha rënë në dashuri me të aq shumë, sa që fshehurazi i puthja përparësen, dorezat. Nga xhelozia që kisha nga ai matufi, burri i saj, nuk mund të flija. Por ajo e do dhe më duket se një burrë nuk ka nevojë të jetë i zoti dhe i suksesshëm për t'u dashuruar nga një grua e tillë, që unë vazhdoj ta admiroj ende. Shpesh ai më kërkon borxh pak marka për të shkuar në një nga ata lokale artistësh, ku mbahet me të madh me kollaren ekstravagante dhe flokët e pakrehur, duke boshatisur një shishe të tërë raki dhe unë i jap para se nuk mund ta ofendoj dot të shoqen duke e poshtëruar kështu. Ai e di pse i jap para, sepse zotëron atë dinakëri, pa të cilën përtacët do të vuanin urie. Ai është një nga ata dembelë, që dinë të marrin pamjen e improvizuesve të mëdhenj, por unë as që e besoj, që ai di të improvizojë me të vërtetë.

Më dukej gjithmonë sikur kisha shtënë në dorë një nga ato dhoma, nga të cilat ka vetëm një dhe u çudita aq më shumë, që gjeta për të bijën e Mullerëve një kthinë thujse po aq të mirë në qytet brenda në një shtëpi ku kam për të vëzhguar makinat e një salloni larës: kontrolloj pjesët e gomta për fortësinë e tyre, përtërit përcjellësit, përpara se ata të copëtohen, përforcoj vidhat, përpara se ato të lirohen fare. E dua qytetin brenda, këto lagje që në pesëdhjetë vjetët e fundit i kanë ndërruar pronarët dhe banort e tyre si një frak që së pari vishet për dasmë dhe më pas mbahet nga një ungj varfanjak, që ka ditur të sigurojë si muzikant një fitim të dytë, që është ndërruar nga trashëgimtarët e tij dhe jo i liruar me pagesë dhe, së fundi, në zyrën e pengjeve blihet nga një huajtës kostumesh, i cili ua huazon me çmim të përkorë patricëve varfanjakë, që ftohen befasisht për pritjen e ndonjë ministri, shtetin e të cilit e kërkojnë më kot në altarin e birit të tyre të vogël.

Atje, në shtëpinë ku tani është salloni larës kisha gjetur për çupën e Mulerëve një kthinë, që i plotësonte thujtë të gjitha kushtet e saj. Kthina ishte e madhe, e mobiluar jo keq, kishte një dritare të madhe, që e le të lirë vështrimin në një nga kopshtet e vjetër të patricëve. Këtu në mes të qytetit sundonte në mbrëmje pas orës pesë një atmosferë e qetë dhe e paqme.

E mora dhomën me qira me 1 Shkurt, por më dolën telashe, sepse Muleri më shkroi në fund të janarit se e bija ishte e sëmurë dhe do të vinte vetëm më 15 mars, se a do të mund ta mbaja dhomën të lirë, dhe, se qiraja do të paguhej. I shkrova një letër plot inat duke i sqaruar kushtet e banimit në qytet dhe më pas u turpërova se mu përgjigj ulët dhe e tregoi veten të gatshëm ta paguante qiranë për gjashtë javë.

Nuk më kishte shkuar në mendje vajza, isha siguruar vetëm që Muleri e kishte paguar qiranë. Ai e kishte dërguar dhe kur e pyeta për këtë, pronarja më pyeti nga ana e saj, atë që tashmë më kishte pyetur kur e pashë dhomën. "Mos e kini gjë shoqe, ë?

"O zot" - thashë i zemëruar- "Ja ku po ua them se nuk e njoh fare vajzën".

"Nuk duroj dot që..." - tha ajo.

"E di" i thashë unë "çfarë nuk duroni dot, por ja ku po jua them se nuk e njoh.

"Bukur fort", tha ajo dhe unë fillova ta urrej nga ngërdheshja e fytyrës së saj. "Pyeta vetëm sepse me të fejuarit bëj herë pas here ndonjë përjashtim."

"O zot" thashë unë "Edhe kjo na duhej. Ju lutem qetësohuni". Por ajo nuk po qetësohej.

Vajta disa minuta me vonesë në stacion dhe, ndërsa po hidhja groshin në automatin e biletës së peronit, po përpiqesha të sillja ndër mend çupën, që atëherë kishte kënduar "Suveija", kur po shpija përmes korridorit të errët në kthinën e Mulerëve fletoret e reja, gjuhësore të

punës. Qëndroja në shkallën e peronit dhe mendoja: bionde, njëzetvjeçare, vjen në qytet për t'u bërë mësuese. Kur po shikoja njerëzit, që kalonin para meje, mu duk sikur bota ishte mbushur plot me çupa bionde, njëzetvjeçare - kaq shumë po vinin nga ky tren. Të gjitha kishin valixhe në dorë dhe dukeshin sikur vinin në qytet për t'u bërë mësuese. Isha tepër i lodhur për t'i folur ndonjëres prej tyre, ndera një cigare dhe shkova në anën tjetër të hyrjes dhe pashë prapa parmakëve një çupë që ishte ulur mbi valixhe, një çupë që gjithë kohën kishte ndenjtur prapa meje. Ajo kishte flokë të errët, pardesynë e kishte aq jeshile sa bari që në një natë të ngrohtë me shi shpërthen e rritet përpjetë. Ajo ishte aq jeshile saqë mu duk se binte erë bar. Flokun e kishte ngjyrë të errët, siç janë çatitë me rrasa shisti pas shiut, fytyrën të bardhë thuajse të bardhë verbuese si gëlqerja e freskët, përmes së cilës vezullonte si okër. Mendoja se i lyente buzët me të kuq, por nuk ishte kështu. shikoja vetëm atë mantelin e jeshilët verbues, shikoja atë fytyrë dhe papritur më zuri frika, ajo frikë, që ndjejnë zbuluesit kur shkulin në tokën e re, duke e ditur, se një ekspeditë tjetër po vjen, që ndoshta e ka ngulur tashmë flamurin dhe që e ka zaptuar atë vend, zbulues, që duhet të kenë frikë se mundimet e rrugës së gjatë të gjitha sfilitjet, loja për jetë a vdekje mund të jenë të kota.

Ajo fytyrë mu fut thellë brenda, depërtoi mes përmes si një prerës, që në vend të kallëpit të metalit të çmuar has në dyllë dhe dukej, sikur po shpohesha mepërmes pa derdhur gjak. Për një çast të marrë kisha dëshirën që ta shkatërroja atë fytyrë si ai piktori që do të shkatërrojë gurin prej të cilit ka marrë vetëm një mostër të vetme.

E lashë cigaren të më binte nga dora dhe bëra gjashtë hapat e gjerësisë së shkallës. Frika më iku kur qëndrova para saj dhe i thashë: "A mund të bëj diçka për Ju?"

Ajo buzëqeshi, tundi kokën dhe tha "Oh, po, mund të më thoni ku është Judengase?"

"Judengase" - thashë unë dhe mu duk sikur dëgjoja të më thërrisnin emrin në ëndërr, pa e ditur se ishte emri im. Nuk isha në vete dhe mu duk, sikur e kuptoja çdo të thoshte të mos ishe në vete.

"Judengase" - thashë unë "po, Judengase. Ejani. Pashë si u ngrit, pakëz e çuditur, mori valixhen e rëndë dhe isha si i turbulluar tek mendoja se duhej ta mbaja në krahë. Isha shumë larg mirësjelljes së duhur. Njohja, që në këtë çast s'e kisha bërë aspak, vetëdija se ajo ishte Hedvig Mulleri, që duhej të më vinte si një gjë e vetëkuptueshme, kur tha "Judengase", më bëri thuajse si të marrë. Diçka ishte ngatërruar apo bërë rrëmujë: isha aq i sigurt se çupa e Mulerëve ishte bionde , se ishte një nga ato kandidatë të panumërta bionde për lektore, që kishin kaluar para meje, saqë këtë çupë nuk munda ta identifikoja dot me atë. Edhe sot më lindin shpesh dyshime, në është apo jo Hedvig Muleri dhe këtë emër e them vetëm me ngurrim, sepse më duket se duhet ta gjej emrin e saj. "Po, po" thashë kur pashë vështrirnin e saj pyetës, "ejani" dhe e lashë të kalonte me valixhen e rëndë përpara, duke u ndjekur pas gjer te postblloku.

Në këtë gjysmë minute që e ndoqa pas më shkoi në mendje se do ta shtija në dorë dhe se për ta shtënë në dorë, do të shkatërroja gjithçka që do të më pengonte në këtë drejtim. E shikoja veten tek shkatërroja makina larëse, tek goditja me një çekiç dhjetë pfundesh. Shikoja shpinën e Hedvigës, qafën, duart e saj që ishin pa gjak nga valixhja e rëndë që mbante. Isha xheloz ndaj atij punonjësi të hekurudhës, që i preku një çast dorën Hedvigës, kur i zgjati biletën pesë pfenigëshe - xheloz ndaj truallit të stacionit ku ajo shkelte me këmbët e saj. Kur arritëm thuajse në daljen e stacionit, më vajti mendja t'ia merrja valixhen. "Më falni" thashë unë, kërceva pranë saj dhe ia mora valixhen nga dora. "Gëzohem" tha ajo "që erdhët e më morët në stacion". "O zot" thashë "më njihkeni? "Natyrisht" tha duke qeshur "Fotografia juaj është në skrinin e babait Tuaj." "E njihni babanë tim?" "Po" tha ajo "e

kam pasur mësues". E shtyva valixhen prapa në makinë, e vura çantën pranë saj dhe e ndihmova të hipte. Kështu mbajta për herë të parë dorën, llërën e saj: ishte një llërë topolake dhe e fuqishme dhe një dorë e gjatë, por e lehtë. Dora ishte e thatë dhe e freskët dhe, kur dola në anën tjetër, duke i rënë rrotull makinës, për t'u ulur në tirnon, qëndrova para radiatorit, hapja kapakun dhe bëja sikur shikoja makinën, por në të vërtetë vështroja atë që rrinte prapa xhamit: kisha frikë, jo më frikën se dikush tjetër do ta zbulonte dhe do të ma merrte, kjo frikë më kishte ikur, se nuk do të ikja që aty në anën e saj, këtë ditë jo dhe në ditët e shumta, që do të vinin, gjithë këto ditë, shumta e të cilave quhet jetë. Kisha një frikë tjetër, frikën se çfarë më priste: treni ku kisha dashur të hipja ishte gati për t'u nisur, ishte nën avull, bashkudhëtarët tashmë kishin hipur, sinjali ishte tërhequr lart dhe burri me kasketën e kuqe e kishte ngritur tashmë diskun e sinjalizimit. Të gjithë prisnin vetëm, që unë, që qëndroja në shkallë, t'i hipja shpejt, por këtë çast kërcëva poshtë. Solla ndër mend bisedat e shumta të hapura, që do të duhej t'i duroja dhe tani e kuptova se bisedat e hapura i kisha pasur gjithmonë zët: dërdëllitje të pafundme e pakuptim, peshimi absurd i fajit dhe i pafajësisë, qortime, krrakërritje, telefonata, letra, faji, që duhej t'i mbaja mbi shpinë fajin që unë tashmë kisha. Shikoja jetën tjetër, jetën krejt të përshtatshme, që ndiqte hullinë e saj si një makinë e komplikuar, e cila rrinte për dikë që nuk ishte më aty: Unë s'isha më aty. Vidhat liroheshin, pistonat ishin skuqur, pjesë teneqeje fluturonin në havadan dhe binte erë e djegur.

Kisha kohë që e kisha mbyllur kapakun, krahët i kisha mbështetur mbi llamarinën e radiatorit dhe përmes xhamit e vështroja vajzën në fytyrë, që ishte ndarë në dy pjesë të pabarabarta nga fshirësi i xhamave: më dukej e pakapshme që s'e kishte parë ende asnjë burrë sa e bukur ishte. Ende s'e kishte njohur asnjë: ndoshta ishte kështu që ajo u shfaq aty në çastin që e pashë unë.

Ajo më vështroi kur hipa në makinë dhe u ula pranë saj. Në sytë e saj pashë frikën se çdo të thosha se ç'do të bëja tani, por unë s'thashë asgjë, vetëm nisa gojëkyçur makinën për në qytet. Vetëm nganjëherë kur ktheja makinën djathtas, shikoja profilin e saj anash. Edhe ajo më shikonte. Po udhëtoja për në Judengase, shpejtësinë e makinës e kisha ulur për të ndaluar para shtëpisë ku do të banonte. Por nuk dija ç'të bëja kur të qëndronim, të zbrisja dhe të shkoja te shtëpia. Kështu kalova përmes Judengasse, e rrotullova gjysmën e qytetit me të në makinë, dola përsëri nga stacioni dhe kova rrugës për në judengase edhe një herë. Dhe kësaj here qëndrova.

Nuk thashë gjë kur e ndihmova të zbriste duke e zënë nga dora e madhe e kur ndjeva në dorën time të majtë llërën e saj topolake. Mora valixhen shkova drejt derës së shtëpisë, i rashë ziles, ktheva kokën dhe e pashë kur po vinte me çantën në dorë. Me valixhen në dorë eca përpara, e vura këtë lart përpara derës së shtëpisë dhe e ndesha kur ajo po ngjiste me ngadalë shkallët me çantën në dorë. Nuk dija si t'i drejtohesha, se, si Hedvig ashtu dhe zonjusha Muler mu dukën për të emra të papërshtatshëm dhe kështu thashë: "Do të vij pas gjysmë ore t'ju marr për të ngrënë bukë, mirë?"

Ajo vetëm bëri me kokë, vështroi e menduar diku para meje dhe u duk sikur gëlltiti diçka. Nuk thashë më gjë, vrapova poshtë, u ula në makinë dhe u nisa pa e ditur se ku. Nuk e di në ç'rrugë kalova dhe çfarë mendoja, di vetëm se makina mu duk kaq pafundësisht bosh, makina, me të cilën kisha udhëtuar gjithmonë thujse vetëm, vetëm, në të rrallë me Ulan dhe përpiqesha të përfytyroja si kishte qenë para një ore, kur shkova në stacion pa atë.

Por nuk e gjeta më në kujtesë atë që kishte ndodhur më parë: e shikoja veten vetëm në makinën me të cilën udhëtoja për në stacion, ashtu siç shikon një vëlla binjak, me të cilin ngjan si dy pika uji, por që s'ke tjetër asgjë të përbashkët. Erdha në vete vetëm kur po shkoja drejt

një dyqani lulesh. Ndalova dhe hyra brenda. Brenda ishte freskët, binte erë e ëmbël lulesh dhe unë isha vetëm. Në dyqan duhej të kishte trëndafila jeshilë, thashë me vete, trëndafila me gonxhe jeshile dhe pashë veten në pasqyrë si nxora nga portofoli paratë - nuk e njoha menjëherë veten në pasqyrë dhe u skuqa, sepse mendimet i kisha shprehur me zë "Trëndafila jeshilë" e ndjeva veten tani të përgjuar - e njoha veten nga skuqja që më hipi në fytyrë dhe mendova: Kështu, pra, je me të vërtetë, dukesh me të vërtetë krejt fisnik. Nga sfondi i dyqanit erdhi një grua plakë, dhëmbët e vënë të së cilës buzëqeshnin dhe feksnin që nga larg: ajo kapërdiu poshtë edhe një kafshore nga dreka dhe pas kapërdimës buzëqeshja lodroi përsëri në fytyrën e saj dhe mu duk sikur bashkë me bukën ajo kapërdiu dhe buzëqeshjen. Nga fytyra e saj pashë se mua më fuste në grupin e klientëve të trëndafilave të kuq dhe ajo shkoi buzagaze drejt një buqete të madhe trëndafilash të kuq, në një kovë të madhe argjendi. Gishtat e saj ledhatonin lulet fare lehtësisht, kisha ndijimin e diçkaje që s'më përkiste. Mu kujtuan bordellot, për të cilat më kishte paralajmëruar zoti Brotig, burri i pronares sime. Papritmas e mora vesh pse rrija si në gjemba: më dukej sikur isha në një bordello, megjithëse nuk kisha shkelur kurrë në to.

"Të mrekullueshëm, apo jo? - ia bëri gruaja. Por trëndafilat e kuq nuk i doja, s'i kisha dashur kurrë. "Të bardhë" thashë me një zë të ngjirur - dhe ajo shkoi buzagaze te një kovë tjetër, të bronzte me trëndafila të bardhë. "Ah" ia bëri ajo "për dasmë".

"Po" – i thashë "për dasmë".

Kisha dy kartëmonedha dhe ca para të shkoqura në xhepin e xhaketës. I palosa duke i vënë në banak dhe thashë: ashtu siç i vendosja groshët në fëmijëri dhe thosha: më jep me këto para sheqerka -; Më jepni trëndafila të bardhë me këto... me shumë gjelbërim". Gruaja i mori paratë me gishtat majucë, numëroi mbi banak dhe llogariti në letrën pështjellëse, sa trëndafila merrja me ato para. Nuk buzëqeshte, kur

bënte hesapin, por, kur shkoi tek kova prej bronzi me trëndafilat e bardhë, papritur iu shfaq në fytyrë buzëqeshja, siç shfaqet papritur kapërdima. Ëmbëlsia e fortë, me të cilën që mbushur dyqani, më hipi papritur në kokë si një helm vrastar. Bëra dy hapa të mëdhenj drejt banakut i rmblodha paratë dhe dola jashtë.

Kërceva në makinë - dhe në të njëjtën kohë e pashë veten sikur kërceja nga një largësi e pafundme në makinë si dikush, që ka grabitur arkën e dyqanit, u nisa dhe kur pashë dyqanin para syve, mu duk sikur e kisha parë atë njëmijë vite njëri pas tjetrit një mijë herë në ditë dhe ora e stacionit tregonte dymbëdhjetë e dhjetë. Ishte dymbëdhjetë pa një çerek kur hodha groshin në automatën për biletën e peronit: besoja se ende e dëgjoja zhurmën që bëri automati kur gatiti groshin dhe kërcitjen e lehtë, qesëndisëse, me të cilën ai pështyni biletën prej kartoni. Ndërkaq kisha harruar kush isha, ç'pamje dhe ç'profesion kisha.

I rashë rrotull stacionit, qëndrova pranë qoshkut me lule përpara bankës së zanatçinjve, zbrita nga makina dhe bleva me tri marka tulipanë të verdhë: dhjetë tulipanë, i dhashë gruas edhe tre marka të tjera dhe mora dhjetë tulipanë të tjerë. I solla lulet në makinën, i hodha atje prapa, pranë çantës sime të veglave, kalova para qoshkut me lule drejt bankës së zanatçinjve dhe, kur nxora nga xhepi i brendshëm i xhaketës librin e çeqeve e shkova me ngadalë drejt pulsit të shkrimit para arkës, mu duk vetja pakëz qesharak. Edhe unë kisha frikë se mos nuk më jepnin paratë. Në anën e jashtme, jeshile të librit me çeqe kisha shënuar gjendjen e llogarisë 1710,80. E mbusha me ngadalë çekun, shkrova 1700 në kollonën e vogël lart djathtas dhe shkrova një mijë e shtatëqind prapa "më fjalë". Dhe kur shkrova poshtë çekut emrin tim: Valter Fendrih, mu duk vetja si dikush që bën një falsifikim çeku. Vazhdoja të kisha akoma frikë kur i dhashë vajzës pranë arkës çekun, por ajo e mori këtë pa më vështruar, e hodhi në një konvejer dhe më dha një numër të verdhë kartoni. Qëndrova te arka, pashë çequet që

ktheheshin nga një konvejer tjetër te arkëtari. Edhe çeku im erdhi shpejt, u habita kur arkëtari thirri emrin tim, i shtyva atij mbi pllakën e mermerit e të bardhë dokumentin prej kartoni dhe mora paratë: dhjetë qindëshe dhe katërbëdhjetë pesëdhjetëshe.

U çudita kur dola nga banka me paratë në xhep: ishin paratë e mia, i kisha kursyer. Nuk e kisha pasur të vështirë t'i kurseja, se kisha fituar mirë, por kolonat e bardha prej mermeri, dera e praruar, përmes së cilës dola jashtë, serioziteti i rreptë i fytyrës së portierit - të gjitha këto më sillnin ndijimin se i kisha vjedhur paratë e mia.

Por kur i hipa makinës, qesha dhe u ktheva shpejt në Judengase.

I rashë ziles së zonjës Grolta, e shtyva derën me kurriz kur u hap, dhe ngjita e lodhur e i dëshpëruar shkallët. Kisha frikë se ç' do të më ndodhte. E mbaja buqetën me lule poshtë në dorë si të ishte një thes letre me patate. Shkova drejt pa vështruar as majtas, as djathtas. Nuk e di çfarë shprehje kishte marrë fytyra e pronares kur e kalova përpara, se nuk e pashë.

Hedviga rrinte me libër në dorë te dritarja. E pashë menjëherë se nuk po lexonte: u përvodha pa zhurmë përmes korridorit gjer te dera e dhomës së saj dhe e hapa këtë - kaq pa u ndjerë siç i hapin hajdutët dyert (kurrë s'isha ushtruar për një gjë të tillë dhe kurrkund nuk kisha mësuar). Hedviga e mbylli librin dhe ky gjest i vogël ishte për mua aq paharrueshëm sa dhe buzëqeshja e saj. Ende edhe sot e dëgjoj përplasjen e dy pjesëve të librit. Bileta pesëpënjigëshe e trenit, që ajo e kishte vënë si shenjë në libër, fluturoi tej dhe as ajo, as unë, asnjëri nga ne të dy nuk u përkul për ta ngritur.

Qëndrova te dera, vështrova pemët e vjetra në kopsht, fustanet e Hedvigës, që ajo i kishte shpaketuar dhe hedhur pa kujdes në tryezë dhe karrige dhe në libër lexohej qartë e kuqe mbi gri: Teksti i pedagogjisë. Hedviga qëndronte midis shtratit dhe dritares duart i kishte varur poshtë të mbledhura thujse grusht si dikush që do t'i bjerë daulles, por s'ka

marrë shkopinjtë. E shikoja, por nuk mendoja fare për te. Po mendoja ato, që më kishte rrëfyer ndihmësi i Vikveberit, me të cilin vitin e parë mësimor rrija githmonë bashkë. Ai quhej Gremig, ishte i gjatë e thatanik dhe parakrahun e kishte plot blana nga ciflat e granatave të dorës. Ai mbulonte ndonjëherë gjatë luftës fytyrat e grave, që kishte shtënë në dorë dhe unë çuditesha se sa pak më kishin frikësuar përshkrimet e tij. Frika e përshkrimeve të Gremigut më pushtoi vetëm tani kur me lule në dorë qëndroja përballë Hedvigës: gjashtë vjet më vonë dhe përshkrimet e Gremigut mu dukën më të këqij se të gjitha ato, që zakonisht më janë dashur të dëgjoj. Çirakët më kishin rrëfyer shumë gjëra të shëmtuara, por asnjëri nuk kishte mbuluar me peshqir fytyrën e ndonjë gruaje - dhe ata, që s'e kishin bërë këtë gjë, mu dukën tani të pafajshëm si fëmijë. Fytyra e Hedvigës - asgjë tjetër nuk mund të mendoja.

"Shkoni" - tha ajo - "shkoni që tani".

"Po" - ia bëra unë. "po shkoj", por nuk ika. Atë, që desha të bëja me të tani, nuk e kisha bërë kurrë me një grua. Mund të përmendja shumë emra, shumë fjalë mund të thosha, i njihja thuajse të gjitha ato. I kisha mësuar gjatë kohës së studimeve, në bujtinë dhe nga shokët e mi nxënës në shkollën e inxhinierisë, por as edhe një nga këto fjalë nuk i përshtatej asaj që doja të bëja me Hedvigën - vazhdoj ta kërkoj ende fjalën. Nuk është fjala dashuri, që shpreh gjithçka, ndoshta vetëm ajo i afrohet më shumë kësaj meseleje.

Lexoja në fytyrën e Hedvigës, atë që lexohej në fytyrën time: tmerr dhe frikë, asgjë nga ajo që donte të thoshte qejf, por edhe të gjitha ato, që burrat, të cilët më kishin folur për to, i kishin kërkuar dhe nuk i kishin gjetur - dhe papritur e mora vesh se, bile, as Grëmigu nuk përjashtohej këtu. Ai kishte kërkuar bukurinë prapa peshqirit që kishte hedhur mbi fytyrën e gruas. Atij do t'i duhej vetëm - kështu më dukej mua - ta hiqte peshqirin që ta gjente at. Ngadalë po shkëputej ajo që

kishte rënë nga fytyra ime në atë të Hedvigës dhe fytyra e saj doli përsëri mbi sipërfaqe, fytyra që kishte depërtuar thellë tek unë.

"Shkoni tani" - tha ajo.

"I doni lulet?" e pyeta unë.

"Po". I vura këto në krevatin e saj, të mbështjella me letër, siç ishin, dhe po vëzhgoja atë si i shpaketoi, si i rregulloi burbuqet dhe si ndukte barin. Dukej kështu sikur merrte çdo ditë lule.

"Ju lutem, ma jepni vazon"? - tha ajo dhe i dhashë vazon që ishte mbi komodinën pranë meje aty te dera. Hedviga erdhi disa çape drejt meje. Ndjeva për një çast, tek ma mori vazon, dorën e saj dhe këtë çast mendova gjithçka që do të provoja tani: ta tërhiqja drejt vetes, ta puthja dhe të mos e lëshoja më, por nuk e provova një gjë të tillë, i vura përsëri kurrizin derës dhe po e kundroja si derdhte ujë nga shtamba në vazo dhe si vuri lulet në vazo: ishte një vazo qeramike e kuqe në të errët dhe lulet dukeshin bukur kur i vuri në dritare.

"Shkoni" tha përsëri dhe i ktheva krahët pa i thënë asgjë, hapja derën dhe dola përmes korridorit jashtë. Ishte errësirë në këtë korridor, sepse ky s'kishte dritare; aty binte vetëm drita gri e errët e xhameve qumështorë të derës së katit. Dëshiroja që të më vinte pas dhe të më thërriste diçka, por ajo nuk erdhi. Hapa derën e katit dhe zbrita shkallët.

Qëndrova në hyrjen e shtëpisë, piva një cigare pashë rrugën e kredhur në diell dhe lexova tabelat me emra: Hynert, Shmic, Stefanides, Kroll - pastaj vinte emri i pronares së tyre: Grolta dhe një tabelkë e shtypur: Ndërresa - FLINK, ky ishte salloni larës.

Ende pa e mbaruar cigaren kapërceva rrugën dhe qëndrova në anën tjetër të saj. Vështrova tej dhe e mbajta hyrjen e shtëpisë nën vëzhgim. U tremba, kur papritur më foli pronarja e sallonit larës, zonja Flink: ajo kishte ardhur me përparësen e vet të bardhë përmes rrugës, por unë s'e kisha parë.

"Ah, zoti Fendrih" tha ajo "më erdhët si me porosi: një nga makinat larëse ka filluar të nxehet. Vajza bëri një gabim".

"Fikeni" - ia preva unë pa e parë në sy zonjën Flink. Ia ngula sytë përsëri hyrjes së shtëpisë.

"S'mund ta shikoni pak, ë?"

"Jo" - thashë unë "nuk mund ta shoh".

"Po, po rri këtu" - i thashë "por makinën s'mund ta shoh: Duhet të rri këtu".

"Ky është kulmi" - tha zonja Flink, "Rrini këtu dhe nuk mund të shikoni pak makinën time".

E pashë zonjën Flink buzë fushës sime të shikimit, tek kthehej përmes rrugës dhe një minutë më pas u dukën vajzat që punonin tek ajo, në derë të sallonit, katër a pesë përparëse të bardha. I dëgjova ato tek qeshnin, por aq më bënte. Kështu duhet të jetë, thashë me vete, kur mbytesh: të futet brenda në bark ujë bojë hiri, shumë ujë; nuk shikon më gjë, nuk dëgjon më gjë, vetëm një dehje të mbytur dhe uji bojëhiri, që të shijon i topitur, të duket i ëmbël.

Truri vazhdonte të më punonte si një makinë që e ke harruar ta fikësh: papritur gjeta zgjidhjen e një detyre algjebrike, të cilën nuk kisha mundur ta zgjidhja para dy vjetësh në provimin e shkollës inxhinierike. Fakti, që e gjeta zgjidhjen, më mbushi me një lumturi të thellë, të cilën e ndjen kur papritur të bie ndër mend një emër a një fjalë, të cilën e ke kërkuar një kohë të gjatë.

Fjalë angleze, që para nëntë vitesh në shkollë nuk i dija, mu kujtuan dhe papritur e kuptova se shkrepëse do të thotë match. "Tedi i sollti të atit një shkrepëse dhe babai i Tedit ndezi me këtë shkrepëse çibukun". Zjarri në oxhak u ndez dhe babai i Tedit i hodhi dru të tjera, para se të fillonte të rrëfente për kohën që kaloi në Indi". Dru do të thoshte log dhe tani mund ta përktheja fjalinë, që atëherë askush - bile as i pari i klasës - nuk mund ta përkthente. Më dukej sikur dikush më

pëshpëriste në ëndërr fjalë që s'i kisha lexuar e dëgjuar kurrë. Sytë më ruanin vetëm një tablo: derën e shtëpisë nga ku do të dilte dikur Hedviga: ishte një derë e lyer në ngjyrë kafe dhe e re dhe mu duk sikur s'kisha parë kurrë diçka tjetër përveç kësaj dere.

Nuk e di në vuaja: ujërat bojëhiri në të errët derdheshin e më godisnin dhe në të njëjtën kohë isha aq i butë, siç nuk kisha qenë kurrë: mendoja se ndonjëherë do të më duhej t'i kërkoja ndjesë zonjës Flink. Ajo ishte sjellë gjithmonë mirë me mua, më kish gjetur dhomë për Hedvigën dhe ndonjëherë, kur isha i lodhur, më kishte bërë dhe kafe. Dikur, thosha me vete, duhet t'i kërkoj të falur. Lipsej të bëja shumë gjëra dhe i kujtoja të gjithë, edhe gruan në Kurbelshtrese, që qante në telefon dhe që vazhdonte të më priste.

Tani dija, ç'kisha ditur gjithmonë, por që prej gjashtë vjetësh nuk e kisha pohuar më: se e urreja këtë profesion, siç kisha urryer të gjithë profesionet që kisha provuar. I urreja këto makina larëse. Ndjeja pështirosje nga duhma e pullandrës, një neveri që ishte më shumë se trupore. Ajo që pëlqej në këtë profesion ishte paraja, që më sillte dhe paratë i kisha në xhep. I preka: ato ishin akoma aty.

Ndeza edhe një cigare, por edhe këtë e bëra mekanikisht: nxora kutinë nga xhepi, mora një cigare dhe pastaj pashë për një çast derën e shtëpisë që kuqëlonte nga flaka e vogël e çakmakut, e pashë atë të mbështjellë nga tymi i kaltërremë. Por cigarja nuk po më shijonte dhe gjysmë të pirë e hodha në një kanal anës rrugës. Pastaj kur doja të ndizja përsëri edhe një tjetër, e ndjeva nga pesha se kutia ishte bosh dhe kështu e hodha edhe atë në kanal.

Kisha gjithashtu uri, ndjeja një gërdi të lehtë të më vinte vërdallë si një lëng në epruvetën distile - të gjitha këto po ndodhnin afër meje. Kurrë s'kisha kënduar, por këtu, përballë derës së shtëpisë, nga e cila dikur do të dilte Hedviga, këtu do të këndoja: e dija një gjë të tillë.

E kisha ditur gjithmonë se Vikveberi ishte një mashtrues në mënyrë legale, por këtu në bazaltin e tymosur të bordurës, përballë kësaj dere të shtëpisë, mu kujtua formula, sipas së cilës ishte bërë mashtrimi. Kisha punuar dy vjet në fabrikën e tij dhe më vonë më ishte dashur të kontrolloja dhe të hiqja veglat dhe aparatet, që prodhoheshin atje, aparate, çmimin e shitjes së të cilëve e llogarisja unë me Vikveberin dhe Ulën. Materiali ishte i lirë dhe i mirë, aq i mirë sa dhe materiali për nëndetëse dhe aeroplanë. Vikveberi e merrte atë me vagonë dhe ne e kishim llogaritur çmimin e shitjes së një boileri uji nëntëdhjetë marka.. ky ishte çmimi për tre bukë, në qoftë se tregu - kështu e quanin ata - ishte ngopur në një farë mënyre dhe për dy bukë, në qoftë se tregu - kështu e quanin ata - ishte i biruar. Unë vetë e kisha provuar boilerin në kabinë sipër llogarisë së pagave dhe u kisha biruar F-në time dhe datën përpara se djaloshi çirak t'i sillte në depo, ku paketoheshin e mbështilleshin me letër vaji - përpara një viti i bleva babait një boiler, që Vikveberi ma dha me çmimin e fabrikës. Magazinieri më çoi në magazinë dhe e zgjodha boilerin. E paketova në makinën time, ia shpura babait dhe, kur e motova, e zbulova F'në time të biruar e datën: 19.2.47 - më vinte çudi dhe mendoja për atë si për një formulë në të cilën mungon një e panjohur dhe tani këtu në bordurën përpara derës së Dedvigës, nuk ndjeja më çudi dhe unë e dija të panjohurën: ajo që atëherë kishte kushtuar tre bukë, u shit tani me çmimin e dyqind bukëve. Unë vetë që merrja përqindje, vazhdoja ende të paguaja aq sa kushtonin një qind e tridhjetë bukë. Isha i çuditur që kushtonin kaq shumë: se e panjohura paraqiste një vlerë të tillë dhe kështu solla në mëndje të gjithë hekurat, boilerët ngrohëset e ujit dhe shporetet, të cilëve u kisha biruar gjatë dy vjetëve F-në time.

Solla në mëndje zemërimin, që kisha ndjerë atëherë kur isha në dimër në Alpet me prindërit e mi. Im atë e fotografoi nënën para majëmaleve të mbuluar me dëborë. Ajo kishte flokë të errët dhe mbante

një mantel me ngjyrë të çelur. Kisha qëndruar pranë tij, kur bëri fotografinë: gjithçka ishte e bardhë vetëm flokët e nënës ishin të errët. Por kur babai më tregoi në shtëpi negativin, në të dukej sikur para grumbujve shumë të lartë me qymyr qëndronte një negre me flokë të bardhë.

Isha i zemëruar dhe shpjegimi kimik, që s'ishte bile shumë i komplikuar, nuk më kënaqi. Më dukej gjithmonë deri këtë çast se me disa formula kimike, me solucione dhe kripëra nuk shpjegohej dot gjë - përkundër kësaj më kishte marrë mendtë fjala kthinë e errët. Më vonë, për të më qetësuar im atë fotografoi nënën me një mantel të zi jashtë, para grumbujve me qymyr të qytetit tonë - dhe pashë në negativ një negre me flokë të bardhë, me mantel të bardhë përpara maleve të dëboruar pafundësisht të lartë. Gjithë ajo që te nëna dukej e çelët, tani ishte e errët: por fytyra e saj e bardhë, manteli i zi dhe grumbujt e qymyrit, të gjitha këto dukeshin aq të çelta, kremtërore, sikur nëna qëndronte buzagaze në mes të dëborës.

Zemërimi nuk trië ra pas kësaj fotografie të dytë dhe qysh atëherë kopjet e fotografisë nuk më kanë interesuar kurrë. Më dukej gjithmonë se nga fotografitë nuk duheshin bërë kopje kjo ishte ajo që dukej shumë pak e vërtetë në to. Negativët doja t'i shikoja dhe dhoma e errët më mrekulloi; aty im atë në një dritë të kuqërremtë i linte negativët të laheshin aq gjatë, derisa dëborë bëhej dëborë dhe qymyri qymyr, por dëborë ishte e keqe, po ashtu dhe qymyri... Më dukej se dëborë ishte në negativ qymyr i mirë dhe qymyri në negativ ishte dëborë e mirë. Im atë ishte përpjekur të më qetësonte, duke rënë thënë se kishte vetëm një kopje të vetme të saktë nga të gjitha ato që preheshin në një dhomë të errët dhe që ne nuk i njihnim: në kujtesën e Zotit - dhe ky shpjegim më ishte dukur atëherë tepër i thjeshtë sepse fjala Zot ishte një fjalë kaq e madhe, me të cilën të rriturit përpiqeshin të rmbulonin gjithçka.

Por këtu, duke qëndruar mbi bordurë, mu duk sikur po e kuptoja tim atë: e dija se isha fotografuar tek qëndroja ashtu: se ishte fotografia ime ashtu siç qëndroja aq thellë në sipërfaqen e ujit gri - ishte fotografia ime dhe më kishte marrë malli ta shikoja atë fotografi. Po të më kishte folur dikush anglisht, do t'i isha përgjigjur anglisht dhe aty mbi bordurë para shtëpisë së Hedvigës e pata të qartë, atë që gjithmonë kisha frikë t'ia qartësoja vetes, atë që isha ndrojtur gjithmonë t'ia thosha dikujt: se për mua kishte shumë rëndësi të vija në meshën e mbrëmjes para lutjes së blatimit dhe të rrija po aq shumë në të më pas, ndërkohë që kisha boshatisej shpesh aq gjatë, derisa kandinollafti të tringëllonte me rrethin e çelësave në mënyrë aq demonstrative, sesi kamerierët vinin në mënyrë demonstrative karriget te tavolinat, kur ata donin të bënin pushim dhe trishtimi se duhej braktisur lokali nuk ishte i pangashëm me trishtimin, që kisha ndjerë kur u flaka tej nga kisha, në pragun e së cilës kisha shkelur në minutën e fundit. M'u duk se tani po kuptoja atë që gjer më tani ishte e pamundur për mua të kuptoja: se Vikveberi mund të ishte besimtar, por edhe një horr dhe se ishte i të djave i përsjirtshëm dhe horr dhe unë hiqja dorë nga urrejtja ndaj tij si një fëmijë që papritur e lëshon ballonin, të cilin e ka mbërthyer me ngërç një pasdite të tërë të diele verore për ta parë të ngrihet lart në giellin mbrëmësor ku bëhet më i vogël, më i vogël, gjersa zhduket e nuk shihet më. Dëgjova bile psherëtimën e lehtë, me të cilën zbraza papritur urrejtjen time mbi Vukveberin.

Shko atje, thashë me vete, dhe për një çast i hoqa sytë nga dera. Provova ta ndiqja psherëtimën time këtë çast mbeti atje, ku ishte urrejtja ime një vend bosh një hiç shumë i lehtë, që dukej se më mbartte ashtu siç mban fshikëza e notimit peshkun, vetëm për një çast, pastaj ndjeva si u mbush ky vend me diçka, që ishte e rëndë si plumb: me indiferencën e peshës vrastare. Nganjëherë shikoja orën time të dorës, por nuk vështroja kurrë akrepat e orëve dhe të minutave, vetëm rrethin e

vockël, që ishte vendosur si anësor sipër gjashtës: vetëm atje skadonte për mua koha, vetëm ai gisht i shpejtë e i hollë atje poshtë më bënte të lëvizja, jo gishtat e mëdhenj dhe të ngadaltë atje lart. Ai gisht i shpejtë e i hollë vraponte shumë shpejt, një makinë e vogël shumë precize që priste xhamat e diçkaje të padukshme nga koha. Ajo frezonte dhe shponte rrotull hiçesisë dhe pluhuri që rucirte nga hiçi binte mbi mua si një mjet magjik që më kthente e më bënte një shtyllë të palëvizshme.

Pashë vajzat larëse të dilnin nga salloni për të ngrënë drekë, i pashë dhe kur u kthyen. Pashë zonjën Flink, tek qëndronte atje te dera e sallonit duke tundur kokën. Pas meje vinin njerëz, njerëz kalonin para derës së shtëpisë, nga ku do të dilte Hedviga, njerëz që për disa çaste e mbulonin derën e shtëpisë dhe kujtoja të gjitha ato që lipsej të bëja akoma: Emrat e pesë klientëve ishin shkruar në pusullën e bardhë, që e kisha në makinë dhe në orën gjashtë kisha lënë një takim me Ulan në kafenenë Josi, por gjithmonë sërish sillja në mëndje Ulan.

Ishte e hënë, 14 mars dhe Hedviga nuk erdhi. E mbaja orën e dorës në veshin e majtë dhe dëgjoja zellin qesëndisës të akrepit të vogël, që frezonte vrima në hiçesi, vrima të errëta, të rumbullta, që filluan të hidhnin valle para syve të mij, grupoheshin rreth derës, shpërndareshin sërish dhe zhdukeshin në qiellin e zbehtë si monedha që bien në ujë e fundosen aty. Pastaj për disa çaste fusha ime e shikimit u birua sërish si një prej teneqeve, nga të cilat hiqja në fabrikën e Vikveberit fletët katrore dhe në secilën prej këtyre vrimave shikoja derën e shtëpisë, e shikoja njëqind herë, gjithmonë të njëjtën derë, dyer të vockla, por precize, që vareshin te njëra-tjetra në ingranimin e hollë si pulla në një tabak të madh letre: një qind herë shikoja fytyrën e shpikësit të qiririt ndezës. Më kot kërkoja cigare në xhepat e mi, megjithëse e dija se nuk kisha më. Në makinë kisha një paketë, por ajo ishte njëzet metra tutje djathtas derës së shtëpisë dhe më dukej se midis meje dhe makinës është si të thuash një oqean i tërë. Solla në mendje sërish gruan e

kurbelshtrases, që qante në telefon, siç qajnë vetëm gratë që nuk e rregullojnë dot makinat dhe papritur e kuptova se s'kishte më kuptim të kujtoja Ulën dhe megjithatë e solla në mëndje: e bëra një gjë të tilë, siç vendos papritur të nderësh dritën në një dhomë, në të cilën ka vdekur dikush: në errësirë i vdekuri duket si një njeri që fle dhe mund t'i mbushësh vetes mendjen se i dëgjon frymëmarrjen, i sheh lëvizjet. Por tani drita bie verbuese mbi këtë skenë dhe duket se janë marrë tashmë masat për ceremoninë e zisë: shandanët janë aty, kovat me beronjë dhe diku majtas, nën këmbët e të vdekurit sheh një ngrehinë, ku pëlhura e zezë gufohet në një mënyrë të huaj: atje burri nga instituti i varrimit e ka bërë gati çekiçin, me të cilin nesër do të mbërthejë kapakun e arkivolit dhe tani dëgjon atë që do të dëgjosh nesër: goditjet përfundimtare dhe lakuriqe, që s'përbëjnë asnjë melodi.

Fakti që Ula nuk dinte ende gjë e bënte kujtimin e saj edhe më të lig: asgjë s'mund të ndryshohej dot më, asgjë nuk mund të kthehej më mbrapsht - çdo gjë mund të ndryshohej aq, sa ç'mund të hiqeshin sërish nga kapaku i arkivolit gozhdët e ngulura - por ajo ende nuk dinte gjë.

Përfytyroja jetën që do të bëja me të; ajo gjithmonë më kishte parë, siç shikon një granatë dore, që e punuar si tavëll duhani, qëndron tani mbi piano: në të shkund hirin të dielave pas kafesë, e pastron të hënë dhe, kur e pastron, ke gjithnjë të njëjtën ndjenjë ngazëlluese: shikon një send fillimisht kaq të rrezikshëm në një funksion kaq të padëmshëm, për më tepër ai karagjozi, që ka prodhuar tavllën, e ka përpunuar fitilin në një mënyrë kaq origjinale: mund ta tërheqësh sumbullën e bardhë prej porcelani, që duket si butonat e porcelantë të llambave të tryezës dhe, kur e tërheq, një bateri e fshehur i skuq ca tela, tek të cilët mund të nderësh cigaren: një instrument i paqtë, që është prodhuar për qëllime paqë-sore. Nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë herë mund ta tërheqësh atë, pa sjellë dëme por askush s'e di, se herën e njëmijte vihet në lëvizje një mekanizëm i fshehur, që e bën lodrën

shakatore të shpërthej. Asgjë e keqe nuk ndodh, disa copëra hekuri fluturojnë rrotull, që nuk shkojnë në zemër; tmerrohesh dhe shkon drejt së ardhmes më me kujdes.

Edhe Ulës nuk do t'i ndodhë asgjë e keqe, ajo nuk do të goditet në zemër, të gjitha të tjerat do të goditeshin, vetëm zemra jo. Ajo do të fliste, do të fliste shumë dhe e dija mirë se çdo të thoshte. Do të kishte në një mënyrë mospërfillëse të drejtë dhe donte të kishte të drejtë. Ula do të triumfonte pakëz dhe unë i kisha urryer gjithmonë njerëzit, që kishin të drejtë dhe triumfonin, kur dilte se kishin me të vërtetë të drejtë: ata më ishin dukur gjithmonë si njerëz, që ishin abonuar në një gazetë, por që gjithmonë e kapërcenin vendin, se në Impressum⁵ shkruhej diçka për fuqinë hyjnore - Pastaj zemëroheshin në një mënyrë të pandershme, në qoftë se gazeta një mëngjes nuk dilte. Ata duhej, si në kontratat e sigurimit, të lexonin më saktë shkrimin e vogël se sa titujt kryesorë.

Vetëm kur derën e shtëpisë nuk po e vështroja më, mu kujtua srish se kë po prisja prisja Hedvigën. Derën nuk po e vëzhgoja më, ajo nuk dukej nga një makinë e madhe, e kuqe në të errët, që e njihja shumë mirë: "Shërbimi sanitar Vikveberit" ishte shkruar në makinë me ngjyrë kremi. Shkova përmes rrugës, se derën lipsej ta vëzhgoja përsëri. Çapitesha ngadalë si një njeri që ecën nën ujë dhe psherëtiva, siç do të psherëtijë një njeri që ngjitet në bregun e rrëpirët si në një mal, duke lëvizur me ngadalë përmes pyjeve të leshterikëve dhe kolonive të midhjeve pranë peshqve të çuditur dhe është i frikësuar, sepse nuk e ndjen më peshën e kolonës së ujit në zverk, por ndjen lehtësinë e kolonës së ajrit, që ne e mbajmë mjaft të qetë.

I rashë rrotull kamionit dhe, kur e pashë sërish derën shtëpisë, e mësova se Hedviga nuk do të vinte poshtë: ajo rrinte shtrirë atje lart në

⁵ E dhënë e botuesit përgjegjës dhe e shtypjes në gazetë.

krevatin e saj, e mbuluar krejt nga pluhuri i padukshëm, të cilin e nxjerr akrepi i sekondave nga hiçësia.

Gëzohesha që më kishte nisur tutje, kur erdha me lulet dhe gëzohesha që ajo e kishte marrë vesh menjëherë se çfarë kisha dashur të bëja me të. Kisha frikë nga çasti, kur nuk do të më dërgonte më tutje, nga një çast që do të vinte dikur në këtë ditë, e cila vazhdonte të ishte akoma e hënë.

S'më bëhej më vonë tani për derën e shtëpisë. M'u duk vetja budalla, budalla thuajse në po të njëjtën mënyrë si atëherë, kur putha fshehurazi përparësen e pronares sime. Shkova tek makina ime, e hapa, mora kutinë e cigareve, që ishte djathtas në kapakun nën bllokun e dëftesave për kilometrat e bërë dhe orët e punës - ndeza një cigare, mbylla makinën dhe nuk e dija se ç'do të bëja: në duhej të ngjitesha lart në dhomën e Hedvigës apo të shkoja te gruaja e Kurbelshtreses, që kishte qarë aq shumë në telefon.

Papritur Volfi ma vuri dorën në sup: e ndjeva atë, siç kisha ndjerë peshën e kolonës ujore dhe me një vështrim të tërthortë majtas mund të shikoja dhe dorën. Ishte dora, që më kishte ofruar cigare të panumërt dhe që më kishte marrë po ashtu cigare të panumërt një dorë e pastër dhe e shkathët. Në diellin e marsit shikoja bile si shkëlqente në këtë dorë unaza e fejesës. Në lëvizjen e lehtë fërgëlluese të dorës ndjeva se Volfi qeshte - kjo e qeshur e lehtë, e brendshme, llokoçitëse, me të cilën ai kishte qeshur në shkollën inxhinierike⁶ me shakatë e mësuesit tonë dhe në sekondën, përpara se të kthehesha nga ai, ndjeva, ç'kisha ndjerë atëherë, kur im atë më mbushte mendjen të merrja pjesë në një takim të shokëve të shkollës: ja pra i shikoja ata tek rrinin, ata, me të cilët kisha ndarë tre, katër, gjashtë apo nëntë vjet jetë, kisha ndenjgur galiç në strehim, ndërsa bombat binin si breshër. Detyra klase ishin betejat, që i kaluan krah për krah, shuarja e zjarrit në shkollën që digjej,

⁶ *Shkollë inxhinierike = këtu: shkollë profesionale*

lidhja e plagëve të mësuesit të latinishtes të plagosur, mbartja e tij, ndenja së bashku. Dukej sikur këto përjetime të lidhnin përjetësisht me njëri - tjetrin, por nuk ishim aspak të lidhur përjetësisht me njëri - tjetrin dhe shija e amshtë vjen si kujtimi i vetëm i cigares së parë, i pirë fshehurazi dhe ta ka qejfi që kamerieres, që sjell birrën, t'ia vësh dorën në llërë, asaj, të cilën e sheh për të parën herë në jetë dhe e cila papritur të duket si një e njohur e vjetër kaq e njohur thuajse si një nënë e krahasuar me ndjenjën e huaj që ndjen kundrejt tyre, e tërë urtësia e të cilën qëndron në faktin se ata i kanë humbur idealet, që nuk i kanë pasur kurrë, ideale që fillon t'i duash, sepse i kanë humbur ata: budallenj fatzez, të cilët, të gjithë, mburren një çikë kur i pyet, sa fitojnë në muaj dhe papritur e di se miku i vetëm, që ke pasur ishte ai që vdiq në klasën e dytë: Jyrgen Brolaski ai, me të cilin, nuk ke këmbyer asnjë fjalë, sepse të dukej jo simpatik dhe i mykur; duke bërë not mbyten një mbrëmje vere, të rënë nën një trap, poshtë në sharrë, ku shelgjet kanë shpërthyer bazaltin e kaltër të mureve të skelës, ku mund të bëje në brekë banjë patinazh në rrugët me çimento, në të cilat trungjet tërhicien lart - me patinat gjer në ujë; Barëra midis gurëve të kalldrëmit dhe fjalët dëshpëruese. "Jepini fund tani - fund" të rojës së natës, që kërkonte dru për sobën. Brolaski me trupin e tij, thatanik dhe goshelli nuk kishte patina, të kuq në të trëndafiltë ishin brekët e tij të banjës. E ëma ia kishte bërë ato nga një fund dhe nganjëherë mendoja se ai bënte not vazhdimisht, që të mos ia shihnim brekët: vetëm për disa çaste ai kacavirrej lart në trape, ulej me duart e kryqosura në kraharor, me fytyrën nga Rini, duke vështruar hijen e gjelbër në të errët të urës, që mbrëmjeve arrinte gjer në sharrë. Askush s'e kishte parë të kërcente në ujë, askush s'e ndjente mungesën e tij, gjersa e ëma mbrëmjeve vraponte duke qarë nëpër rrugë, nga shtëpia në shtëpi: "Mos e ke parë djalin tim, mos e ke parë Jyrgenin?" - "Jo".

I ati i Brolaskit qëndronte me uniformë pranë varrit, një rreshter pa urdhra; i menduar ngrinte kokën me një shprehje përgjirni në fytyrë, kur ne këndonim: "Shpejt në varr, vëllaçko, shpejt në varr të mori vdekja, shpejt në varr..."

Vetëm Brolaskin kujtoja gjatë takimit të klasës sonë dhe llërët e bardha e të bukura të kamerieres, mbi të cilat do të vijta tërë qejf dorën time, brekët e banjës së Brolaskit të kuq në të trëndafiltë, të prerë nga fundi i nënës me llastikë të gjerë brenda: në hijen e jeshilët në të errët të urës ishte zhdukur Brolaski...

Shpejt në varr, vagko, të thirri vdekja...

U ktheva me ngadalë nga Volfi, pashë fytyrën e tij të mirë e të shkathët, që e njihja që prej shtatë vjetësh dhe më erdhi pak turp, siç më kishte ardhur turp, kur babai më kishte kapur duke vjedhur formularin e dëshmisë.

"Duhet të më ndihmosh" - tha Volfi. "Nuk po e gjej defektin. Të lutem, eja". Ai më mori për dore, me kujdes, siç merr një të verbër dhe më çoi me ngadalë në sallonin larës. Mbjakta erë, siç kisha mbajtur çdo ditë kaq shpesh: erën e teshave të pista, pashë aty pranë një stavë të tërë rrobash - pashë vajzat larëse zonjën Flink, të gjitha veshur me përparësen e tyre tek qëndronin aty, siç shikon pas një shpërthimi në një gjeratore pluhuri ata, që mbaheshin për të vdekur.

"Kanë punuar të nxehta", dëgjova - "tre herë të provuara asgjë dhe të gjitha makinat të gjitha."

"I ke hequr kullerat?" - pyeta Volfin.

"Po, ato ishin të pista, i pastrova, i futa përsëri dhe të gjitha makinat ishin sërish të nxehta".

"Po humbas klientin tim më të mirë - tha zonja Flink. "Hunenhofin - Hunenhofi është im më i mirë, tani po e humbas, në qoftëse ndërresat e krevatit nuk vinë gjer në mbrëmje".

"Zhvidhosi tubat", - i thashë Volfit dhe e pashë si i zhvidhosi të katër makinat, dëgjova në të njëjtën kohë si kuvendonin vajzat për rrobat e shtratit, për të cilat po shkëmbenin eksperiencë, me pastrueset e hotelit: shpesh ato më tregonin me një ndjenjë triumfi teshat e krevatit të ministrave, aktorëve të njollosura me të kuq buzësh, më zgjatnin rroba, që të mbaja erë duhmën e parfumit, të cilin e përdorte dashnorja e një funksionari partie. - Të gjitha këto gjëra më ishin dukur zbavitëse, por papritur e kuptova se ministrat dhe funksionarët e Partisë aq më bënë: bile as jeta e tyre private nuk më interesonte dhe të fshehtat e jetës së tyre private skadonin bashkë me alkalin, që rridhte nga makinat larëse. Doja të dilja prapë jashtë, i urreja makinat, e urreja duhmën e finjës me sapun...

Duke u zgërdhirë vajzat lanë ndërresat e shtratit të një aktori filmi të vinin vërdallë në makinë. Gabimet e këtij aktori njiheshin tani.

Volfi i zhvidhosi të gjithë tubat dhe më vështroi në sy. Ai dukej pakëz si i zbehtë.

"U riparua gjë tubacioni i ujit e pyeta zonjën Flink pa e vështruar.

"Po" ia bëri ajo" dje hapën Korbmahergasen, që andej na vjen uji".

"Po" tha Volfi, që e kishte lëshuar ujin." "Uji është i ndryshkur dhe i pistë".

"Lëre të rrjedhë, derisa të spastrohet, shtrëngoi vidhat prapë dhe makina do të punojë. Nuk keni për ta humbur klientin tuaj më të mirë" - i thashë zonjës Flink "Teshat janë në darkë gati". Kalova përsëri rrugën, siç kalon në ëndërr nga një peizazh në tjetrin.

U ula në shkallën e makinës së Vikveberit, por nuk ia ngula sytë derës së shtëpisë. I mbylla sytë dhe vështrova një çast kthinën e errët, pashë portretin e njeriut të vetëm, për të cilin di që nuk ka ulërirë gjer më tani, nuk i ka bërë titur asnjë njeriu - e njeriut të vetëm,

përshpirtshmëria e të cilit më ka bindur: pashë babanë. Ai mbante përpara një kuti pusullash, një kuti e kaltër druri, ku ne më parë ruanim gurët e dominosë. Kutia është e mbushur gjithmonë plot e paplot me pusulla të një madhësie të njëjtë, që babai i pret nga letrat e mbetura. Letra është e vetmja gjë, për të cilën babai tregohet kurnac. Nga letrat që fillon e pastaj i hedh, nga letrat e fietoreve të shkollës, që nuk janë shkruar plotësisht, pret ato që s'janë shtypur. Nga lajmërimet për fejesa dhe vdekje, pret pjesët e pashtypura, materialet festive dhe thirrjet e shtypura në letër për t'u mbledhur në manifestime, ftesat e shtypura në pëllhurë liri, më në fund diçka për kauzën e lirisë.

Këto materiale të shtypura e mbushin atë me një gëzim fëmijëror, sepse nga secili prej tyre fiton së paku gjashtë pusulia, që i ruan në kutinë e vjetër të dominove si gjëra të çrnuara. Ai është një njeri-pusullë, i vë pusullat në libra, portofolin e ka të mbushur plot me to, gjërat e rëndësishme dhe të dorës së dytë ua beson këtyre pusullave. Shpesh kam gjetur të tilla, kur isha ende në shtëpi. "Butoni në brekë" ishte shkruar te njëra, në tjetrën "Moxart", në një tjetër "pilageuse-pilage". Një herë gjeta një pusullë, ku thuhej "Pashë në tramvaj një fytyrë, si ajo që kishte Jezus Christusi në agoninë e tij". Përpara se të bëjë psonisjet, i shpaketon pusullat, i shikon e i hap, siç hapim një letër bixhozi, i vë pastaj si në një lojë me letra dhe i rendit sipas rëndësisë, duke formuar grumbuj të vegjël, ashtu siç ndan nga njëri-tjetri aset, mbretërit, çupat, fantet.

Në gjithë librat c tij ata dalin përgjysmë midis faqeve të librit, më të shumtat janë të konsumuara, të njolloosura me një ngjyrë të verdhë, sepse librat shpesh me muaj të tërë dergjen aty rrotull, dhe ai akoma s'i ka vierësuar pusullat. Në pushimet e shkollës i mbledh, i lexon vendet, në të cilat ka bërë shënime edhe një herë, i rendit pusullat në të cilat më shumë ka shënuar fjalë, konstrukte fjalësh, shprehje angleze dhe frënge. Kuptimi i tyre i qartësohet vetëm kur i ka lexuar dy

apo tri herë. Ai mban një korrespondencë të gjerë për shpikjet e veta, lë t'i dërgojnë leksik, sigurohet tek kolegët, ngulmon me një këmbëngulje dashamirëse në redaktimin e veprave të referimit.

Dhe një pusullë ai e mban në portofol, një pusullë me bojë të kuqe, që karakterizohet si veçanërisht e rëndësishme. Një pusullë, që pas çdo vizite time asgjësohet, por pastaj shkruhet shpejt përsëri e re: ajo pusullë ku është shkruar: "Flisni me djaloshin!"

Solla ndër mend si u befasova kur zbulova në veten time këtë qëndrueshmëri dhe këmbëngulje në vitet kur isha në shkollën inxhinierike: ajo që dija dhe njihja nuk më kishte joshur kurrë aq shumë, sa ajo që s'dija dhe që s'njihja. Nuk gjeta qetësi, derisa munda thuajse në gjumë të mblidhja pjesët e një makine të re dhe ta montoja atë. Por kërshtëria ime u çiftëzua gjithmonë me dëshirën për të fituar para me dijenitë e mia: një motiv ky që për babanë ishte plotësisht i pakuptue-shëm. Ajo - një fjalë e vetme mund t'i kushtojë shpesh vetëm tarifë postare, në qoftë se dërgon dhe merr libra, në qoftë se duhet të ndërmarrë udhëtime, - ajo nuk ngre peshë. Ai i do këto fjalë të reja, të zbuluara ose këto shprehje, siç e do një zoolog një kafshë të re, ë zbuluar dhe as që do t'i shkonte kurrë në mend të merrte para për zbulirnet që ka bërë.

Sërish Volfi ma vuri dorën në sup dhe vura re se u ngrita nga shkallarja ku isha ulur, shkova te makina ime dhe vështrova nga jashtë përmes xhamit mbrojtës vendin ku ishte ulur Hedviga: ai ishte tepër bosh...

Ç'ka ndodhur? — pyeti Volfi. "Ç'bëre me gruan e mirë Flink? Ajo është shumë e turbulluar". Unë heshta. Volfi e mbajti dorën në supin tim, më shtyu drejt makinës sime në Korbmahergasse. "Ajo më mori në telefon" tha Volfi, "zëri i saj kishte diçka që më bëri të vija menjëherë - diçka që s'ka të bëjë me makinat tuaja larëse".

Heshta. "Eja" ia bëri Volfi "një kafe do të të bëjë shumë mirë".

"Po" ia bëra unë ultas "një kafe do të më bëjë shumë mirë". Ia hoqa dorën nga supi, i priva drejt Korbmahergases, ku dija një kafene të vogël.

Një grua e re po zbrazte në këtë çast panine nga një thes prej pëlhure liri në vitrinë: paninet u grumbulluan para xhamit dhe mund të dalloja barqet e sheshtë, bojëkafe, kurrizin e tyre të rreshkur dhe bardhësinë e çelët, shumë të çelët atje lart, ku furrtari i kishte prerë: ato rrëshqisnin akoma, kur gruaja e re u kthye në dyqan dhe për një çast mu dukën si peshq, si peshq të ngrirë e të sheshtë që ishin mbledhur në një akuarium.

"Këtu do të futemi? pyeti Volfi.

"Po, këtu" - i thashë unë.

Ai çapiti përpara duke tundur kokën, por qeshi kur e futa, duke kaluar para banakut, në një kthinë të vogël, që ishte bosh.

"Aspak i keq" - ia bëri kur u ul.

"Jo" - ia prita unë. "Aspak i keq".

"Oh" - ia bëri "duhet vetëm të të shikosh ty, që të marrësh vesh se ç'ta ka ndodhur".

"Po ç'më ka ndodhur?" - pyeta unë. "Oh, asgjë" - tha ai duke u ngërdheshur. "Ti dukesh si dikush që ka bërë vetëvrasje. E shoh se sot me ty nuk del gjë".

Gruaja e re solli kafënë, që Volfi e kishte porosit atje përpara dyqanit.

"Babai është tërbuar" - tha Volfi. "Tërë ditën e perëndisë ra telefoni, ty s'kishe ku të të gjeje, as edhe me numrin që i ke dhënë zonjës Brotig. Mos e ngacmo shumë, është shumë i zemëruar. Ti e di që në punë ai s'ha shaka".

"Jo" - ia bëri ai "në punë nuk ha shaka". Unë piva kafënë, u ngrita, shkova në dyqan dhe i thashë zonjës së re të më jepte tre panine. Ajo më dha një pjatë, dhe unë tunda kokën, kur u mat të më jepte një

thikë. I vura paninet në pjatë, u ktheva në dhomë, u ula dhe hapa një panine, duke i vënë të dy gishtat e mëdhenj të dorës pranë njëri-tjetrit në prerjen e bardhë dhe, kur hëngra kafshoren e parë, e ndjeva se gërdia mu ndërpre.

"O Zot" - ia bëri Volfi "s'ke pse ha bukë të thatë".

"Jo" - thashë unë "s'kam pse ha".

"Me ty nuk mund të bisedohet" - tha ai.

"Jo" - thashë - "me mua nuk mund të bisedohet. Shko!"

"Epo, mirë" — ia bëri "ndoshta nesër je përsëri normal.

Ai qeshi, u ngrit, - i thirri gruas në dyqan, pagoi të dy filxhanët me kafë dhe të tre paninet dhe, kur i dha dy groshë bakshish, gruaja e re buzëqeshi dhe ia vuri të dy groshët përsëri në dorën e shkathët e të pastër dhe ai i futi në portofol duke tundur kokën. Hapa paninen e dytë dhe ndjeva vështrimin e Volfit, tek më shikonte zverkun, flokët dhe linjat përgjatë fytyrës, si dhe duart.

"Ajo puna u rregullua".

Unë i hodha një vështrim pyetës.

"A të tregoi dje Ula për porosinë e Tritonias?"

"Po" - thashë ultas. "Ajo më rrëfeu dje".

"E morëm porosinë" tha Volfi shend e verë. Sot në mëngjes e morëm shtojcën. Shpresoj, ti do jesh përsëri i përgjegjshëm, po të fillojmë të premtën. Ç'ti them tyt eti? Çfarë ti them Ai është inatosur aq shumë me ty, siç nuk ka qënë inatosur kurrë që prej asaj historisë prej budallai". E hoqa mënjanë paninen dhe u ngrita.

"Cilës histori?" - e pyeta. Nga fytyra e tij e kuptova se i vinte keq që e kishte filluar këtë bisedë, por tani e kishte filluar. Hapa xhepin e pasmë të pantallonave, ku kisha mbërthyer paratë, i lashë kartëmonedhat të më rrëshqisnin në dorë, u kujtova papritur se ishin vetëm njëqindëshe dhe pesëdhjetëshe, i futa paratë sërish në xhep, mbërtheva kopsën dhe futa dorën në xhepin e xhaketës ku kisha para të

tjera, që i kisha marrë sërish nga banaku i dyqanit të luleve. Mora një kartëmonedhë njëzet markëshe, një dymarkëshe dhe pesëdhjetë pfenige, i mora dorën e djathtë Volfit, ia hapa duke i rrasur paratë.

"Këto janë për atë historinë e atëhershme" i thashë. "Dy marka dhe njëzet e pesë kushtuan ato pllakat e gatimit, që i vodha. Jepja paratë tyt eti, ishin tamam dhjet.

"Që nga ajo historia" thashë ultas, "kanë kaluar gjashtë vjet, por ju nuk e Idni harruar. Gëzohem që ma kujtove".

"Më vjen keq" - tha Volfi "që e përmenda".

"Po ti e përmende, tani dhe këtu tani i more paratë, jepja tët eti".

"Merri paratë" - tha ai "ka s'mund ta bësh dot".

"Pse jo?" - thashë i qetë "atëherë vodha dhe tani, po paguaj atë që vodha. Mos do akorna?"

Ai heshti dhe më erdhi keq për të, sepse nuk dinte ç'të bënte me ato para. I mbante në dorë dhe pashë se në dorën e mbledhur i ishin formuar bula djerse, po ashtu edhe në fytyrë dhe kjo i mori shprehjen siç i merrte kur i thërrisnin ndihmësit - apo kur ata tregonin lapërdhira.

"Ishim të dy gjashtëmbëdhjetë vjet kur ndodhi ajo historia" - thashë unë. I filluam bashkë mësimet, por tani je njëzet e tre dhe nuk e paske harruar atë historinë. Eja, kthemi paratë, po që se ato të brejnë shpirtin. Mund t'ia dërgoj babait tuaj".

Ia hapa dorën sërish, kjo ishte e ngrohtë dhe e lëmekur me djersë dhe monedhat e kartëmonedhën i futa sërish në xhepin tim të xhakëtës.

"Shko tani" - thashë ultas, por ai qëndroi dhe më vështroi siç më kishte vështruar atëherë, kur u zbulua që kisha vjedhur: nuk e kishte besuar dhe më kishte mbrojtur me zërin e tij të qartë e të zellshëm prej djaloshi. Atëherë - megjithëse ishim të një muaji - më ishte dukur si një vëlla shumë më i vogël, që e ha drunë, të cilën e ke bërë hak; plaku i kishte bërëtitur dhe, më në fund, i kishte futur edhe një shpullë. Do të

jepja një mijë bukë, vetëm vjedhjen mos ta pranoja. Por mu desh ta pranoja jashtë në oborrin para punishtes, që ishte e kredhur në errësirë, nën llambën e mjerueshme 15 watt, e cila varej e lirë në një xokolë të ndryshkur dhe që lëkundej në erën e nëntorit. Zëri fëmijëror, protestues dhe i qartë u vra nga Po-ja ime e vogël, kur plaku më pyeti dhe ata të dy shkuan tok përmes oborrit në banesë. Volfi më kishte mbajtur gjithmonë për një djalë, që në zemrën e tij fëmijërore ishte "djalë fisnik" dhe ishte një gjë e keqe për të të ma hiqte këtë titull. E ndjeja veten budalla dhe të mjerë, kur u ktheva me tramvaj në bujtinë: nuk kisha brejtje të ndërgjegjes as edhe një sekondë për pllakat e vjedhura të gatimit, që i kisha këmbyer me bukë dhe cigare. Kisha filluar të çaja kokën për çmimet. Për mua s'kishte rëndësi në më mbante apo jo Volfi për një djalosh fisnik, për mua kishte rëndësi të mos mbahesha prej tij me të drejtë për të tillë.

Mëngjesin tjetër plaku urdhëroi të më thërrisnin në zyrën e tij, e dërgoi Veronikën jashtë dhe duart e tij të errëta loznin të ngathëta me cigaren, pastaj - gjë që zakonisht nuk e bënte kurrë - hoqi kapelën e gjelbër prej shajaku nga koka dhe tha: "I telefonova kapelan Derihsit dhe vetëm tani e mësova se nëna tënde vdiq para pak kohe. Për këtë nuk do të flasim kurrë më, kurrë më, dëgjon? Tani ik"

Ika dhe kur u ktheva në punishte, mendova: Për çfarë të mos flisnim më? Për vdekjen e nënës? Dhe fillova ta urrej plakun edhe më shumë se më parë: nuk e dija arsyen përse, por e dija se kisha arsye. Qysh nga ky çast nuk fola më për atë historinë, kurrë më - dhe kurrë nuk vodha më, jo, sepse vjedhjen e quaja diçka të padrejtë, por sepse kisha frikë ta mësoja vdekjen e nënës prej tyre edhe një herë për shkak të diçkaje të shtrembëruar.

"Ik tani" - i thashë Volfit, "ik".

"Më vjen keq" - tha ai "më... unë...". Sytë i dukeshin sikur besonte akoma në djaloshë fisnikë dhe i thashë: "Tani do bësh mirë të mos e mendosh më. Ik!"

Ai dukej tani, siç duken burrat që në dyzet vjet i humbasin ato që i quajnë ideale: gjë pakëz e vagullt kjo, miqësore dhe bile pakëz nga ajo që e quajnë djalosh fisnik.

"Ç't'i them babait?"

"Do të të dërgojë?"

"Jo" - tha ai "di vetëm se është shumë i zemëruar dhe se do të përpiqet të të gjejë për të biseduar për porosinë - Tritonia".

"Nuk e di akoma se çdo të bëhet?"

"Nuk e di me të vërtetë?"

"Jo" - thashë unë "me të vërtetë jo".

"A është e vërtetë çfarë thanë vajzat për zonjën Flink: se ti i je vardisur një vajze".

"O zot" - tha ai "nuk duhet të të lëshoj vetëm me gjithë ato para në xhep".

"Duhet bile të më lësh" - thashë shumë ultas "ik tani dhe të lutem" - thashë akoma rënë ultas "mos më pyet më se ç'duhet t'i thuash babait tënd".

Ai iku dhe e pashë jashtë të kalonte përpara vitrinave me krahët e varur poshtë, si një boksier, që shkon në një ndeshje të pashpresë. Prita gjersa u zhdruk në qoshen e Korbmachergases, pastaj qëndrova në derën e hapur të dyqanit dhe prita, derisa e pashë makinën e Vikveberit të shkonte në drejtim të stacionit të trenit. U ktheva në dhomën e pasme, e piva kafënë në këmbë dhe e futa paninen e tretë në xhep. Vështrova orën e dorës, tani atje lart, ku koha shtyhej pa u ndjerë dhe me ngadalë. Shpresoja se ora ishte pesë e gjysmë ose gjashtë, por ishte vetëm katër. I thashë "Mirupafshim" gruas së re prapa banakut dhe u ktheva tek makina ime: në hapësirën midis dy sedileve të parme pashë një majë të

bardhë pusulle ku në mëngjes shënoja klientët që duhej t'u shkoja. Hapa derën e makinës, e mora pusullën, e grisa dhe copat i hodha në kanal të rrugës. Do të më pëlqente të kaloja sërish në anën tjetër të rrugës dhe do të isha fundosur thellë, thellë nën ujë, por u skuqa kur e mendova këtë gjë. Shkova drejt derës së shtëpisë, ku banonte Hedviga dhe shtypa zilen; e shtypa dy herë, tre herë, edhe një herë tjetër dhe prita zhurmën e hapësit të portës, por zhurma nuk po dëgjohej. E shtypa edhe dy herë të tjera zflen dhe prapë zhurma nuk u dëgjua. Më zuri sërish frika po ajo frikë, që kisha pasur përpara se të shkoja te Hedviga, në anën tjetër të shkallës së peronit - por këto çaste dëgjova hapa, hapa, që nuk ishin të zonjës Grolta, hapa të shpejtë, teposhtë shkallëve, pastaj nëpër korridor dhe Hedviga hapi derën: ajo ishte më e gjatë nga ç'e mbaja mend, thuajse aci e gjatë sa unë dhe u trembëm të dy, kur papritur u gjendëm kaq pranë njëri-tjetrit. Ajo bëri një hap mbrapa, por e mbajti derën të hapur dhe unë e dija sa e rëndë ishte dera, sepse na ishte dashur ta mbanim, kur futëm brenda në shtëpi makinat larëse për zonjën Flink, gjersa kjo erdhi dhe derën e vumë prapë në vend.

"Dera ka një gremç, - thashë unë.

"Ku?" - pyeti Hedviga.

"Këtu" - thashë dhe trokita sipër butonit të derës që nga jashtë dhe dora e saj e majtë e fytyra u zhdukën për disa çaste në errësirën prapa derës. Drita e rrugës binte qartë mbi të dhe e pashë mirë. E dija se ajo kishte frikë të shikohej kështu, të shikohej si një portret, por ajo e duroi solide vështrimin tim, vetëm shpërveshi pak buzën e poshtme. Hedviga më pa aq mirë, siç e shikoja unë dhe e ndjeva se tani më iku frika. Sërish ndjeva dhimbjen, me të cilën më kishte depërtuar brenda kjo fytyrë.

"Atëherë" - thashë "ju ishit bionde"

"Kur atëherë?" - pyeti ajo.

"Para shtatë vjetësh, pak para se të ikja nga shtëpia".

"Po" - ia bëri ajo buzagaze "atëherë isha bionde dhe anemike".

"Sot në mëngjes kërkova me sy mos shihja ndonjë bionde - thashë "por Ju tërë kohën keni ndenjur prapa meje mbi valixhe.

"Nuk ndenja shumë" - tha ajo. "Ndenja pikërisht sa erdhët Ju. Ju njoha menjëherë, por nuk desha t'ju flisja". Ajo buzëqeshi përsëri.

"Pse?" - e pyeta.

"Sepse dukeshit kaq i zemëruar, kaq i rritur dhe i rëndësishëm dhe unë kam frikë nga njerëzit e rëndësishëm".

"Çfarë menduat?" - e pyeta.

"Oh, asgjë" - tha ajo. "Mendova se ky pra ishte Fedrihu i ri; në fotografinë, që ka yt atë dukeni shumë më i ri. Nuk flasin mirë për Ju. Dikush më rrëfeu se keni vjedhur". Ajo u skuq dhe mund të shikojë qartë se nuk ishte me anemike: u bë prush e kuqe në fytyrë, saqë ishte e padurueshme për mua ta shikojë.

"Jo" - ia bëra ultas "mos u skuqni. Kam vjedhur me të vërtetë, por ka gjashtë vjet qysh atëherë dhe ishte... - do ta bëja sërish një gjë të tillë. Kush u tregoi".

"Im vëlla" - tha ajo "nuk është aspak djalë i keq".

"Jo" ia bëra unë "nuk është aspak djalë i keq. Dhe keni menduar se kam vjedhur pikërisht kur ika nga shtëpia".

"Po" - tha ajo "e kam menduar këtë gjë, por jo për një kohë të gjatë".

"Sa kohë" e pyeta.

"Nuk e di" - tha buzagaze, "kam menduar edhe gjëra të tjera. Kisha uri" - tha ajo. "Po kisha frikë të zbrisja poshtë se e dija që atje ishit Ju".

E nxora paninen nga xhepi i xhaketës, ajo e mori duke buzëqeshur, e theu shpejt dhe pushë që gishtin e madh, të bardhë e të fuqishëm e futi thellë në tulin e butë, sikur ta fuste brenda në një jastëk.

Hëngri një kafshore dhe, kur mori të dytën, i thashë: "A e dini kush i tregoi vëllait tuaj se unë kam vjedhur"?

"Ka rëndësi për Ju ta dini këtë?"

"Po" - i thashë unë "shumë".

"Duhet të jenë ata njerëzit, që Ju - ajo u skuq - që ju i vodhët. Im vëlla më tha: "E kam mësuar nga burime të para". Mori kafshoren e dytë, vështroi diku pranë meje dhe tha ultas: "Më vjen keq, që u dërgova kështu, por kisha frikë dhe, kur e bëra një gjë të tillë, nuk e mendova aspak atë historinë, që më kishte rrëfyer im vëlla".

"Kisha thujse qejf të vidhja" thashë unë "dhe vodha rre të vërtet, por e bukura është se nuk dija të vidhja. Isha i ri atëherë, frikacak - kurse sot do të vidhja me marifet".

"Nuk pendoheni fare që e keni bërë një gjë të tillë? - pyeti ajo dhe futi sërish një kafshore në gojë.

"Jo" - i thashë "s'pendohern fare, veçse, siç doli, ajo ishte një punë e ndyrë dhe nuk mund ta mbroja veten. dhe ata po e shtrembërojnë këtë mesele; a e dini sa e bukur është ta marrësh diçka të shtrembëruar se nuk e ndjen aspak si një faj?"

"Jo" - tha ajo "nuk e di, por mendoj se është diçka e keqe. Ju keni" - tha buzagaze "rastësisht bukë në xhep. Çfarë bëni me atë? Ushqeni zogjtë - apo keni frikë nga një krizë buke?"

"Kam gjithmonë frikë nga një krizë urie - thashë unë. "Doni më shumë bukë?"

"Po" - ia bëri ajo.

"Ejani." - i thashë "po u ble ca".

"Më duket sikur jam në një shkretëtirë - tha.

"Kam shtatë orë që as kam ngrënë dhe as kam pirë fare.

"Ejani" - i thashë.

Ajo heshti dhe nuk buzëqeshte më. "Po vij me Ju" - tha me ngadak "në qoftë se më premtoni se nuk do vini më në dhomën time kaq papritur dhe me kaq shumë lule".

"Ju premtoj" - i thashë unë.

Ajo u përkul atje prapa derës, e ngriti grremçin me dorë lart dhe dëgjova përplasjen e grremçit në mur.

"Nuk është larg" - i thashë "ja atje pas qoshes, "ejani", por ajo qëndroi, e mbajti derën me kurriz fort dhe priti, gjersa unë kalova përpara. Çapitesha pak përpara saj, kthehesha nganjëherë dhe vetëm tani pashë se kishte marrë me vete çantën.

Te banaku i kafenesë qëndronte një burrë, që priste byrekë të freskët me mollë me një thikë të madhe: thurima e kaftë prej brumi mbi pelten jeshile të mollës ishte e freskët dhe burri e priste byrekun me kujdes për të mos e prishur thurimën e bërë. Ne qëndronim të heshtur pranë njëri-tjetrit para banakut dhe bënim sehir burrin.

"Këtu ka" - i thashë me një fije zëri Hedvigës "edhe supë pule dhe supë gulashi".

"Po" tha burri pa i ngritur sytë "mund të merrni. Ai kishte flokë të zinj dhe të dendur, atje, ku ata dilnin nga kasketa që mbante. Burri binte erë bukë, siç bien erë qumësht fshatarkat.

"Jo" - ia bëri Hedviga, "nuk dua supë. Dua byrek.

"Sa do" - pyeti burri. Ai bëri prerjen e fundit në byrek, e hoqi thikën me një shtytje të vogël dhe e kundroi buzagaz punën që kishte bërë, "Vë bast" - tha dhe fytyra e ngushtë, e errët u tkurr nën buzëqeshjen e tij, "vë bast se të gjitha ngastrat janë njësoj të mëdha dhe të rënda. E shumta e hoqi thikën mënjanë. E shumta, dy, tre gram dallim, kjo është e papërfillshme. E vëmë me bast?"

"Jo" - thashë duke buzëqeshur "nuk vë bast". Këtë bast do ta humbja. Byreku dukej si rozetat e një katedraleje. "Po, me siguri" tha burri "me siguri do të humbnit. Sa doni?"

I hodha Hedvigës një vështrim pyetës. Ajo buzëqeshi dhe tha: "Një ngastër është pak, dy janë shumë".

"Një e gjysmë, pra" - tha ai.

"A mund të marr?" - pyeti Hedviga.

"Sigurisht - tha, mori thikën dhe preu një copë mu në mes të byrekut. "Pra, për secilin një e gjysmë thashë unë - edhe një kafe".

Filxhanët ishin akoma në tryezë, ku isha ulur me Volfin dhe në pjatën time kishte akoma drudhe paninesh. Hedviga u ul në karrigen, ku ishte ulur Volfi, nxora cigaret nga xhepi dhe ia zgjata asaj.

"Jo, faleminderit" ia bëri "ndoshta më vonë".

"Dua t'ju pyes edhe për diçka" i thashë dhe u ula. "Për diçka, që do ta kisha pyetur gjithmonë me qejf babanë tuaj por kisha, natyrisht, druajtje.

"Çfarë" - tha ajo.

"Si shpjegohet" thashë "që quheni Muler dhe jo Myler"?

"Ah" - ia bëri "kjo është një histori prej budallai, për të cilën jam zemëruar shpesh".

"Si kështu?" - e pyeta.

"Im gjysh quhej Müller, ai kishte shumë para, emri që mbante i dukej ordiner dhe dha çmendurisht shumë para për t'i eliminuar të dy pikat mbi U.

E kam marrë inat.

"Pse?"

Sepse ishte më mirë të quhesha Müller⁷ (Myler) dhe të kisha paratë, që duheshin për t'i zhdukur të dy pikat e pafajshme. Do të dëshiroja të kisha paratë, atëherë s'kisha pse të bëhesha mësuese".

"Nuk keni qejf të bëheni mësuese" - e pyeta.

"Edhe kam" - tha "por jo marrëzisht. Babai thotë se duhet të bëhem mësuese, që të nxjerr kështu bukën e gojës.

⁷ Ü - u-ja me dy pika në gjermanisht lexohet y.

"Po të dëshironi" thashë ultas "ua nxjerr unë bukën e gojës".

Ajo u skuq dhe u gëzova që më në fund ia thashë dhe që ia thashë në këtë mënyrë. U gëzova edhe që burri hyri brenda dhe solli kafënë. Ai e vuri ibrikun në tavolinë, hoqi enët e palara dhe tha "Doni kajmak në byrek".

"Po, të lutem, kajmak" — tha ajo.

Burri shkoi dhe Hedviga shtiu kafe. Ajo vazhdonte të ishte e kuqe flakë. Vështrova pranë saj fotografinë që varej mbi të në mur: ishte fotografia e një gruaje në statujë mermeri. Kisha kaluar shpesh para kësaj statuje dhe s'e kisha ditur kurrë se kë prezantonte ajo dhe u gëzova, që lexova nën fotografi: Përmendorja e perandoreshë Hugusta dhe që mësova se kush ishte ajo gruaja.

Burri solli byrekun. Shtiva qumësht në kafe, e trazova, këputa me lugë një copë byrek dhe mu bë qejfi kur edhe Hedviga filloi të hajë. Tani nuk ishte më e kuqe dhe tha, pa e ngritur kokën nga pjata "Një haje e çuditshme: shumë lule dhe një panine, të ngrëna pa sajdi".

"Dhe më pas" - thashë "byrek me kajmak dhe kafe - dhe në mbrëmje ajo që ime ëmë e quan një haje të arsyeshme.

"Po" - ia bëri "edhe nëna ime thoshte se unë duhet të ha çdo ditë diçka të arsyeshme".

"Ndoshta aty nga ora shtatë" thashë unë.

"Sot?" - pyeti ajo.

"Po, sot" - thashë.

"Jo" - ia bëri. "Sot në darkë nuk mundem. Do të shkoj për vizitë te një e afërme e tim eti. Ajo banon në rrethina dhe ka kohë që mezi më pret".

"Keni qejf të shkoni atje?" - e pyeta.

"Jo" - tha "ajo është një nga ato gra, të cilat që në vështrimin e parë thonë kur janë larë herën e fundit perdet dhe më e keqja është se

ato që thotë janë tamam ashtu siç thotë ajo. Po të na shikonte këtu, do të thoshte: ai do t'ju shtjerë në dorë".

"Është tamam kështu" - thashë "dua t'ju shtie në dorë".

"E di" - tha Hedviga - "jo, nuk ma ka qejfi të vete.

"Mos shkoni" - thashë unë. "Do të ishte mirë, po t'ju shihja përsëri sot në mbrëmje. Njeriu nuk duhet të vejë te njerëzit, që nuk i do.

"Bukur" - ia bëri ajo, "nuk do të vete, por po të mos shkoj te ajo, vjen ajo tek unë dhe më merr. Ajo ka një makinë dhe është tmerrësisht e fuqishme, jo, e vendosur thotë im atë për të".

"I urrej njerëzit e vendosur" - thashë.

"Edhe unë" - ia bëri ajo. E hëngri pjesën e mbetur të byrekut dhe kruajti me lugë kajmakun, që kishte rrëshqitur nga byreku.

"Nuk mund të vendos për të shkuar atje ku duhej të shkoja në orën gjashtë" - thashë unë. "Doja të takoja vajzën, me të cilën dikur desha të martohesha dhe t'i thosha se nuk doja të martohesha me të". Ajo mori ibrikun e kafesë për të shtënë prapë, por e la dhe tha: "A varet nga unë nëse do t'ja thoni sot, apo jo".

"Jo" - ia bëra unë. "Varet vetëm nga unë, sidoqoftë, lipset t'ia them".

"Atëherë shkoni dhe thojani. - Kush është ajo?"

"Është ajo" - thashë "babanë e së cilës e vodha dhe që ia tregoi atij, që ia rrëfeu vëllait tuaj".

"Oh" - ia bëri "këtë ajo do ta bëjë me siguri fare lehtë".

"Shumë lehtë" - ia bëra "aq lehtë sa do të jetë thuajse ashtu si me një anulim abonimi, ku njeriut nuk i vjen keq për gazetën, por vetërn për lajmëtaren, që merr një bakshish mujor më pak".

"Shkoni" - tha ajo. "Kurse unë nuk do të vete tek e njohura e babait. Kur do të shkoni".

"Aty nga ora gjashtë" - iu përgjigja "po tani s'ka vajtur as pesë ora".

"Lermëni vetëm" - tha Hedviga "shkoni mos gjeni ndonjë kinkaleri dhe blimëni një kartë postale: u kam premtuar atyre të shtëpisë t'ju shkruaj çdo ditë.

"Doni një kafë tjetër" - e pyeta.

"Jo" - u përgjigj. "Më jepni një cigare".

I zgjata paketën, ajo mori një cigare. I dhashë ta ndizte dhe pashë, kur isha në dyqan dhe paguaja paratë, si rrinte atje tej dhe pinte duhan. Pashë se pinte duhan rrallë, si e mbante cigaren dhe si e nxirrte jashtë tymin. Kur u ktheva edhe një herë në dhomë, Hedviga ngriti sytë dhe tha:

"Shkoni" dhe shkova sërish. Duke ikur pashë vetëm si hapi çantën: astari i çantës ishte aq i gjelbër sa dhe manteli i saj.

Shkova përmes gjithë Korbmahergases, ktheva qoshen dhe u futa në Necmahergase. Bënte fresk dhe në disa vitrina kishte tashmë dritë. Mu desh të shkoja përmes gjithë Necmahergases, përpara se të gjeja një kinkaleri.

Gjithçka në dyqan, në raftet e modës së vjetër, ishte hedhur mbi dhe pranë njëra-tjetrës. Në banak një kuti me letra bixhozi me të cilat lot, siç duket, dikush, që nuk e quan si diçka të mirë. Ai i kishte vendosur letrat e dëmtuara pranë një pakete të hapur: një as karò, në të cilin karoja madh ishte i zbehur në mes të letrës, dhe një nëntë spathi që kishte një përthyerje. Përreth kishte dhe stilolaps, pranë bllokut, në të cilin dikush i kishte provuar. I mbështeta krahët mbi banak dhe kundrova bllokun. Në të ishin bërë lajle të ndryshme, rrathë të egër, dikush kishte shkruar "Brunoshtrese", por me të shumtit kishin provuar aty nënshkrimin e tyre dhe në shkronjat e fillimit shihje shtytjen, që ata kishin pasur: Maria Kelish lexova qartë një shkrim të qëndrueshëm dhe të rumbullakët. Një tjetër kishte shkruar shkronjat e një belbacuku: Robert - Robert – Br - Robert Brah, shkrimi ishte qoshelli, i dalëmode, dhe prekës dhe mu duk se duhet t'i kishte shkruar këto një burrë plak.

"Heinrich" kishte shkruar dikush dhe pastaj me të njëjtin shkrim "Mos më harro", kurse dikush tjetër kishte shkruar me një stilograf të trashë "Karakatinë".

Më në fund erdhi një grua e re, që më përshëndeti me kokë miqësisht dhe futi në karton kutinë me letra bixhozi me të dy letrat e prishura.

Në fillim urdhërova të më jepte kartolina, pesë copë. Mora nga stiva që më vuri përpara pesë kartolinat e para. Ato tregonin pamje të lulishteve dhe të kishave dhe një monument, që s'e kisha parë akoma: ai quhej monumenti Noldevol, tregonte një burrë të derdhur në bronz që mbante një rendigotë dhe në duar një top letre që po e ffillonte.

"Kush ishte ky Noldevoli - e pyeta gruan e re dhe i dhashë letrën, që ajo e futi në zarf bashkë me të tjerat. Ajo kishte një fytyrë të dashur dhe të kuqe, mbante flokë të errët, të ndarë me vijë në mes dhe kishte një pamje, siç e kanë gratë, që duan të shkojnë në manastir.

"Noldevoli" tha "ishte ndërtuesi i Nordshtatit".

E njihja Nordshtatin. Shtëpi të larta me qira përpiqeshin vazhdimisht të dukeshin ashtu siç dukej në vitin 1910 një shtëpi borgjeze banimi. Tramvaje kthenin këtu, makina jeshile, gjëra që më dukeshin aq romantike, siç i ishte dukur tim eti një koçi në vitin 1910.

"Faleminderit" - thashë dhe mendova: për këtë më parë duhej të ngrinin një monument.

"Dëshironi akoma diçka?" pyeti gruaja dhe unë i thashë: "Po, më jepni ju lutem kartonin me letër shkruese, atë të madhin, jeshilin".

Ajo hapi vitrinën, mori kartonin nga penxherja dhe i fryu pluhurit.

E pashë si mori letër ambalazhi nga rrotulla, që varej në mur, prapa saj, duke admiruar duart e saj të bukura, të vockla, krejt të zbehta. Papritur nxora stilografin nga xhepi, e hapa dhe shkrova emrin tim nën Maria Kelish, në bilokun, ku ata kishin provuar stilolapsat. Nuk e di pse

e bëra, por kjo më joshi aq shumë se do të përjetësohesha në atë copë letër.

"Oh" - ia bëri gruaja "mos doni ta mbushni stilografin?"

"Jo" thashë dhe e ndjeva se u skuqta "jo, faleminderit, sapo e kam mbushur".

Ajo buzëqeshi dhe thujtse mu duk se e kuptoi pse e kisha mbushur.

Vura paratë mbi banak, mora nga xhepi i setrës bllokun me çeqe, mbusha mbi banak një çek me mbi njëzet e dy marka e pesëdhjetë dhe shkrova tërthor tij: VETËM PËR TË KALUAR NË KONTO, mora zarfin, në të cilën gruaja kishte futur kartat postale, futa letrat në xhep dhe çekun në zarf. Zarfë ishte nga një lloj shumë i lirë si ai që të dërgon finanza apo policia. Adresa e Vikveberit u shkri kur shkrova mbi ë, e fshiva atë fare dhe e shkrova me ngadalë edhe një herë.

Mora nga paratë e shkoqura që më ktheu gruaja një markë, ia ktheva atë prapë dhe i thashë gruas: "Më jepni pulla, një dhjetësh, ju lutem, dhe mbani dhe tarifën postare. Ajo hapi një sirtar, mori pulla nga një fletorkë, m'i dha dhe unë ngjita dy në zarf.

Kisha dëshirë të harxhoja akoma më shumë para, i lashë të shkoqurat mbi banak dhe kërkova me sy rrotull raftëve. Në to kishte dhe fletore të kolegëve, që i përdornin në shkollën inxhinierike: zgjodha një nga ato, që ishte lidhur me lëkurë të butë, jeshile dhe ia zgjata gruas te banaku për paketim. Gruaja e vuri përsëri në lëvizje rrotkën me letër paketimi dhe, kur mora pakon e vogël, kuptova se Hedviga nuk do ta përdorte kurrë këtë fletore si fletore kolegësh.

Kur u ktheva përsëri në Necmahergase, mu duk se kjo ditë nuk do të mbaronte kurrë, pak më qartë ndriçonin llampat në vitrina. Kisha qejf të harxhoja akoma më shumë para, por asnjë nga vitrinat nuk më joshi të blija diçka. Ndenja vetëm pakëz më gjatë përpara një dyqani arkivolesh, vështrova qivuret e zinj dhe të kaftë në të errët, që

ndriçoheshin dobët, vazhdova rrugën dhe mu kujtua Ula, kur ktheva sërish në Korbmahergase. Nuk do ta kishte të lehtë siç më ishte dukur mua. e dija se ajo kishte kohë që t'njihte dhe më njihte mir, por edhe unë ama, e njihja: kur e puthja, kisha parë nganjëherë nën fytyrën vajzërore, të lëmuar dhe të bukur kafkën e vdekur që babai i saj do të kishte dikur: një kokë të vdekur, që mbante një kapelë shajaku ngjyrë jeshile.

Unë me të bashkë e kishim mashtruar plakun në një mënyrë më dinake dhe më frytdhënëse, sesa në atë historinë me pllakat e gatimit. Më shumë para dhe para të mira kishim nxjerrë, duke shtyrë tej pjesë hekurishtesh, që i kisha fituar me një kolonë të tërë punëtorësh, duke shkatërruar fare gërmadhat, që ishin gati për t'u shembur. Disa dhoma, që i arritëm me shkallë të larta, kishin mbetur plotësisht të paprekura. Gjetëm banja dhe kuzhina, në të cilat çdo sobë, çdo boiler, çdo bulon ishin ende si të rinj, çdo gremç muri i emaluar, gremçe, në të cilat vareshin akoma shpesh peshqirë, rafte xhami, ku të kuqtë e buzëve dhe aparati i rrojës ishin pranë e pranë. Vaska akoma me ujë, në të cilin shkuma me sapun kishte rënë poshtë në fjolla gëlqerore, ujë i kthjellët, ku notonin ende kafshë prej gome, me të cilat loznin fëmijët, që ishin mbytur në bodrum dhe unë vështroja në pasqyra, ku ishin vështroar tani së fundi njerëz, që pak minuta më vonë kishin vdekur, pasqyra, në të cilat kisha shkatërruar me çekiç nga zemërimi dhe neveria fytyrën time - cifla sermi kishin rënë mbi aparatin e rrojës dhe të kuqtë e buzëve. Hoqa tapën e vaskës dhe uji ra katër kate poshtë, kafshët prej gome ranë me ngadalë në truallin gëlqeror të vaskës.

Diku ishte një makinë qepëse, gjilpëra e së cilës ishte ngulur në një copë liri të kaftë që do të përfundonte në pantallona të rinjsh. Askush nuk më kuptoi kur e përmbysa poshtë përmes derës së hapur, pranë shkallës, ku u bë copë-copë në gurët dhe muret e rrëzuara. Më shumë do të më pëlqente të shkatërroja fytyrën time atje në pasqyra, që

gjetëm - ceflat e sermta binin, siç bie një lëng tingëllues, derisa Vikveberi zuri të habitej që nuk pa më pasqyra në mallrat e plaçkitura dhe një çirak tjetër mori komandën për punimet pastruese.

Por mua më dërguan atje, kur djaloshi çirak, që ishte kacavarur natën në një shtëpi të shkatërruar për të marrë një makinë larëse elektrike, që rrëzuar. Askush nuk dinte ta shpjegonte si kishte hipur në katin e tretë, por ai kishte arritur atje dhe e kish ulur poshtë makinën, aq të madhe sa një komodinë nate me një litar që ishte këputur. Makinën e kishte akoma atje në rrugë nën rrezet e diellit, kur mbërritëm ne. Erdhi policia dhe dikush, që mati me një matës gjatësinë e litarit. Ky tundi kokën, vështroi lart, ku dera e kuzhinës ishte akoma hapur dhe dukej një fshesë që ishte mbështetur në murin e ljer me bojë të kaltër. Makina larëse ishte çarë si një arrë: cilindri kishte dalë jashtë, por djaloshi rrinte shtrirë si një i palënduar në një grumbull dyshekësh të kalbur, i varrosur mes leshterikëve dhe gojën e kishte aq të hidhur, siç e kishte pasur gjithmonë: goja e një të urituri, që nuk beson në drejtësinë e kësaj bote. Ai quhej Alois Frukler dhe ndenji vetëm tre ditë tek Vikveberi. E shpura tek makina e varrimit, dhe një grua në rrugë më pyeti: "Mos e kishit vala?". Unë iu përgjigja: "Po, është vëllai im". Pasdite pashë Ulan si e ngjeu penën në një shishe me bojë të kuqe dhe me një vizore shoi emrin e tij nga Lista e pagesës. Ishte një vizë kjo e drejtë dhe e pastër aq e kuqe sa gjaku, sa jaka e Sarahorstit, buzët e Ifigjenisë dhe sa zemra në asin kup.

Hedviga mbështeti kokën në duar, pulovrën jeshile e kishte të tërhequr lart dhe parakrahët e saj të bardhë qëndronin topolakë në tryezë si shishe midis grykave të të cilave ishte mbërthyer fytyra e saj. Kjo fytyrë mbushte hapësirën e rumbullaktë midis qafave, që vinin duke u ngushtuar. Sytë i kishte të kaftë në të errët, por me një të verdhë të çelët nën vete, thujse ngjyrë rnjalti dhe pashë hijen time të binte në sytë e saj. Por Hedviga vazhdonte të shikonte diku pranë meje: ajo vështronte

në korridor brenda, të cilën e kisha shkelur tamam dymbëdhjetë herë me fietoret e reja gjuhësore të punës dhe për të cilin kisha vetëm një kujtim të turbullt e të vagullt: lincrusta⁸ të kuqërreme, por ky mund të ishte edhe bojëkafë në të errët, sepse në këtë korridor nuk binte shumë dritë, fotografia e babait të saj me kasketën e studentit dhe nënshkrimin e egër të një onia... aroma e çajit të mendrës, era e duhanit dhe një raft me pentagrame, në të cilin dikur kisha lexuar titullin e fletores që ishte lart fare: Grig - vallja e Anitrës.

Do të dëshiroja ta njihja korridorin aq mirë, sa ç'e njihje dhe Hedviga dhe në kujtesën time kërkoja sende, që ndoshta i kisha harruar. E hapa me të prerë kujtesën, siç pret astarin e xhaketës për të nxjerrë monedhën, që e ke gjetur - një monedhë, që papritur bëhet pafundësisht e çmuar, sepse është e fundit dhe e vetme: groshi për dy panine, për një cigare ose për një rrotull të vogël mendrë, tabletat e bardha në formë osteje mund të mbushnin urinë me ëmbëlsinë e tyre plot erëza, siç mbushin me ajër mushkëritë, që nuk punojnë më.

Kur e prisje astarin, në dorë të mbetej pluhur, push leshi dhe gishti rrëmonte për të kapur monedhën e çmuar, të cilën e di mirë që është një grosh dhe nga e cila fillon të shpresosh se është një markë. Por ishte vetëm një grosh - e kisha tani dhe ai ishte i çmuar. Mbi hyrje - e kisha parë gjithmonë kur dilja - varej një tablo e zemrës së Jezusit me një llambë vajguri përpara.

"Shkoni" - tha Hedviga "po ju pres këtu. do të rrih shumë?" E tha këtë pa më parë në sy.

"Kjo kafene këtu" - thashë "mbyllet më shtatë".

"Do të vonohesh më shumë se ora shtatë?"

"Jo" - ia bëra unë. Me siguri jo. Ju do të rri këtu.

"Po" u përgjigj ajo. "Do të rri këtu. Shkoni".

⁸ *Lincrusta (lat) – lloj tapeti.*

I vura kartat postale mbi tryezë, markat pranë tyre dhe ika. U ktheva në Judengase, i hipa makinës sime, i hodha të dy pakot me dhuratat për Hedvigën në sedilet e mbrapme. E dija se gjithë kohën para makinës kisha pasur frikë, ashtu siç kisha frikë nga puna ime. por udhëtimi me makinë kishte dalë mirë, siç kishte dalë pirja e cigares, kur kisha qëndruar në anën tjetër të rrugës dhe kisha vështruar derën e shtëpisë. Udhëtimi me makinë ishte bërë automatikisht: duheshin shtypur butona, duheshin tërhequr butona: duheshin shtytur poshtë dhe lart levat. E ngisja makinën siç ngitet në ëndërr një makinë: shtruar, qetë dhe pastër dhe më dukej sikur e drejtoja përmes një bote të heshtur.

Kur po kaloja në kryqëzimin Judengase - Korbmachergase, për t'u futur në sheshin Röntgen, pashë sesi u zhduk në errësirë tutje në Korbmahergase pulovra jeshile e Hedvigës. U rrotullova në mes të kryqëzimit të rrugëve dhe e ndoqa pas me makinë. Hedviga po vraponte, pastaj i foli një burri, që po kalonte përmes rrugës me një karavele bukë nën sqetull. Ndalova, se isha shumë afër dhe pashë se burri po i sqaronte diçka duke lëvizur duart. Hedviga vazhdonte rrugën, kurse unë e ndiqja me ngadalë, kur po kalonte përmes Necmahergases, prapa dyqanit me takëme shkrimi, ku kisha blerë kartat postale; u kthye në një rrugë të errët e të shkurtër, që nuk e njihja. Ajo tani nuk vraponte më, çanta e zezë i tundej në dorë, hapa për një çast dritën për larg, sepse nuk e shihja tërë rrugën dhe atëherë u skuqta nga turpi, kur prozhektori im ndriçoi plotësisht portalin e një kishe të vogël ku Hedviga sapo hyri. Mu duk vetja siç duhet t'i duket dikujt, që xhiron një film, që ndez papritur natën prozhektorin e tij dhe kap një çift tek përqafohet.

I rashë kishës përqark me shpejtësi, u rrotullova atje dhe pastaj u nisa drejt sheshit Röntgen. Isha këtu i përpiktë në orën gjashtë dhe pashë Ulën atje para dyqanit të mishit kur dola nga Çandlershrase dhe ktheva drejt sheshit Röntgen: e pashë tërë kohën, ndërkohë që u bllokova nga makina të tjera, lëviza ngadalë përqark sheshit Röntgen, gjersa më në fund munda të kthehesha dhe të parkoja. Hedviga kishte veshur mushamanë e kuqe dhe kishte vënë kapelën e zezë. Mu kujtua se dikur i kisha thënë se kisha qejf ta shikoja me mantelin e kuq. Parkova diku, vrapova drejt saj dhe fjalët e saj të para ishin: "Këtu nuk lejohet të qëndrosh. Mund të të kushtojë njëzet marka".

E pashë nga fytyra se ajo kishte folur me Volfin, lëkura e trëndafilte kishte hije të zezë. Midis dy blloqeve me sallo të bardhë atje prapa në vitrinën e dyqanit të kasapit, mbi kokën e saj, midis vazove me lule dhe rafteve prej mermeri ngrihej një piramidë konservash mishi, në etiketat e të cilave me ngjyrë të kuqe flakë ishte shkruar: Corned beef. "Lëre makinën" thashë unë "nuk kemi shumë kohë". - "Marrëzira" - ia bëri ajo, "nëm çelësin. Atje përtej është një vend bosh".

I dhashë çelësin dhe pashë si hipi në makinën time. E drejtoi atë me shkathtësi nga ana e ndaluar në anën tjetër të rrugësë, ku sapo ishte larguar një makinë tjetër. Atëherë shkova te kutia postare atje në qoshe dhe e hodha letrën për babain e saj.

"Marrëzira" - tha ajo, kur u kthye dhe më dha çelësin "sikur ti ke para për të dhuruar".

Psherëtiva dhe mendova pafundësinë e një martese të gjatë, të gjatë sa jeta, që thuajse do të çoja me të, qortimet që do të binin mbi mua pas tridhjetë-dyzet vjetëve, siç bien gurët në pus; sa e çuditshme do të kishte qenë kjo, sikur jehona e gurëve të rënë të bëhej më e pakët, më e topitur, e shkurtër - derisa ajo s'i përket më asnjë jehone dhe gurët të dalin nga pusi. Tabloja e pusit, që villte gurë, më ndiqte, kur unë me të ktheva qoshen dhe u drejtova drejt kafenesë Josi.

E pyeta Hedvigën: "Fole me Volfin?". Ajo u përgjigj: "Po". E kapa për krahu kur qëndruam para kafenesë "Josi" dhe i thashë: "A duhet të bisedojmë?"

"Oh, po" - ia bëri "duhet të bisedojmë" Hedviga më shtyu brenda kafenesë dhe, kur e hoqa mënjane perden prej shajaku, e kuptova përse kishte për të kaq shumë rëndësi të rrinte me mua këtu. Këtu kisha qenë me të dhe me Volfin shumë shpesh, qysh në kohën kur ndiqja me Volfin kurset e mbrëmjes, edhe më vonë kur dhamë provimin dhe s'shkuam më në shkollën inxhinierike; kafeneja "Josi" kishte qenë pika jonë e takimit: filxhanë të panumërt kafeje kishim pirë këtu së bashku, kishim ngrënë akullore të panumërta dhe kur pashë buzëqeshjen e Ulas, tek qëndroi pranë meje dhe kërkoi me sy një tryezë të lirë, e kuptova se ajo besonte se më kishte joshur në një kurth: këtu muret, tryezat, karriget, grahmat dhe fytyrat e vajzave të shërbimit të gjitha këto ishin në anën e saj. Këtu ajo do të luftonte në një truall me mua ku kulisat ishin kulisa të saj, por nuk e dinte se këto vite - tre apo katër - ishin fshirë nga kujtesa ime, megjithëse dje kisha ndenjur me të këtu. I kisha flakur tej këto vite, siç flak një kujtim, që në çastin që e merr të duket kaq i çmuar dhe i rëndësishëm: copa shkëmbore, e ruajtur lart në majëmalin Montblank, për të sjellë në mëndje çastin kur papritur e ke mësuar çdo të thotë ai. U merren mendtë këtyre gurëve gri, të mëdhenj sa një kuti shkrepseje, që duken si miliarda tonë shkëmbinj mbi këtë tokë. Papritur i lë ata të bien nga treni midis shinave ku shkartin me guralecë.

Në mbrëmje ishim gjer vonë këtu; Hedviga më mori pas meshës së mbrëmjes dhe atje prapa te tualeti lava duart, që ishin ende të pista nga puna. hëngra një pashtet, piva verë - dhe diku, e shtytur poshtë nga kartëmonedhat në xhepin e pantalionave, duhej të ishte dëftesa, që më kishte dhënë ajo vajza. 6,58 DM duhej të ishin aty dhe e pashë vajzën që m' kishte dhënë, atje prapa tek varte në qoshk gazetave të mbrëmjes.

"Ulemi?" - pyeti Ula.

"Mirë" - iu përgjigja "ulemi".

Zonja Jos qëndronte te banaku dhe rendiste me një pincë argjendi bonbone me lëvore të kristalta. Kisha shpresuar se do të kalonim aty pranë për t'u përshëndetur nga zonja Jos. Ajo e quan të rëndësishme ta bëje këtë, sepse "e ka në zemër rininë", por tani doli nga banaku, zgjati të dyja duart dhe më shtrëngoi në kyçe, sepse kisha në dorë çelësin e makinës dhe kapelën. Ajo thirri: "Sa mirë që po të shoh përsëri". Ndjeva se u skuqa dhe vështrova i turbulluar sytë e saj të bukur e të prerë në mënyrë vezake, në të cilët mund të lexoja sa shumë u pëlqeja grave. Përdorimi i përditshëm i bonboneve, ruajtësja e të cilave është ajo, e ka bërë zonjën Jos të ngjashme me ato. Ajo duket si një bonbonkë: e ëmbël, e pastër, oreksndjellëse. Gishtat e saj të brishtë qëndrojnë nga përdorimi i pincës së sermtë pak të hapur. Ajo vjen si e vogël dhe kërcen si një zogth. Të dyja cullufet e bardha të flokëve, që kalojnë në të dy tëmthat e përfundojnë mbrapa, më kujtojnë gjithmonë ca shirita marsipani në ca bonbone. Në kokën e saj të vogël në trajtë veze rri tërë topografia bonboneske e qytetit tonë. Ajo e di tamam cila grua ç'boribone pëlqen, me se mund të të kënaqë dhe kështu është bërë këshilltarja e të gjithë kavalierëve, e njohura e dyqaneve të mëdhenj, që në ditët e festave u kushtojnë vëmendje grave të klientëve të tyre të mëdhenj. Çfarë prishje kurore janë për t'u bërë, çfarë janë bërë tashmë - këto ajo i lexon nga konsumimi i përzjerjeve të bonboneve. Gjithashtu ajo shpik edhe shkartisje të reja, që i fut në modë me shumë zotësi.

Ajo i dha dorën Ulas duke i buzëqeshur. Futa çelësin e makinës në xhep dhe ajo e hoqi dorën nga Ula dhe ma dha edhe një herë mua.

Vështrova më me vëmendje ata sy të bukur dhe u përpoqa të përfytyroja se si Hedviga do të kishte folur me mua, sikur të kisha ardhur para shtatë vjetësh dhe ta kisha pyetur për bukë. I pashë ata sy të bëheshin më të ngushtë, të fortë dhe të thatë si sytë e një pate. I pashë

ata gishta të lezetshëm të hapur bukurisht, tek mbërtheheshin si kthetra, pashë atë dorë të butë, të ruajtur, të rrudhosur dhe të verdhë nga koprracia dhe e hoqa dorën time kaq shpejt nga e saja, sa ajo u tremb dhe shkoi te banaku duke tundur kokën. Fytyra i dukej tani mu si një bonbone që e kanë hedhur në plehra dhe nga e cila mbushja rrjedh me ngadalë në kanal, mbushje aspak e ëmbël, por e thartë.

Ula më tërhoqi tutje dhe ne kaluam pranë tryezave të zëna përmes thurinës së kuqërremtë të rrugës së tapetit mbrapa, ku ajo kishte parë dy karrige të lira. S'kishte tryezë të lirë, vetëm këto dy karrige pranë një tavoline për tre persona. Aty rrinte një burrë, që mbante në gojë një puro dhe lexonte një gazetë. Kur e nxirrte frymën, i dilte përjashta tym i hollë ngjyrë gri dhe mbi kostumin e tij të errët binin grimca të vogla hiri.

"Këtu do të ulemi?" e pyeta unë.

"S'ka vend tjetër të lirë" - tha Ula.

"E kam fjalën" - thashë "do të ishte më mirë të shkonim në një kafene tjetër".

Ajo i hodhi burrit një vështrim plot urrejtje, vështroi përreth dhe pashë se sytë i ndrinë nga një shprehje triumfi, kur atje te qoshja u ngrit një burrë, që ndihmoi të shoqen të vishte pallton e kaltër. Për atë - këtë e ndjeva sërish, kur shkova pas saj ishte jashtëzakonisht e rëndësishme, që biseda jonë të bëhej këtu. Ajo e hodhi çantën e saj në karrige, në të cilën ishte një karton këpucësh i gruas me pallton blu. Gruaja me pallton blu mori, duke tundur kokën, kartonin e saj dhe shkoi te burri, që ishte atje mes tryezave dhe po paguante llogarinë vajzës shërbyese.

Ula i mblodhi enët e pista bashkë, u ul në karrigen te qoshja. U ula në karrigen pranë saj, mora cigaret nga xhepi dhe ia zgjata; ajo mori një cigare, i dhashë zjarr ta ndizte, ndeza dhe për vete një dhe e hodha vështrimin tek pjatat e pista, në të cilat kishin mbetur të ngjitura drudhe

gjalpi dhe kishte bërthama qershish në qumështin gri të mbetur në një nga filxhanët e kafesë.

"Lipsej ta dija" - tha Ula "kur të vëzhgoja në fabrikë përmes murit të xhamtë, që ndante llogarinë nga fabrika, - si silllesh me punëtoret e vogla për t'u marrë atyre një copë bukë nga mëngjesi: njëra nga ato ishte një qenie e shëmtuar, e vockël, një nga mbështjellëset e grremçave. Ajo ishte pak rakitike, kishte një fytyrë shëndetligë e me puçrra dhe të dha ty gjysmë të bukës me marmelatë dhe unë të pashë si e fute në gojë.

"Ajo që s'di ti është se e putha, bile, dhe shkova me të në kinema, i mbaja në errësirë duart e saj në të miat dhe se ajo vdiq në ditët që dhashë provimin për kallfë. Ti s'di edhe që harxhova një rrogë javore për lule, që ia vura në varr. Shpresoj të ma ketë falur gjysmën e bukës me marmelatë".

Ula më vështroi në heshtje, shtyu edhe më tej enët e pista, kurse unë i shtyva prapë në vend, sepse një pjatë për pak sa s'ra përdhe.

"Ju nuk e quajtët të nevojshme, bile, të dërgonit një kurorë në varrimin e saj" - thashë unë. Bile s'u dërguat një letër ngushëllimi prindërve të saj. Them me mend se i hoqët me bojë të kuqe një vizë të pastër dhe të drejtë emrit të saj në listën e pagesës.

Vajza shërbyese erdhi, hoqi pjatat dhe filxhanët me një tabaka dhe tha: "Kafe, apo jo?"

"Jo" ia bëra unë - "ju lutem, për mua. Jo".

"Kurse unë dua" - tha Ula.

"Po ju?" - më tha vajza.

"Diçka" - thashë i lodhur.

"Sillini zotit Fendrih një çaj mendre" - tha Ula.

"Po" ia bëra "sillmëni një çaj mendre".

"O zot" - tha vajza "po ne s'kemi çaj mendre, kemi vetëm çaj të zi".

"Po, të lutem, të zi, - thashë dhe vajza iku.

Vështrova Ulën dhe u çudita, siç isha çuditur shpesh, kur ajo gojë e plotë dhe e bukur ngushtohet, hollohet e bëhet si vizë, që ajo hiqte me vizore.

Hoqa orën nga dora dhe e vura në tryezë ku rrija. Ishte ora gjashtë e dhjetë dhe asnjë minutë më vonë se shtatë pa çerek do të shkoja.

"Do t'i kisha paguar me qejf ato njëzet marka, për t'u llafosur dy minuta më shumë me ty, do të t'i kishe dhuruar gjatë ndarjes me qejf ato dy minuta, si dy lule veçanërisht të çmuara - por ti vodhe veten tënde. Për mua ato dy minuta kishin vlerën e njëzet markave.

"Po" - ia bëri ajo "ti je bërë një zotëri fisnik dhuron lule, një lule dhjetë marka".

"Po" - thashë "mu duk se ia vlente barra qiranë me qenë se kurrë s'i kishim dhuruar vetes diçka. Kurrë, apo jo?

"Po" - ja bëri ajo "s'i kerni dhuruar vetes kurrë diçka. Më është ngulitur në mendje se njeriu duhet t'i meritojë dhuratat. Nuk më është dukur kurrë që të kesh merituar ndonjë dhuratë, edhe unë duket s'e s'kam merituar asnjë".

"Po" - thashë. "Të vetmen dhuratë, që desha të të jepja, megjithëse s'e ke merituar, atë dhuratë të vetme ti nuk e pranove. Dhe kur dilnim" - thashë ultas nuk harronim kurrë të kërkonim dokument për taksën një herë për ju dhe herën tjetër për mua, dhe po të kishte dëftesa për puthje, do t'i kishe ato në një rregullator".

"Ka dëftesa për puthje" - ia bëri ajo "do t'i shikosh ndonjë ditë".

Vajza i solli Ulës kafënë dhe mua çajin. Mu duk sikur kaloj një pafundësi e tërë, gjersa gjithë ceremonia mbaroi: ajo vendosja e pjatave, e filxhanëve, e kanave me qumësht dhe e mbajtësve të sheqerit, e bidonit të çajit dhe pastaj edhe e një pjatëze të vogël ku ishte një

gjallesë e vogël prej argjendi me kthetra që mbante në dhëmbë një copëz të vockël limoni.

Ula heshtte dhe kisha frikë se mos bërtiste. E kisha dëgjuar njëherë si bërtiste, kur i ati ia refuzoi prokurën. Ora nuk po ecte, ishte gjashtë e trembëdhjetë minuta.

"Ta marrë djalli" - ia bëri Ula ultas "hiqe të paktën atë orë".

E mbulova orën me menyne.

Mu duk sikur të gjitha këto më ishte dashur me mijra herë t'i shikoja, t'i dëgjoja dhe t'i mbaja erë, si pllakat e gramafonit, që njerëzit që banonin mbi mua, i vinin çdo mbrëmje në një kohë të caktuar si një film që e shikon në ferr: gjithmonë një film dhe këtë grahamë në ajër, grahamë kafeje, djerse, parfumi, likerit dhe cigaresh: ajo që thashë unë, ajo që tha Ula, të gjitha këto ishin thënë me mijëra herë dhe nuk ishte ashtu, fjalët shijonin false në gjuhë: ato më dukeshin si ajo që i tregova tim eti për tregun e zi dhe për urinë që kisha: ashtu siç shpreheshin ato, nuk ishin më të vërteta - papritur sofia në mendje skenën si më kishte dhënë bukë me marnelatë Helena Frenkeli aq qartë, sa besova se shijova shijen e marmelatës së kuqe, të zakonshme. Më mori malli për Hedvigën dhe për hijen e jeshiltë në të errët të urës ku ishte zhdukur Jyrgen Brolaski.

"Nuk e kuptoj fare" - tha Ula, "sepse nuk kuptoj se ka gjëra që t'i nuk i bën për hir të parasë apo ka para ajo?"

"Jo" - thashë, "ajo nuk ka para, por e di që unë kam vjedhur. Dikush nga ju mund t'ia ketë treguar dikujt, që pastaj ia rrëfeu valait tuaj, edhe Volfi ma kujtoi edhe një herë këtë punë.

"Po" - ia bëri ajo, "bëri mirë që ta tha: je bërë aq fisnik, saqë, ndoshta, po fillon të harrosh se ke vjedhur pllaka gatimi për të blerë cigare".

"Edhe bukë" - thashë, "bukë, që ti, që yt atë nuk më dhatë - vetëm Volfi më jepte nganjëherë. Ai nuk e dinte ç'ishte uria, por

gjithmonë më jepte bukë, kur punonim bashkë. "Besoj" - thashë ultas "po të më kishe dhënë atëherë qoftë edhe një herë një karavele, do të ishte e pamundur për mua të rrija këtu dhe të flisja kështu me ty".

"Ne paguanim gjithmonë mbi tarifën dhe secili që punonte te ne, merrte shpërblimin e vet dhe në drekë një supë pa marka".

"Po" - ia bëra unë "ju paguanit gjithmonë mbi tarifë dhe çdokush që punonte te ju merrte shpërblimin që i takonte dhe në drekë një supë pa marka.

"Horr" - tha ajo, "horr bukëshkalë".

E mora menynë nga ora ku e kisha vënë, por kjo s'kishte vajtur akoma gjashtë e gjysmë dhe e vura përsëri mbi të. "Shqyrtoi listat e pagesës edhe një herë" - thashë, "listat, që ti ke bërë, lexoi emrat edhe njëherë - me zë të lartë dhe me përdëllirne, siç lexon një litani - shpalli ata dhe prapa çdo emri thuaj: Na fal, pastaj mblidhi emrat, shumëzoi numrin e emrave me një mijë bukë dhe këtë rezultat shumëzoi sërish me njëmijë: kështu do të kesh numrin e mallidrneve që prehen në konton bankare të babait tënd. Njësia e llogaritjes është buka, buka e këtyre viteve të hershme, që rrinë në kujtesën time si nën një mjegull të thellë: supa, që na jepnin, llokoçitej e vakët në stomakun tonë, e ngrohtë dhe e thartë përplasej te ne kur troshitëshim në mbrëmje në tramvajin që ktheheshim në shtëpi: ishte gromësima e pafuqisë dhe e vetmja zbavitje që kishim ishte urrejtja - "urrejtja" - thashë ultas "që ka fluturuar e dalë me kohë nga unë si një gromësimë, që ta shtyp stomakun fort. "Ah, Ula" - thashë ultas dhe e vështrova për herë të parë siç duhet "a do të më mbushësh mendjen me të vërtetë, të më bësh të besoj se me supën dhe mbiçmimin e vogël të pagesës ishte bërë... e do këtë? Mendo vetëm rrotullat e mëdha me letër vaji!"

Ajo e trazoi kafënë, më vështroi sërish dhe më zgjati cigaret; mora një, i dhashë zjarr dhe ndeza dhe cigaren time.

Nuk më bëhet bile vonë, që u kini treguar këtyre njerëzve për vjedhjen time legjendare a do të më bësh seriozisht të besoj se ne jo të gjithë, jo të gjithë ne, që ishim në listat tuaja të pagesës, ishim kohë më kohë të lejuar të merrnim disa bukë ekstra?

Ula vazhdonte të heshte, vështronte diku pranë meje dhe unë thashë: "Atëherë kur isha në shtëpi i vodha tim eti libra për të blerë bukë, libra që ai i donte, që i kishte mbledhur, për të cilët kishte vuajtur urie kur ishte student librat, për të cilat kishte paguar paratë e njëzet bukëve, unë i shisja me çmimin e një gjysmë buke: kjo është përqindja e interesit që marrim: minus dyqind gjer minus në pafundësi.

"Edhe ne" - tha ultas Ula "edhe ne paguajmë përqindje përqindje, që ti nuk e di".

"Po" - ia bëra unë "i paguani dhe nuk dini bile saktë, sa është përqindja kurse unë merrja çdo libër, i zgjidhja vetëm nga trashësia. Im atë kishte shumë, saqë besoja se s'do të binin në sy - vetëm më vonë e kuptova se çdo libër e njihte rmirë, siç njih bariu dhentë e tija. Një nga këta libra ishte i vogël dhe i vjetruar, ishte i shëmtuar - e dhashë atë me çmimin e një kutie shkrepseje. Por më vonë e mora vesh se bënte aq para, sa një vagon i tëri me bukë. Më vonë babai mu lut duke u skuqur, kur ma tha se duhej t'ia lija atij shitjen e librave. Ai i shiti vetë, mua më dërgonte paratë dhe kështu blija bukë...".

Ajo u drodh, kur thashë "bukë" dhe tani më erdhi keq për të. "Goditrnë po të duash" - tha ajo, "dredhma çajin në fytyrë folë, folë më tej, ti, që nuk doje të flisje por, të lutem, mos e përdor më fjalën "bukë": ma dhuro mua se duhet ta dëgjoj... të lutem" - ia bëri ajo dhe thashë ultas: "Më fal, nuk do ta them më". E pashë përsëri dhe u tremba: Ula, që rrinte atje, e ndryshoi çehren e fytyrës nga fjalët e mia, nga vështrirnet, nga efekti i akrepit të vogël të orës, që vazhdonte të shponte atje nën meny: ajo nuk ishte më ajo, që i përkisnin fjalët e mia. Kisha besuar se do të fliste shumë dhe se do të kishte të drejtë në një mënyre

mospërfillëse - por tani isha unë, që kisha folur shumë dhe isha unë që kisha të drejtë në një mënyrë mospërfillëse.

Ajo më vështroi dhe unë e kuptova, se më vonë, kur të kalonte para punishtes së errët për në shtëpinë e babait të saj përmes kaçubave, nëpër rrugën me zhavorr, poshtë kaçubave të shtogut e kuptova se s'do ta bënte atë që kisha pritur aq pak prej saj - do të qante dhe një Ula që qante unë nuk e njihja.

Besoja se do të triumfonte, por tani triumfova unë duke ndjerë në gjuhë shijen e thartë të triumfit.

Ajo nuk e preku kafënë, luante me lugën dhe u tremba nga zëri i saj kur tha: "Do të të jepja me qejf një çek të bardhë, që t'i tërheqësh mallkimet nga kontoja jonë. Është mirë të dish që gjithë këto vite ke menduar dhe i ke numëruar mallkimet për këto gjëra, pa më thënë mua.

"Nuk kam menduar gjithë këto vite" - thashë unë. "Është ndryshe puna: sot, ndoshta këtu, mu kujtuan ato gjëra: ti derdh material ngjyrosës të kuq në një burim për të zbuluar se sa larg venë rrembat e tua, por do të zgjatë me vite, gjersa të gjesh diku, ku nuk e hamendësuar ujin e ngjyrosur me të kuq. Sot kuqëlojnë përrenjtë, vetëm, sot e di ku ka mbetur ngjyra ime e kuqe.

"Mund të kesh të drejtë" - tha ajo " edhe unë e di vetëm sot, vetëm tani s'e çaj kokën për para: nuk do të më kushtonte asgjë të të jepja një çek të bardhë, të dytë dhe një dëftesë kontoje bashkë me të dhe ti mund të tërhiqje sa të doje, nuk do të ndjeja dhimbje - kam besuar gjithmonë se do të ndjeja dhimbje. Ndoshta ke të drejtë por për të gjitha këto tani është vonë.

"Po" ia bëra unë "është tepër vonë - duket si vrapon kali përmes objektivit, për të cilin ke dashur të vësh një mijë marka - dëshminë e mbushur të bastit e ke tashmë në dorë, pusullën e bardhë, që do të kishte vlerën e një pasurie të tërë, po ta kishe vënë, por nuk e ke vënë dhe pusulla është pa vlerë, nuk ka kuptim ta ruash atë si kujtim.

"Kemi akoma një mijë markat" - tha ajo "por ti, ndoshta, do t'i hidhje të njëmijë markat tok me pusullën në kanal të rrugës".

"Po" - thashë, "besoj se do ta bëja këtë gjë". E shtiva qumështin në çajin e ftohtë, e shtrydha limonin aty brenda dhe pashë si u bë qumështi i trashë dhe u fundos poshtë me fjolla të verdheme në gri. I zgjata Ulës cigaret, por ajo tundi kokën. Edhe unë nuk kisha qejf ta tymosja dhe i hoqa cigaret. E ngrita paksa menynë nga ora ime, pashë se ishte shtatë pa dhjetë dhe e vura menynë shpejt sërish mbi orë, por ajo e pa dhe tha: "Shko tani - unë po rri akoma".

"A të të shpie në shtëpi" - e pyeta.

"Jo" - ia bëri ajo "po rri edhe ca këtu. Shko tani".

Por ndenja dhe ajo tha: "Nëma dorën" unë ia dhashë. Ula e mbajti dorën një çast fort, pa e parë, papritur e lëshoi prapë poshtë, përpara se të mendoja se do ta lëshonte dhe dora më goditi në buzë të tryezës.

"Më fal" - ia bëri "nuk desha, nuk desha". Ndjeva një dhimbje të fortë në dorë, por i besova se nuk e kishte bërë me dashje.

"T'i kam vëzhguar shpesh duart si mbanin veglat, si kapnin aparatin, si i vije veçmas aparatet, që nuk i njihje. Studioje mënyrën e tyre të të punuarit dhe pastaj i montoje prapë. Mund të shikoje se t'i ishe i lindur për këtë profesion dhe e doje atë, se ishte më mirë të fitoje me të bukën e gojës, sesa të ta dhuronin.

"Nuk e dua atë profesion" thashë "e urrej atë, siç urren boksieri baksin".

"Shko tani" - ia bëri ajo, "shko" dhe ika pa thënë asgjë, pa u kthyer, gjer te banaku, pastaj u ktheva dhe i pagova vajzës së shërbimit, që qëndronte atje midis tryezave, kafenë dhe çajin.

IV

Ishte errësirë dhe gjithnjë e hënë kur ktheva për në Judengase; po ecja shpejt. Por tashmë ora ishte shtatë dhe nuk e mendova se Nadelbraite mbyllej për makina që në orën shtatë. Ecja në tym përreth saj nëpër rrugë të errëta e të pazëna me ndërtime dhe dola sërish te kisha, ku e kisha parë Hedvigën herën e fundit.

Mu kujtua se të dyja, Hedviga dhe Ula "shko" më patën thënë, "shko".

Kalova përsëri pranë dyqanit me takëme shkrimi, dyqanit t2 arkivoleve në Korbmahergase dhe u tremba kur pashë, se në kafene nuk kishte më dritë. Doja të kaloja aty e të futesha në Judengase, pashë çastin e fundit pulovrin jeshil të Hedvigës te hyrja e kafenesë dhe frenova aq fort sa makina filloi të shtillej e të rrëshqiste në brezin argjilor, ku rruga hapej dhe mbyllej përsëri, dora ime e majtë u përplas pas dorezës së derës. Të dyja duart më dhembnin, kur zbrita dhe shkova në errësirë drejt Hedvigës: ajo qëndronte atje, siç kishin qëndruar vajzat, që më kishin folur nganjëherë, kur shkoja mbrëmjeve nëpër një rrugë të errët: pa pallto, me pulovrin jeshil, verbuese. Nën flokët e errët i dukej fytyra e bardhë dhe akoma më e bardhë - e bardhë gjer në dhimbje - ishte dekolteja e vogël, në formë flete e qafës së saj. Goja i dukej sikur ishte lyster me bojë të zezë.

Hedviga nuk lëvizte, nuk tha gjë, nuk më vështroi dhe, pa i thënë gjëkafshë e tërhoqa për dore në makinë.

Aty ishin mbledhur njerëz, se zhurma e frenave tingëlloi si një buçimë trompete në rrugën e qetë. Hapa shpejt derën e makinës, e shtyva Hedvigën brenda, kalova me shpejtësi në anën tjetër dhe u largova me ngut që aty. Vetëm një minutë më vonë, kur kishim kohë, ishim prapa stacionit të trenit, pata kohë ta shikoja. Ishte e zbehtë si mehiti dhe e mbante pjesën e sipërme të trupit drejt si një statujë.

Eca nën një fener dhe qëndrova. Ishte një rrugë e errët dhe rrethi i dritës së fenerit binte në një lulishte duke ndriçuar një copë të rrumbullt gjelbërimi në errësirë. Përreth ishte qetësi.

"Një burrë më fal" - tha Hedviga dhe u tremba, sepse ajo vazhdonte gjithnjë të shikonte drejt si një statujë. "Një burrë, ai donte të më merrte me vete apo të shkonte me mua. Ai ishte shumë i lezetshëm: çantën e mbante nën sqetull dhe dhëmbët i kishte pakëz si të verdhë nga tymi i duhanit. Ishte i madh, me siguri, tridhjetë e pesë vjet, por, ama, ishte i lezetshëm.

"Hedviga" - thashë, por ajo nuk më vështroi. Vetëm kur e kapa për krahu, ktheu kokën dhe tha ultas: "Shpjermë në shtëpi". E kuptova vetvetiu si futi në fjali fjalën "ti".

"Po të shpie në shtëpi" - thashë, "ah, o Zot".

"Jo, prit edhe një çast" tha ajo dhe më pa, më pa tamam, aq tamam, siç e kisha parë unë, por tani kisha frikë ta shikoja. Më buloi djersa dhe ndjeva dhimbje në të dyja duart. Kjo ditë, kjo e hënë mu duk padurimisht e gjatë, shumë e gjatë për një ditë të vetme dhe e kuptova se nuk duhej të dilja nga dhoma e saj. Kisha zbuluar vendin dhe ende nuk kisha vënë shenjën time. Vendi ishte i bukur, por i huaj, ama, po aq i huaj, siç ish dhe i bukur.

"O zot" - ia bëri ajo ultas "më bëhet qejfi që je më i mirë se ai, shumë më i mirë, furrtari nuk ishte aspak kaq mirë sa ç'dukej. Fiks në orën shtatë më flaku jashtë. Ti nuk duhej të vije vonë. Shko tani" - tha ajo. Eca ngadalë dhe rrugët e errëta, nëpër të cilat kalova, mu dukën si

shtigje lymishteje, në të cilët makina mund të fundosej çdo çast. Eca me kujdes, sikur të kisha ngarkuar eksploziv dhe dëgjoja zënë e saj, ndjeja dorën e saj në krahun tim. E ndjeva veten thuajse siç duhet ta ndjejë dikush, që ka dhënë provimin e madh Ditën e Gjyqit.

"Për pak do të kisha shkuar me të" - tha "nuk e di sa kohë i duhej të qëndronte, por ai nuk qëndroi. Donte të martohej me mua, donte të ndahej kishte fëmijë dhe ishte i mirë. Por iku me vrap, kur dritat e makinës tënde ndriçuan rrugën. Vetëm një minutë qëndroi para meje duke pëshpëritur me ngut si ata njerëzit që kanë pak kohë. Edhe ai kishte pak kohë: një minutë dhe unë rrojta një jetë të tërë në krah të tij këtë minutë: rashë në krahët e tij, pastaj u çlirova prej tyre: mora fëmijët e tij, i arnova çorapet, i merrja mbrëmjeve, kur vinte në shtëpi, çantën, e puthja kur dera e shtëpisë ishte mbyllur pas tij. Gëzohesha me të për dhëmbët e tij të rinj të vënë, dhe, kur e mori rrogën me rritje, bëmë një aheng të vogël: pati byrekë, shkuam në kinema, më bleu një kapelë të re, të kuqe si reçeli i qershisë, ai bëri me mua atë, që kishe dashur ti të bëje dhe unë i pëlqejta dhelkat e tij të flashkëta - e shikoja tek i ndërronte kostumet, kostumin e së dielës e bëri kostum të përditshëm, edhe ky i varej poshtë mori kostum të ri dhe fëmijët u bënë të mëdhenj, mbanin kapele të kuqe si reçeli i qershisë dhe ua ndalova atë gjë, që mua më ishte ndaluar gjithmonë - të shëtisja në shi. Ua ndalova për të njëjtën arsye, që mu ndalua dhe mua: sepse rrobat prishen shumë shpejt në shi... Isha vejusha e tij dhe më erdhën për ngushëllim nga firma. Ai ishte kalkulues në një fabrikë çokollatash dhe në mbrëmje më tregonte sa kishte fituar firma e tij me çokollatat "Jussupoff". Ajo fitonte shumë dhe më porositi ta mbyllja gojën për këtë, por unë nuk e mbylla. Në dyqanin e qumështit, të nesërmen në mëngjes tregova sa kishte fituar firma e tij me çokollatat "Jussupoff". Duhej të qëndronte akoma një apo dy minuta, por nuk qëndroi: vrapoi, vrapoi shpejt si një lepur, kur

vetura tënde mori kthesën në rrugë. "Nuk jam pa shkollë, zonjushë, më tha".

E ula edhe ca shpejtësinë, se dora e majtë më dhimbte shumë dhe e djathta filloi të enjtej pak. U futa në Judengasse aq me ngadalë, sikur të ecja mbi një urë, që mund të shembej nga çasti në çast.

"Çdo këtu?" - pyeti Hedviga, "do të qëndrosh".

E pashë me aq frikë, siç e shikonte i shoqi.

"Nuk mund të shkoni në dhomën time" tha ajo "atje më pret Hilde Kamenc. Pashë dritë në dhomën time dhc makinri e saj përpara derës sime".

Kalova me ngadalë përpara derës së shtëpisë, kësaj dere në ngjyrë të kaftë, tablonë e së cilës do ta shikoja sërish, kur ajo vinte nga dhoma e errët: dyer shtëpish në trajtë harkimi - grumbuj hargesh me dyer shtëpish, si grumbujt e pullave të reja, që iknin nga shtypshkronja shtetërore.

Një makinë e kuqe si vera qëndroi përpara kësaj dere.

I hodha Hedvigës një vështrim pyetës.

"Hilde Kamenc" - tha ajo "është një e njohura e babait tim. Merr qoshen tani. Kam parë nga dritarja e dhomës sime se në Nebenshrasse është një shtëpi me një të çarë: pashë atje një kalldrëm të errët me brezin e kaftë argjilor në mes dhe ty që shtriheshe i vdekur mbi të, se kisha frikë se nuk do të vije kurrë përsëri".

U rrotullova dhe u futa në Korbmahergase, gjithnjë me ngadalë dhe mu duk se nuk mund të ecja kurrë më me shpejtësi. Pak shtëpi prapa furrës ishte shtëpia me një të çarë dhe ne pamë bahnën e pasme të shtëpisë, ku banonte Hedviga: pemët e mëdha e mbulonin një pjesë të shtëpisë por mund të shikonim një radhë të tërë pingule dritaresh: në katin përdhes dritarja ishte e errët, në katin e dytë e ndriçuar; edhe në katin e tretë kishte gjithashtu dritë. "Dhoma ime" - tha ajo "kur e hapi dritaren mund ta shihnim siluetën e saj: ti do të kishe rënë brenda në

këtë kurth si e verbër. Ajo do të na rrëmbente e çonte në shtëpinë e saj - një shtëpi e mrekullueshme, që është e bukur, siç janë të bukura shtëpitë që janë rastësisht të bukura. Po ti në vështrimin e parë shikon që rasti është i përgatitur me marifet dhe e ndjen veten, siç e ndjen kur vjen nga kinemaja, i prekuri i tëri nga filmi dhe dikush të thotë pastaj, kur je duke dalë, para gardërobës: S'ishte film i keq, vetëm muzika ishte mediokre. - Ja ku është ajo".

I hoqa sytë nga Hedviga dhe i drejtova sërish në dhomën e saj. Aty pashë siluetën e një gruaje, që mbante një kapelë majuce dhe, megjithëse nuk ja shquaja dot sytë, vura re se ajo shikonte makinën tonë me sytë e atyre grave që donin të sillnin rregull në jetën e njerëzve të tjerë. "Shkojmë në shtëpi" - tha Hedviga "ec... kam frikë se do të na njohë këtu poshtë dhe, po t'i biem në dorë, do të rrimë tërë mbrëmjen në këtë shtëpi, do të pimë një çaj të shkëlqyer dhe nuk do të shpresojmë se fëmijët e saj do të zgjohen e do të merren me të ëmën, se ata janë edukuar me disiplinë dhe flenë që nga ora shtatë e mbrëmjes deri më shtatë të mëngjesit. Ec - s'është këtu as burri i saj: ai është në rrugëtim. Diku u ngre njerëzve të tjerë me honorare shtëpi, që duken se janë të bukura rastësisht. Ec tani". Unë ecja, ecja nëpër Korbmahergase, Necmahergase, kapërceva ngadalë Nudelbreite-n, u solla rreth sheshit Röntgen, hodha një vështrim në vitrinën e dyqanit të mishit, kur ende qëndronte piramida e Corned-beef dhe mendoja më shkoi sërish te Ula dhe vitet, që kalova me të: ato vite ishin bërë të ngushtë si një këmishë që nuk e ka përballuar dot larjen, por koha që nga dreka, që nga mbërritja e Hedvigës ishte një kohë tjetër.

Isha i lodhur, sytë më dhimbnin dhe, kur u lëshova poshtë rrugës së gjatë dhe të drejtë Mynhner, eca thuajse i vetëm në krahun e djathtë. Në krahun e majtë shtyheshin dhe parakalonin makinat, i binin borisë dhe çirreshin triumfuese pranë njëra-tjetrës. Në stadium duhej të kishte ndeshje boksi apo garë çiklistike: vazhdimisht isha nën dritën e

prozhektorëve të makinave të krahut të kundërt. Drita e tyre më verbonte sytë, një dhimbje nga drita, nën të cilën për disa çaste rënkova: më dukej sikur vrapoja mbi gjemba në një radhë të pafundme shtizash të gjata, shumë të ndritshme, çdonjëra prej të cilave më ngulej thellë në trup me mundimin e dritës së tyre. Isha si i kamxhikuar me dritë dhe solla në mëndje vitet, në të cilët mëngjeseve kur zgjohesha e urreja dritën. Dy vjet të tërë më kishte shtytur ecja përpara dhe çdo mëngjes ngrihesha më pesë e gjysmë, pija një filxhan çaji të hidhur, mësoja përmendësh formula ose merresha poshtë në punishten e vogël të qilarit me sajime, limime dhe montime gjërash, provoja konstruksione, që rrjetin elektrik të shtëpisë e rëndonin shpesh aq shumë, saqë linja digjej dhe dëgjoja lart në shtëpi zëra të indinjuar që bërtisnin për ujin e kafesë së tyre. Ora me zile ishte aty pranë meje në skrivani, apo në bankën e punës dhe vetëm kur binte zilja, kur ora ishte tetë, ngjitesha lart, bëja dush dhe pastaj shkoja në kuzhinën e pronares për të marrë mëngjesin - kisha punuar dy orë e gjysmë përpara se shumica e njerëzve të fillonin të hanin mëngjesi kisha urreyer këto dy orë e gjysmë, nganjëherë edhe i kisha dashur, por gjithmonë i kisha bërë. Por, kur haja mëngjes në dhomën time me dritë, shpesh e kisha ndjerë këtë kamxhikim të dritës, siç e ndjeja tani. Rruga Mynher ishte e gjatë dhe gëzohesha kur stadiumin e linim pas.

Hedviga nguroi, nguroi vetëm një çast, kur qëndruam: i hapa derën e makinës, i dhashë dorën dhe, duke u kalarnendur para saj, ngjita shkallët.

Ora ishte shtatë e gjysmë dhe e hëna mu duk e gjatë sa përjetësia: s'kishin kaluar as njëmbëdhjetë orë, që kisha dalë nga shtëpia.

Mbajta vesh në korridor, dëgjoja të qeshurat e fëmijëve të pronares sime, tek hanin darkën dhe tani, që po ngjitja shkallët, e pashë pse këmbët i kisha aq të rënda: copa argjilore vareshin në këpucët e

mia. Edhe këpucët e Hedvigës ishin zhyer me argjilë nga kanali në mes të Korbmahergases.

"Nuk po e hap dritën" - i thashë Hedvigës kur hymë në dhomë. Sytë më dhembnin shumë.

"Po" - tha ajo "mos e hap dritën" dhe mbylla derën pas saj.

Një dritë e lëyrte binte në dhomë nga dritaret e shtëpisë përkundruall dhe pashë mbi skrivani pusullat, ku zonja Brotig kishte shënuar telefonatat, që më ishin bërë. Pusullat ishin rëndësuar me një gur; e mora gurin, e peshova në dorë si një armë flakëritëse, hap dritaren dhe e hodha në kopsht. Dëgjova si u rrokullis në errësirë mbi bar dhe u përplas pas kazanit me plehra. E lashë dritaren hapur, numërova pusullat në errësirë. Ishin shtatë pusulla, i grisa dhe i hodha copërat në koshin e letrave.

"Ke sapun?" - më pyeti Hedviga nga mbrapa "Dua të laj duart, uji në dhomën time është plot ndryshk dhe me pislëqe.

"Sapuni është majtas në raftin e poshtëm" - thashë unë. Mora një cigare nga paketa, e ndeza dhe, kur u ktheva për t'i fryrë fijes së shkrepëses e për ta hedhur në tavëll, pashë fytyrën e Hedvigës në pasqyrë: goja i dukej si goja që ishte shtypur në bllokun e letërthithësve, me të cilat fshija brisqet e rrojës - ujët gurgullonte dhe ajo lau duart; dëgjoja sesi i fërkonte njëra me tjetrën. Prisja diçka dhe e dija çfarë kisha pritur, kur trokiti ultas dera. Ishte pronarja ime, shkova shpejt te dera, e hap vetëm përgjysmë dhe dola në treme.

Këtë çast ajo po zgjidhte përparësen, e palosi dhe vetëm tani, pas katër vitesh, që banoja tek ajo, vetëm tani vura re se i ngjante pak zonjës Vicel, pakëz, por ama, i ngjante. Gjithashtu tani pashë për herë të parë sa vjet ishte: me siguri, dyzet, ndoshta, edhe më shumë. Ajo kishte një cigare në gojë, shkundi tani përparësen për të dëgjuar në kishte shkrepëse në xhep. Nuk kishte, edhe unë shkunda më kot xhepat, se i kisha lënë ato në dhomë. I dhashë cigaren time të ndezur, e ndezi, e

thithi thellë tymin dhe pastaj ma ktheu cigaren. Ajo pinte duhan, siç kisha parë zakonisht vetëm burra të pinin, me një vetëkuptueshmëri të zjarrtë e thithte tymin thellë.

"Ç'ditë ishte dhe kjo!" - ia bëri - tani së fundi nuk kam shkruar aspak. M'u duk një gjë pa kuptim me qenë se Ju ishit zhdukur pa gjurmë. Përse e harruat gruan e varfër atje në Kurbelshtrase?"

Mblodha supet dhe e pashë në sytë e përhimtë pakëz të shtrembër.

"Mos kujtuat gjë lulet?"

"Jo" - ia bëri - "i kam harruar".

Heshti, rrotulloi e turbulluar cigaren në dorë, u mbështet pas murit dhe e kuptova se e kishte të zorshme të thoshte atë që deshte të thoshte. Doja ta ndihmoja, por nuk po gjeja fjalët. Fshiu me dorën e majtë ballin dhe tha: "Hajën e keni në kuzhinë". Po haja ime ishte gjithmonë në kuzhinë; thashë "faleminderit", pashë diku pranë saj dhe thashë ultas në modelin e tapetit: "Thuama tani".

"Nuk bën" tha pronarja "nuk më ka hije ta them - më vjen rëndë që t'ua them, që nuk desha - nuk desha që vajza të rrinte natën me Ju".

"E keni parë?" - pyeta unë.

"Jo" - ia bëri "po u kam dëgjuar të dy Ju: ishte shumë qetësi dhe tani papritur mora vesh gjithçka. Do të rrijë te Ju?"

"Po" - ia bëri - "ajo është, ajo është gruaja ime".

"Ku kini vënë kurorë?" Nuk buzëqeshi dhe vështroi brenda modelit të tapetit trekëndëshat ngjyrë portokalli. Heshta.

"Ah" - ia bëri ultas "Ju e dini se s'kam qejf ta them, por gjëra të tilla nuk i duroj dot. Nuk mundem, dhe duhet t'ua them, jo vetëm t'ua them, nuk mundem, unë...".

"Ka martesë nga e keqja" - thashë "siç ka pagëzime nga e keqja".

"Po" - ia bëri "këto janë truke. Nuk jemi në shkretëtirë dhe as në humbëtirë, ku nuk ka priftërinj".

"Ne" - thashë unë "ne të dy jemi në shkretëtirë dhe në humbëtirë dhe nuk shoh kurrkund ndonjë prift, që të na vërë kurorë". Mbylla sytë se vazhdonin gjithnjë të më dhembnin nga kamxhikimi i dritave të makinave. Isha i lodhur, i lodhur për vdekje dhe ndjeja dhimbje edhe në duart. Trekëndëshat portokalli vallëzonin para syve të mi.

"A njihni ndonjë prift?" - e pyeta.

"Jo" - tha zonja Brotig - "nuk njoh asnjë".

Mora tavllën, që ishte në karrige para telefonit, shojta cigaren dhe ia zgjata. Ajo shkundi në tavëll hirin e cigares dhe ma mori atë nga dora.

Kurrë në jetën time s'kisha qenë kaq i lodhur. Sytë shikonin vazhdimisht trekëndëshat ngjyrë portokalli si të shikonin gjemba. E urreja burrin e saj, që blinte të tilla plaçka, sepse këto janë ato që ai i quan moderne. "Lipset ta kujtoni pak babanë. E doni?"

"Po" - thashë "e dua dhe sot e kam kujtuar shumë shpesh" përsëri e solla ndër mend tim atë, e shikoja si shkruante me bojë të kuqe gjak në një pusullë: Të bisedoj me djalin.

E pashë Hedvigën në sytë e pronares sime - një vizë të errët në këtë përhimësi miqësore. Nuk e ktheva kokën nga ajo, ndjeva dorën e saj në sup, frymëmarrjen e saj dhe e nuhata se buzët i kishte lyer me të kuq: një pomadë e ëmbël. "Kjo është zonja Brotig" - thashë "dhe kjo është Hedviga". Hedviga i dha dorën zonjës Biotig dhe pashë sa të mëdha ishin duart e Hedvigës, sa të bardha e të fuqishme, kur dora e zonjës Brotig toku dorën e saj.

Ne heshtnim të gjithë. Dëgjoja një çezmë që çuquriste në kuzhinë, dëgjoja hapat e një burri në rrugë, dëgjoja pushimin pas pune në hapin e tij dhe vazhdoja të buzëqeshja gjithnjë, buzëqeshja, pa e ditur

si. se unë, unë isha i lodhur të bëja lëvizjen e vockël të buzëve, nga të cilat lindte buzëqeshja.

Zonja Brotig e vuri tavllën sërish në karrige, që ishte nën telefon, e hodhi përparësen e saj aty pranë. Hiri i cigareve u ngrit lart dhe thërrnizat e tij u ulën poshtë si pudër mbi qiiirnin blu në të erra. Ajo ndezi një cigare tjetër me duqin, që i kish mbetur dhe tha: "Nganjëherë harroj sa i ri jeni akoma, por tani shkoni, mos më lodhni t'ju nxjerr jashtë - shkoni".

U ktheva dhe e tërhoqa Hedvigën për krahu në dhomën time. Kërkova me të prekur në errësirë çelësat e mi të makinës, i gjeta në skrivani dhe zbritëm sërish shkallët me këpucët tona të pista. Isha i gëzuar që s'e kisha lënë makinën në garazh, por në rrugë. Dorën e majtë e kisha thujse të mpitë, pakëz të ënjtur dhe e djathta më dhembte fort nga të goditurit në mermerin e tryezës së kafenesë. Isha i lodhur dhe i uritur, u ktheva me ngadalë në qytet. Hedviga heshte, e mbante pasqyrën e dorës para fytyrës dhe pashë se shikonte vetëm gojën e saj në pasqyrë. Pastaj mori të kuqtë e buzëve nga çanta dhe i leu ato fort.

Nudelbreite vazhdonte ende të ishte e mbyllur. Ora s'kishte vajtur tetë, kur kalova sërish përpara kishës në Necmahergase, pastaj eca nëpër Korbmahergase dhe qëndrova në boshllëkun e shtëpisë para furrës.

Drita në dhomën e Hedvigës ndriçonte ende. Vazhdova rrugën, pashë makinën e kuqe si vera, tek qëndronte akoma përpara derës së shtëpisë dhe i rashë sërish përqark kiejt bllokut gjer te boshfiëku i shtëpisë në Korbmahergase. Ishte qetësi dhe errësira kishte ndehur napën e saj. Ne heshtnim. Më kapi uria më iku sërish, më erdhi dhe më iku prapë. Ajo lëshohej mbi mua si valët e një tërmeti.

Mu kujtua se çeku, që ia kisha dërguar Vikveberit, nuk ishte mbuluar aspak dhe mendova se Hedviga nuk më kishte pyetur se çfarë profesioni kisha, nuk ma dinte as emrin. Dhimbjet e duarve mu bënë më

të forta dhe, kur i mbyllja sytë e munduar për disa sekonda, vallëzoja nga përjetësia plot trekëndësia ngjyrë portokalli.

Drita e dhomës së Hedvigës do të shuhej këtë të hënë, që kishte dhe katër orë kohë. Zhurma e motorit të makinës të kuqe si verë do të largohej. Tashmë dëgjoja, sesi motori çante natën, duke lënë prapa qetësi dhe errësi. Do të ngjitim shkallët. Dyert do t'i hapnim dhe mbyllim lehtë. Edhe një herë Hedviga vështroi gojën e saj. Edhe një herë tjetër i përshkoi buzët me ngadalë dhe fort, sikur ato të mos ishin plotësisht të kuqe dhe tani e mora vesh, se çdo të mësoja më vonë.

Kurrë më parë nuk e kisha ditur, se isha i pavdekshëm dhe në të njëjtën kohë isha si i vdekur. Dëgjoja britmat e fëmijëve, që u vranë në Betlehem⁹ dhe në britmat e tyre përzihej britma e vdekjes e Fruklarsit, një britmë, që askush s'e kishte dëgjuar, por që e kapi veshi im. nuhata frymëmarrjen e luanëve, që kishin copëtuar martirët, ndjeja panxhat e tyre që më futeshin në mish si gjemba. Shijova ujin e kripur të detit, pikla të hidhura nga thellësia më e thellë dhe pashë tablo, që dilnin jashtë kornizave të tyre, siç del uji mbi brigjet - peizazhe që s'i kisha parë kurrë, fytyra, që s'i kisha njohur kurrë dhe rashë përmes këtyre tablove në fytyrën e Hedvigës, u përplasa me Brolaskin, me Helenë Frenkelin, me Fruklarin rashë përmes këtyre fytyrave sërish në fytyrën e Hedvigës dhe e kuptova se fytyra e saj ishte e pavdekshme, se do ta shihja përsëri, me një cohë para fytyrës, që papritmas do të grisej për t'ia treguar fytyrën e saj Grëmigut. Fytyra e Hedvigës, që nuk mund ta shihja me sytë e mi, se nota ishte shumë e errët, por s'kisha nevojë më për sy për të parë atë.

Nga dhoma e errët vinin tablora: e pashë veten time të përkulej mbi Hedvigën si një i huaj, dhe isha xheloz me vetë veten time. Shikoja burrin, që i kishte folur Hedvigës, dhëmbët e tij të verdhë, çantën, shikoja Moxartin si i buzëqeshte zonjushës Klontik, mësueses së

⁹ Këtu: kujtesë për një histori biblike.

pianos, që kishte banuar pranë nesh. Gruaja e Kurbelshtreses qante në të gjitha tablorat dhe gjithnjë ishte e hënë, e dija se nuk doja të shkoja përpara, doja të kthehesha mbrapa se ku nuk e dija, por të kthehesha.